21. Cili nga antibiotikët e poshtëshënuar është zgjedhja e parë për mjekimin e anginave streptokoksike, në se pacienti ka alergji nga antibiotikët betalaktamidë:

- A) ampicilina
- B) eritromicina

- C) amikacina
- D) gentamicina

22. Cili nga ushqimet e mëposhtme nuk absorbohet në sëmundjen celiake:

- A) Kosi
- B) Buka e grurit
- C) Orizi
- D) Mishi

23. Sëmundja reumatike shfaqet në përgjithësi:

- A) Pas një infekzioni stafilokoksik
- B) Disa jave pas një infekzioni streptokoksik
- C) Menjëherë pas difterisë
- D) Pas një infekzioni nga fruthi

24. HTA në radhë të parë dëmton:

- A) arteriet cerebrale
- B) arteriet koronare
- C) arteriet veshkore
- D) arteriet periferike

25. Kush nuk është ndërlikim madhor i HTA?

- A) infarkti i miokardit
- B) tromboembolizmi sistemik
- C) insuficiencia kardiak
- D) insulti cerebral

26. Në astmën bronkiale të formës së mesme nuk nevojitet për mjekim:

- A) Korticosteroidë parenteral
- B) B2 mimetikë inhalatorë
- C) Kromoloine
- D) Ksantina

27. Cili nga medikamentet e më poshtëme antihipertensive jep me shpesh konstipacion:

- A) propanololi
- B) lasiksi
- C) aldometri
- D) izoptina

28. Femër 30 vjeçë, paraqitet me dhimbje shpine, në regjionin gluteal dhe në anesinë e poshtme. Ajo ishte duke ngritur objekte të rënda në shtëpi. Ajo qëndron e përkulur në njëren anë dhe ngritja e këmbës së shtrirë është e kufizuar dhe e dhimbëshme. Diagnoza e mundshme është:

- A) Mialgji
- B) Spondilozë lumbare
- C) Stenozë spinale
- D) Prolaps i diskut lumbar

29. Mashkull 20 vjeç, paraqitet me dhimbje kolike periumbelikale, që zhvendosen drejt fosës iliakë të djathtë, temperaturë, humbje oreksi. Diagnoza e mundshme është:

- A) Kolecistit akut

- B) Divertikulit akut
- C) Ulçer peptike e perforuar
- D) Appendicitis akut

30. Grua 47 vjeçe, astmatike dhe hipertonike për të cilin merr methyldopa, ankon për anoreksi, dhimbje barku dhe ikter që po theksohet. Diagnoza e mundshme është:

- A) Hepatit kronik aktiv
- B) Kolecistit akut
- C) Pankreatit akut
- D) Hepatit viral akut

31. Grua 78 vjeçe me me anginë të qëndrueshme, 10 ditë pas një operacioni për frakturë të qafës së femorit ankon për distension masiv të barkut. Diagnoza e mundshmë është:

- A) Aneurisma e aortës abdominale
- B) Ulçer peptike e perforuar
- C) Pseudo- obstruksion
- D) Kolit Ulçeros

32. Burrë 60 vjeç, kohët e fundit është trajtuar për tuberkuloz të veshkës, paraqet rënie në peshë, diarhe, anoreksi, hypotension. Ai paraqet hiperpigmentim të mukozës së gojës dhe vijave të pëllëmbëve të duarve. Cilin eksaminim do të kërkonit përvendosjen e diagnozës:

- A) Glicemi
- B) ACTH dhe kortizolin plazmatik
- C) ECHO abdominale
- D) Testet e funksionit të tyroides

33. Grua 50 vjeçe, ankon për rënie në peshë, oreks të shtuar, djersitje, palpitacione, preferencë për mot të ftohtë, ka vapë, duar të djersira si dhe tremor. Cilin ekzaminim do të kërkonit përvendosjen e diagnozës:

- A) ACTH dhe kortizolin plazmatik
- B) Testet e funksionit të tyroides
- C) ECHO abdominale
- D) Hemokulturë

34. Burrë 65 vjeç, ka fillim të menjëhershëm të diabetit, anoreksi, rënie në peshë, dhimbje epigastrike dhe shpine. Cilin eksaminim do të kërkonit përvendosjen e diagnozës:

- A) Gjak komplet
- B) Glicemi
- C) Testet e funksionit të tyroides
- D) ECHO abdominale

35. Grua 70 vjeçe, ankon për rënie në peshë, disfagi progresive, dhe ndjenjën se ushqimet i ngecin në fyt. Cilin ekzaminim do të kërkonit përvendosjen e diagnozës:

- A) Skopi me barium
- B) Gjak komplet
- C) ECHO abdominale
- D) Testet e funksionit të tyroides

36. Djalë 17 vjeç, ankon për temperaturë të lartë që dy javë, dhimbje fytë, zmadhim të gjëndrave në qafë. Në ekzaminim objektiv ka ndjeshmëri në kuadratin e sipërm abdominal të djathë,

subikter në sklera, SGOT dhe SGPT, lehtësishët të rritura. Cilin ekzaminim do të kërkonit përvendosjen e diagnozës:

- A) Hemokulturë
- B) Mantuox
- C) Monospot (gjak përm MI)
- D) ECHO abdominale

37. Burrë 54 vjeç, ka 2 muaj që ka zmadhim të tonsilës së majtë, temperaturë fluktuante, kryesisht mbas dite, si dhe zmadhim të limfonodujve në qafë. Cilin ekzaminim do të kërkonit përvendosjen e diagnozës:

- A) Gjak komplet
- B) Biopsi e limfonodulit
- C) Mantuox
- D) CT toraksi

38. Femër 25 vjeçe, ndihet sëmurë, ka ethe, poliartralgji, eritemë nodoze. Radiografia e thoraxit tregon lymphadenopathy mediastinale hilare. Cilin ekzaminim do të kërkonit përvendosjen e diagnozës:

- A) Testi Kvein
- B) Monospot
- C) HIV 1+2
- D) Mantuox

39. Mashkull 29 vjeç, përdorues droge iv, paraqet temperaturë, adenopati cervikale që rrjedh një substancë të bardhë si gjizë. Cilin eksaminim do të kërkonit përvendosjen e diagnozës:

- A) Testi Kvein
- B) Monospot
- C) HIV 1+2
- D) Mantuox

40. M 35 vjeç, ka kollë, hemoptizi. Ro: masë në hilusin dex. dhe një zonë konsolidimi në lobin superior të djathë, lateralisht. Diagnoza e mundëshme:

- A) Tbc
- B) Metastazë karcinomatoze
- C) Sarkoidozë
- D) Granuloma e Wegener

41. M 65 vjeç, ka kollë, dispne. Pulmone me reale bronkiale, subkrepitante, sibilanca. Ro: fibrozë pulmonare difuze, trashje dhe kalcifikime pleurale bilaterale. Diagnoza e mundëshme:

- A) Pneumokoniozë
- B) Ca bronkial
- C) Bronshit kronik
- D) Astmë bronkiale

42. M 14 vjeç, ka kollë dhe infeksione të përsëritura pulmonare, gishta tamburi, rënie në peshë, steatorhe. Rodiografi: trashje të mureve bronkiale, hije në formë rrathi të bronkektazisë si dhe hije të shpërndara në pulmone. Diagnoza e mundëshme:

- A) Bronshit kronik
- B) Pneumoni atipike
- C) Astmë bronkiale

D) Fibroza kistike

43. Stjuardesë 34 vjeçë, ka 7 ditë me temperaturë, kollë të thatë, dispne, takipne. Në auskultim respiracion i pastër. Diagnoza e mundëshme:

- A) grip
- B) Mykoplasma pneumonie
- C) Pneumoni atipike
- D) Astme bronkiale

44. M 65 vjeç me kollë kronike produktive, vjen në urgjencë me dispne, dhe i përgjumur. Pulmone me rale bronkiale, sibilanca, ulje e lëvizshmërisë së pulmoneve. Diagnoza e mundëshme:

- A) Ca bronkial
- B) Bronshit kronik
- C) Pneumokoniozë
- D) Astme bronkiale

45. M 55 vjeç zgjohet me dispne, kollë me pështymë me shkumë, ka kaluar IAM 2 javë më parë. Ka takipne, cianotik, rale krepitante në pulmone. Diagnoza e mundëshme:

- A) Pneumoni atipike
- B) Trombemboli pulmonare
- C) Edemë pulmonare akute
- D) Astme bronkiale

46. F 25 vjeç, ka adenopati në qafë, temperaturë, djersë natën, rënie në peshë. Biopsia e limfonodulit: ka qeliza të mëdha me dy bërthama, imazhi i pasqyrës, qelizat e Reed- Sternberg. Diagnoza e mundëshme

- A) Mononukleoza infektive
- B) Morbus Hodgkin
- C) Leukemi akute
- D) Sarkoidoze

47. M 70 vjeç, përdor omnik për adenomën e prostatës. Ka dhimbje mesi dhe kockash, anemi, insuficiencë renale. Mielograma ka qeliza plazmatike 38 %. Diagnoza e mundëshme

- A) Miёlome multiple
- B) Leukemi akute
- C) Metastaza kockore nga ca prostate
- D) Leukemi mieloide kronike

48. M 18 vjeç, ka dobësi, zbehje, zverdhje të syve, urinim me ngjyrë të errët dhe anemi. Lieni preket 10cm. Gjaku periferik, Hb 7 gr/dl. Në serinë e kuqe: hypokromi dhe mikrocitozë e shprehur, ka qeliza target, anizocitosis dhe poikilocitosis të shprehur si dhe retikulocite të larta. Diagnoza e mundëshme:

- A) Thalasemi major
- B) Leukemi akute
- C) Hepatit viral akut
- D) Drepanocytosis

49. F 35 vjeçë, ka anemi, rënie të flokëve, ragade në këndet e buzëve. Gjaku periferik: hipokromi, mikrocitozë e eritrociteve.

Diagnoza e mundëshme

- A) Anemi nga mungesa e acidit folik
- B) Anemi nga mungesae vit.B12
- C) Anemi hemolitike
- D) Anemi nga mungesa e hekurit

50. Burrë 75 vjeç, ka dhimbje kockash. Preken, Shpretka 14 cm, hepari 7cm. Gjaku periferik: er 4000000, HB 13 gr/dl, Tb 730.000 mm³, leukocite 300.000 mm³, Formula: (bl 3%, PM 10%, MC 17%, MM 20/, SH 10%, Seg 20%, eo7%, Ba 3%, Limfocite 10%. Diagnoza e mundshme

- A) Leukemi limfoblastike akute
- B) Leukemi mieloide kronike
- C) Mononukleoze infektivi
- D) Leukemi mieloblastike akute

51. Mashkull 23 vjeç, ankon për temperaturë 38 gradë, dhimbje kockash, vështirësi në gëlltitje. Ka anjinë Ulçero-nekrotike, lieni 4 cm. Gjaku periferik anemi, trombocitopeni, leukociti 26.000, ka 34% blaste. Në disa blaste ka trupza Auer. Diagnoza e mundshme

- A) Leukemi limfoblastike akute
- B) Leukemi myeloide kronike
- C) Leukemi myeloblastike akute
- D) Mononukleoze infektive

52. M 55 vjeç, ka dhimbje të fortë në sternum dhe marrje fryme. Frekuenca kardiake 40/ min., ECG: dhëmbë Q dhe rritje të ST në D III, DII, AVF. Mjekimi i mundshëm:

- A) Adalat
- B) Lanatosid c
- C) Atropine
- D) Atenolol

53. M 20 vjeç, kthehet nga udhëtimi jashtë shtetit. Ka dispne dhe shqetësim në gjoks në anën e majtë. Radiografia: ka një zonë të vogël në apexin e pulmonit të majtë pa ind pulmonar. Diagnoza e mundëshme

- A) Aneurizëm disecante e aortës
- B) Emboli pulmonare
- C) Tbc
- D) Pneumotoraks nga tensionimi
- E) Inseficiencën mitrale

54. Grua 60 vjeçe, pasi ngrihet nga banja pati marrje fryme shumë të theksuar, dhimbje të fortë gjoksi, hemoptizi. ECG takikardi sinusale. Diagnoza e mundëshme:

- A) Pneumotoraks spontan
- B) Trombemboli pulmonare
- C) Infarkt akut i miokardit
- D) Mediastinit

55. Grua 60 vjeçe me artrit rheumatoid ka splenomegali. Në gjakun periferik leukociti 1500 mm³. Diagnoza e mundëshme:

- A) Sindroma Felty
- B) LMC
- C) Lymphomë malinje

D) Cirozë e heparit

56. M 60 vjeç. Para 15 vitesh ka kaluar hepatit viral B. Paraqitet me hematemezë masive dhe gjendje shoku. Ka ascit. Shkaku i hematemezes:

- A) Ulçer peptike kronike
- B) Cancer i stomakut
- C) Varicet e esofagut
- D) Sindroma Mallory- Weiss

57. Grua 50 vjeçe, njihet se vuan nga karcinoma e gjirit. Ajo paraqet të përziera dhe të vjella akute, polidipsi, konfusion, përgjumësi. Cilin është eksaminimi më dallues për diagnozë:

- A) Calcemi
- B) Glicemi
- C) Azotemi, kreatinine, elektolitë
- D) Testet e tyroides

58. Mashkull 30 vjeç, ka vite që në pranverë dhe vjeshtë ka dhimbje barku sidomos nga mesi i natës që e zgjojnë nga gjumi. Aktualisht ka dhimbje epigastrike shumë të fortë, të menjëherëshme, dhimbje në shpatullën e majtë dhe të vjella. Nuk dëgjohen zhurma perisaltike. Cili është ekzamini më dallues për diagnozë:

- A) Azotemi, kreatinine, elektolitë
- B) Gjak komplet
- C) ECHO abdominale
- D) Eksaminim radiologjik i toraksi në pozicion vertikal

59. Djalë 25 vjeç, ankon për dhimbje anale, shkarkime me gjak dhe mukus. Në eksaminimin objektiv ka cikatrice të shumta punktiforme rreth anusit. Cila është diagnoza më e mundëshme:

- A) Fistula në sëmundjen e Chron's
- B) Fisura në anus
- C) Koliti Ulçeros
- D) Karcinoma e rektumit

60. Burrë 70 vjeç, paraqet hemoragji rektale të pa dhimbëshme. Gjaku është në formën e rremave në fece. Ai ankon për tënësma. Në tushe rektale palpohet një masë e butë, e fiksuar, e pa dhimbëshme. Nuk preken limfonoduj inguinalë. Cila është diagnoza më e mundëshme:

- A) Karcinoma e kolonit
- B) Karcinoma e rektumit
- C) Hemorhoidet
- D) Karcinoma e anusit

61. Burrë 75 vjeç, ankon për dhimbje epigastrike dhe defekim me ngjyrë të zezë (melenë) me fece pothuajse të formuara, ka rënë në peshë. Ka një lifonodul të zmadhuar në regionin supraklavikular të majtë. Cila është diagnoza më e mundëshme:

- A) Karcinoma e kolonit
- B) Ulçer e stomakut
- C) Ulçer e duodenit
- D) Karcinoma e stomakut

62. Femër 30 vjeçë, ankon për dhimbje shumë të fortë të menjëherëshme të shpinës. Ajo udhëton me skoliozë kompتابore. Në eksaminim, ajo ka dhimbje nga gluteusi tek kyci i këmbës, humbje të ndjeshmërisë së shputës, dhe pulpës së këmbës së majtë. Cila është diagnoza më e mundëshme:

- A) Prolaps lumbar dhe sciatica
- B) Stenoza spinale
- C) Mieloma multiple
- D) Spondilolistesis

63. Burrë 50 vjeç, ankon për dhimbje të shpinës që përhapet drejt të dy anësive. Dhimbja përkeqësohet nga ecja dhe qetësohet nga pushimi dhe përkulja përpara. Në eksaminim, ai ka kufizim të ngritjes lart të këmbës së shtrirë dhe mungesë të reflekseve të kyceve të këmbës.

Cila është diagnoza më e mundëshme:

- A) Stenoza spinale
- B) Osteoartrit
- C) Prolaps lumbar dhe sciatica
- D) Spondiliti ankilozant

64. Grua 50 vjeçë, ankon për dhimbje shpine. Ajo ka anemi normokrome, normocitare me sediment shumë të lartë. Proteina totale 11 gr/dl. Cila është diagnoza më e mundëshme:

- A) Stenoza spinale
- B) Mieloma multiple
- C) Prolaps lumbar dhe sciatica
- D) Spondiloarthrosis

65. Burrë 67 vjeç, ka dhimbje mesi sidomos gjatë ecjes. Është i zbehtë, ka azotemi të lartë. Proteinuria Bence -Jonce pozitiv. Cila është diagnoza më e mundëshme:

- A) Prolaps lumbar dhe sciatica
- B) Stenoza spinale
- C) Mieloma multiple
- D) Metastaza kockore

66. M 60 vjeç, ankon për dhimbje të kockave, të shpinës në regionin lumbar dhe në kofshët e tij. Fosfataza alkaline serike 1000 u/L. Calciumi dhe phosphori janë normal. Pacienti ka vështirësi me dëgjimin. Cila është diagnoza më e mundëshme:

- A) Sëmundja e Paget
- B) Stenoza spinale
- C) Prolaps lumbar dhe sciatica
- D) Mieloma multiple

67. M 50 vjeç, ankon për dhimbje të forta të kockave sidomos të shpinës që e zgjojnë nga gjumi. Ka të përziera, të vjella. Objektivisht, në palpim epigastri duket i zënë. Në eksaminimin radiologjik duke dëmtime osteolitike të vertebrave. Fosfataza alkaline dhe Eritrosedimenti janë i lartë. Cila është diagnoza më e mundëshme:

- A) Mieloma Multiple
- B) Metastaza në kocka
- C) Stenoza spinale
- D) Spondilolistesis

68. M 68 vjeç, ankon për dhimbje shpine dhe kockash. Ka djegie gjatë urinimit dhe vështirësi në urinim. Urina komplet nuk ka shenja të infekzionit. Fosfataza alkaline e lartë. PSA e rritur. Gjaku komplet: leuko-erithroblastik, sediment i lartë. Cila është diagnoza më e mundëshme:

- A) Sëmundja e Paget
- B) Mielomë multiple
- C) Prolaps lumbar dhe sciatica
- D) Metastaza kockore nga ca prostate

69. Burrë 60 vjeç, paraqet tremor, djersë dhe gjendje të fiki në mëngjes. Zgjidh eksaminimin më dallues për diagnozë:

- A) Tensioni arterial
- B) ECG me 12 lidhje
- C) glicemi
- D) CT e kokës

70. F 65 vjeç, me insuficiencë renale kronike, paraqet kriza tetanie dhe të fikët. Ajo ankon për krampe në anësi dhe mpirje rreth gojës. Zgjidh eksaminimin më dallues për diagnozë:

- A) glicemi
- B) gjak komplet
- C) kalcemi
- D) urinë komplet

71. F 40 vjeçe, ka fibromë të ovarit, hidrotoraks të djathë dhe ascites. Cila është diagnoza më e mundshme:

- A) Sindromi Budd-Chiari
- B) Pseudomiksoma peritoneale
- C) Sindromi Meig's
- D) Peritonit tuberkular

72. F 25 vjeçe, ka të përziera, të vjella, dhimbje abdominale. Objektivisht ka hepatomegali të dhimbëshme dhe ascit. Kohët e fundit ajo ka filluar përdorimin e kontraceptivëve oralë.

Cila është diagnoza më e mundshme:

- A) Sindromi Meig's
- B) Sindromi Budd-Chiari
- C) Trombozë e venës porta
- D) Peritonit tuberkular

73. M 30 vjeç, zhvillon ascites dhe dhimbje kolike në kuadratin e djathë të poshtëm. Likidi ascitik ka natyrë viskoze dhe mukoide. Cila është diagnoza më e mundshme:

- A) Pseudomiksoma peritoneale
- B) Shtypja e venës porta nga limfonodujt
- C) Pamjaftushmëri e zemrës së djathë
- D) Peritonit tuberkular

74. F 40 vjeçe, ka ascit. Në anamnezë, ka kaluar ethe rheumatizmale. Në auskultim, ka një ton të dytë pulmonar të lartë. Volumi i pulsit në arteriet periferike i ulët. Cila është diagnoza më e mundshme:

- A) Cirrhosis
- B) Shtypja e venës porta nga limfonodujt
- C) Pamjaftushmëri e zemrës së djathë si pasojë e stenozës mitrale

D) Peritonit tuberkular

75. F 50 vjeçë, ka ascites, dobësi. Ajo ka puls të crregullt, të shpejtë, me volum të vogël. Eksaminimi radiologjik tregon zemër të vogël me kalcifikime që duken në projeksionin lateral. ECG demonstron QRS me voltazh të ulët dhe valë T të invertuara. Cila është diagnoza më e mundshëme:

- A) Pamjaftushmëri e zemrës së djathtë si pasojë e stenozës mitrale
- B) Cirrhosis
- C) Perikarditi constriktiv
- D) Peritonit tuberkular

76. F 40 vjeçë, pas lëvizjes së një tavoline të rëndë ka dhimbje të shpinës; ajo nuk ka shenja të prekjes së rrënjos nervore. Cili është trajtimi më i përshtatshëm:

- A) Referim urgjent te ortopedi/ neurukirurgu
- B) Dy ditë pushim + analgjezikë
- C) Regjim shtrati për dy javë
- D) Radiografi toraksi

77. F 50 vjeçë, ankon për dhimbje shpine që 2 muaj, që përkeqësohen natën. Radiografia tregon frakture kompresive të dy vertebrave pa shkak traumatik. Cila është trajtimi më i përshtatshëm:

- A) Eksaminime të mëtejshme për tumor apo pathologji të tjera kockore
- B) Referim urgjent te ortopedi për dekomprimim nervi
- C) Regjim shtrati për dy javë
- D) Fizioterapi

78. M 60 vjeç, ka dhimbje shpine që përhapet poshtë të dy gjunjëve bilateralisht. Në eksaminim, ka anestesi të "shalës", inkontinencë urine dhe humbje të tonusit anal. Cili është trajtimi më i përshtatshëm:

- A) ECHO abdominale
- B) Eksaminime të mëtejshme për tumor apo pathologji të tjera kockore
- C) Referim rutinë te neurokirurgu/ ortopedi
- D) Referim urgjent tek neurokirurgu për dekomprinim kirurgjikal urgjent

79. F 50 vjeçë, ankon për dhimbje kronike mesi që përhapen drejt gluteuseve. Vjen shpesh në ambulancë për dhimjen e mesit. Nuk ka prekje të rrënjos nervore. Cila është trajtimi më i përshtatshëm:

- A) Fizioterapi
- B) Eksaminime të mëtejshme për tumor apo pathologji të tjera kockore
- C) Referim rutinë te neurokirurgu/ ortopedi
- D) Referim urgjent tek neurokirurgu

80. M 30 vjeç, ankon për dhimbje shpine që përhapet poshtë gjurit. Në eksaminim ka humbje të ndjeshmërisë lateralisht pulpës së djathtë dhe medialisht këmbës së djathtë. Nuk bën dot dorsifleksionin e gisshit të madh. Ai ka qëndruar regjim shtrati për 6 javë. Cili është trajtimi më i përshtatshëm:

- A) Referim urgjent tek neurokirurgu
- B) Referim rutinë te neurokirurgu/ ortopedi
- C) Eksaminime të mëtejshme për tumor apo pathologji të tjera kockore
- D) Fizioterapi

81. M 26 vjeç, ka një fyrje (xhungë) të pa dhimbëshme që 6 javë në testin e majtë. Nuk ka adenopathi inguinale. Alfa fetoproteina është e lartë. Cila është diagnoza më e mundëshme

- A) Torsion i testit
- B) Hydrocele
- C) Epididimo-orkit akut
- D) Tumor i testit

82. Fëmijë 6 vjeç, ka hematuri të padhimëshme, afebril, dhe edemë skrotale që 2 ditë. Porcioni i mesit të urinës ka mbetje granulare. Cila është diagnoza më e mundëshme

- A) Nekrozë tubulare akute
- B) Pielonefrit akut
- C) Isuficiencë renale kronike
- D) Epididimo-orkit akut

83. M 70 vjeç, ka pakësim të urinimit, urinim natën, është i zbehtë, ka edema në anesi, ascit, TA 170/100 mmHg. Cila është diagnoza më e mundëshme

- A) Karcinomë e prostatës
- B) Isuficiencë renale kronike
- C) Nekrozë tubulare akute
- D) Karcinomë e veshkës

84. M 75 vjeç, ankon për urinim të shpeshtë natën, dhimbje shpine. Preket glob vezikal, dhe në tushe rektale prostatë e zmadhuar. Fosfataza alkaline dhe acide në serum janë të rritura. Cila është diagnoza më e mundëshme

- A) Insuficiencë renale kronike
- B) Karcinomë e prostatës
- C) Karcinomë e veshkës
- D) Karcinome e vezikes

85. Fëmijë 12 vjeç paraqetën njëjtë, skuqje, dhimbje të skrotumit. Porcioni i mesit të urinës është normal. Cila është diagnoza më e mundëshme

- A) Tumor i testit
- B) Hydrocele
- C) Torsion i testit
- D) Epididimo-orkit akut

86. Femijë 10 vjeç, ka stridor. Ai ka histori të njëjtjes së duarve dhe këmbëve si dhe diarhe. Të njëjtën histori e ka edhe e motra. Cila është diagnoza më e mundëshme

- A) Ethe rheumatizmale akute
- B) Angloedema hereditare
- C) Sindrom nefrotik kongenital
- D) Insuficiencia kardiakongestive

87. Vajzë 6 vjeçe, ka temperaturë që ngrihet e ulet (temp. me majë), enjte të artikulacioneve të gishtave. Gishtat e fryrë kanë marrë formë boshti. Cila është diagnoza më e mundëshme

- A) Ethe rheumatizmale akute
- B) Artrit rheumatoid juvenil
- C) Angloedema hereditare
- D) Sinovit toksik

88. Djalë 12 vjeç, paraqet poliartrit dhe dhimbje abdominale. Ai kishte bajamet e sëmura rreth 2 javë para. Në buzën e anës së majtë të sternumit dëgjohet zhurmë e hershme diastoloke shfryrëse. Cila është diagnoza më e mundëshme

- A) Sindrom nefrotik kongenital
- B) Ethe rheumatizmale akute
- C) Arhrit rheumatoid forma juvenilde
- D) Insuficiencia kardiake kongestive

89. Vajzë 12 vjeçe, ka zbehje, dispne, puls 190/1'. Ajo ka hepatomegali dhe cardiomegali, edema në anësi. Cila është diagnoza më e mundëshme

- A) Perikardit
- B) Insuficiencia kardiake kongestive
- C) Myokardit
- D) Sindrom nefrotik kongenital

90. Femër 18 vjeçe, nulipare, 12 javëshe; do të përfundojë shtatzaninë. Zgjidh trajtimin më të mirë:

- A) histerectomi e thjeshtë
- B) Kolposkopi
- C) Antibiotikë iv
- D) Dilatacion dhe kyretazh

91. Plakë 70 vjeçe, ka 3 muaj me hemoragji vaginale. Histeroskopja dhe biopsia e endometrit konfirmojnë adenokarcinomë. Zgjidh trajtimin më të mirë:

- A) histerectomi e thjeshtë
- B) Kolposkopi
- C) Histerekomi totale abdominale, salpingo- oophoroectomy bilaterale
- D) Dilatacion dhe kyretazh

92. Grua 30 vjeçe, vjen në ambulancë më dhimbje të fortë në anën e majtë të barkut dhe shpatullës së majtë. Para dy muajsh ka ndaluar kontraceptivët dhe ka dy muaj pa cikël menstrual. TA 90/50 mmHg, pulsi 120/1'. Zgjidh trajtimin më të mirë:

- A) histerectomi e thjeshtë
- B) Histerekomi totale abdominale, salpingo- oophoroectomy bilaterale.
- C) Dilatacion dhe kyretazh
- D) Reanimim urgjent dhe loparatomia.

93. Grua 30 vjeçe, nulipare, ankon për infertilitet. Ajo ka perioda të rregullta, zgjatin 8 ditë e me sasi të shtuar. Ajo dhe bashkëshorti kanë një vit që tentojnë për shtatëzani. Burri ka bërë vizitë te urologu dhe nuk ka probleme dhe ajo kërkon të dijë në se defekti është te ajo. ECHO tregon fibrinoidë uterinë subserozë. Zgjidh trajtimin më të mirë:

- A) Dilatacion dhe kyretazh
- B) Reanimim urgjent dhe loparatomia.
- C) Laparaskopi
- D) Testi Papanicolou

94. Grua 28 vjeçe, ka eksaminim jo normal të qafës së mitrës. Ajo ka condilomë dhe displazi të moderuar. Zgjidh trajtimin më të mirë:

- A) Antibiotikë iv+ flagyl ovul
- B) Colposkopi e ndjekur nga krem 5- Fluouroucil apo excizion me diatermi

- C) Dilatacion dhe kyretazh
- D) Cone biopsi

95. Fëmijë dy vjeç, ka anemi, dhimbje barku. Nëna thotë se e ka parë të gërvishtë muret dhe ka frikë se ha gelqere nga suvaja. Diagnoza më e mundëshme

- A) Skizofreni
- B) Delirium
- C) Pica clorotica
- D) Fuga

96. Grua 23 vjeçë, ka frikë të lërë shtëpinë e vet. Ajo funksionon (sillet) normalisht vec mos daljes jashtë shtëpisë së saj. Diagnoza më e mundëshme

- A) Skizofreni
- B) Algophobia
- C) Delirium
- D) Agaraphobia

97. M 18 vjeç, ka diarhe, djersitje, të përziera, pupila të zgjeruara, ngritje të TA. Ai ka qënë përdorues dhe ka pasur vartësi nga drogat. Diagnoza më e mundëshme

- A) Intoksikim nga cocaine
- B) Lënia e opoidëve (krizë abstinence)
- C) Delirium
- D) Intoksikim nga drogat

98. F 30 vjeçë, është gjetur në një gjendje amnesie. Burri i saj referon se ka disa ditë që ka humbur, që kur mori letrën e divorcit. Diagnoza më e mundëshme

- A) Skizofreni
- B) Intoksikim nga alkoli
- C) Delirium
- D) Fuga

99. M 30 vjeç, me crregullime bipolare nën mjekim me litium. Kohët e fundit mjeku i familjes i ka nisur hydrochlorthiasid për një tension arterial të moderuar. Aktualisht ai është konfus, me ataxi, mjegullim të pamjes, tremor jo fin. Diagnoza më e mundëshme

- A) Intoksikacion nga cocaine
- B) Intoksikacion medikamentos
- C) Perdorim opiatesh
- D) Lënia e alkolit

100. F 28 vjeçë, ankon për dhimbje të fundit të barkut. Objektivisht ka shumë cikatrikse kirurgjikale në abdomen. Objektivisht, abdomeni dhe pelvisi normal. Ajo këmbëngul se ka nevojë për laparaskopi. Diagnoza më e mundëshme

- A) Sindromi Munchausen
- B) Skizofreni
- C) Delirium
- D) Neurozë histerike

101. M 54 vjeç, skizofrenik, ka nisur haloperidol. Një muaj pas fillimit ai ka jargë, ecën duke hequr këmbët zvarrë. Ai vuan gjithashtu nga lëvizje përtypëse të pa vullnetshme. Diagnoza më e mundshme

- A) Efekte anësore autonomike të medikamentit
- B) Efekte extrapiramidale të meddikamentit
- C) Efekte anësore antikolonergjike të med.
- D) Neurosis

102. F 40 vjeçë, ankon për tharje të gojës, turbullime të pamjes, konstipacion. Objektivisht ka zgjerim të pupilave. Ajo ka nisur amitiptilinë për depresion madhor.

Diagnoza më e mundëshme

- A) Efekte anësore autonomike të medikamentit
- B) Neurosis
- C) Efekte extrapiramidale të meddikamentit
- D) Efekte anësore antikolonergjike të med.

103. M 45 vjeç, ka dhimbje koke, etje të theksuar, urinim të shpeshtë. Ai ka pucrra (akne të theksuara), lëkurë të ashpër, strumë. Diagnoza më e mundëshme

- A) Hypothyroidism
- B) Sindrom Cushing
- C) Neurosis
- D) Akromegali

104. M 30 vjeç, paraqitet tek mjeku i familjes se ka nxjerrë shpatullen. Në eksaminim, shpatulla është në rregull. Nuk ka dislokacion të saj, por pacienti këmbëngul se e ka të nxjerrë. Diagnoza më e mundëshme

- A) Depresion
- B) Skizofreni
- C) Simulant
- D) Neurosis

105. M 25 vjeç, ka 5 ditë me temperaturë të lartë, dhimbje koke sidomos në regionet temporale, diarhe, njolla rozë në trunk. Ju dyshoni për tifo. Cilin eksaminim do të kërkonit për diagnozë:

- A) Paul Bunnell
- B) ELISA
- C) Weil-Felix
- D) Widal

106. Blegtor nga Saranda, ka 12 ditë me temperaturë ondulante, djersë të shtuara, me erë të rëndë, dhimbje kockash. Lieni 2 cm, hepari 2 cm. Gjaku periferik leukocite 3800 mm^3 , deviacioni i majtë, lifo- monocitosi relative. Cilin eksaminim do të kërkonit për diagnozë:

- A) Wright
- B) Widal
- C) Weil-Felix
- D) Paul Bunnell

107. M 23 vjeç, paraqet rash makulopapular në shputat e këmbëve dhe papula anale. Cilin eksaminim do të kërkonit për diagnozë:

- A) VDRL (Slide test i laboratorit të sëmundjeve veneriane)
- B) Wright
- C) Widal
- D) Paul Bunnell

108. M 30 vjeç, ankon për ethe, zverdhje, dhimbje të pulpave. Ai është i apasionuar pas notit. Ju dyshoni për sëmundjen e Weil. Cilin eksaminim do të kërkonit për diagnozë:

- A) Widal
- B) Wright
- C) ASO
- D) Testi i aglutinimit Schuffner

109. F 20 vjeç, ankon për dhimbje fytit, temperaturë, adenopati në qafë, petikie në palatum. Cilin eksaminim do të kërkonit për diagnozë:

- A) Widal
- B) Wright
- C) Paul Bunnell
- D) Weil-Felix

110. M 60 vjeç, ka dhimbje gjoksi, dispne. ECG: bradikardi sinusale, 45 rrahje/1min. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm:

- A) Pacemaker transvenos
- B) Pacemaker extern
- C) Atropinë IV
- D) Oksigjeno terapi

111. M 60 vjeç, pëson kolaps në rrugë. Nuk e ka parë njeri si ndodhi. Aktualisht ai nuk ka puls. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm:

- A) Atropinë iv
- B) CRP (Ringjallje zemër- mushkëri), adrenalinë iv 1:1000 push
- C) Oksigjeno terapi
- D) CRP (Ringjallje zemër- mushkëri) derisa të jetë gati defribulatori.

112. F 55 vjeç, ka ritëm të ngadaltë, por është asimptomatike. ECG tregon mos përputhje midis ritmit atrial dhe ventrikular. Ritmi ventrikular është 40 rrahje/ min. Komplekset QRS janë të zgjeruara. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm:

- A) Pacemaker transvenos
- B) Godditje me grusht në sternum
- C) Atropinë iv
- D) Defibilim me 200 Joules

113. M 30 vjeç që praktikon numra shpejtësie, është gjetur pa koshiençë në skenë. Në ambulancë ai bën frymëmarje në mënyrë spontane. Monitori ECG tregon ritëm të crregullt ku nuk dallohen valët P,QRS, ST, T. Ritmi është i shpejtë. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm:

- A) CRP (Ringjallje zemër- mushkëri) derisa të jetë gati defribulatori.
- B) CRP (Ringjallje zemër- mushkëri), adrenalinë iv 1:1000 push
- C) Atropinë 1mg iv push
- D) Oksigjeno terapi

114. M 53 vjeç, vjen në ambulancë me dhimbje shumë të fortë gjoksi. Ai ka pasur histori të anginës. Dhimbja nuk qetësohet nga trinitrina. TA 120/70mmHg, ritmi 100 rrahje 1/min. ECG: ritëm sinusal. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm:

- A) Morfinë im + Oksigjeno terapi 4 LPM
- B) Atropinë 1mg iv bolus
- C) CRP (Ringjallje zemër- mushkëri), adrenalinë iv 1:1000 push

D) Lignocaine iv

115. M 50 vjeç, vjen në ambulancë se ka infarkt akut të miokardit. Pa pritur, TA bie 70/45mmHg. Në të dy bazat pulmonare dëgjohen rale. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm:

- A) Infuzion Dopaminë
- B) Morfinë im + Oksigjeno terapi 4 LPM
- C) CRP (Ringjallje zemër- mushkëri), adrenalinë iv 1:1000 push
- D) Atropinë 1mg iv bolus

116. M 50 vjeç, në ECG (monitor)ka takikardi paroksismale supraventrikulare. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm:

- A) Lignocainë
- B) Trinitrinë
- C) Masazh i sinusit carotid
- D) Addrenalinë

117. M 50 vjeç, vjen me dispne. Pulsi është i rrregullt në frekuencë dhe ritëm. Skopia tregon cardiomegali dhe zmadhim të atriumit të majtë. ECG: fibrilacion atrial me frekuencë 180/min. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm:

- A) Atropine
- B) propranolol
- C) Antikoagulum + digitalizim
- D) Lignocaine iv

118. M 75 vjeç, humb pa pritur koshiencën në ambulancë. ECG tregon takikardi ventrikulare. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm:

- A) Atropinë 1mg iv bolus
- B) Morfinë im + Oksigjeno terapi 4 LPM
- C) Convertim cardiak me Defibrilator me 200 joules
- D) Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm:

119. F 20 vjeçe, ka diare rekurrente me gjak dhe krampe abdominale. Sigmoidoskopia dhe biopsia konfirmojnë diagnozën: kolit Ulçeros. Zgjidh mjekimin më specifik

- A) Subtotal colectomy, fistul mukozale dhe ileostomi permanente
- B) likide iv, antibiotikë iv dhe analgjezikë
- C) Panproctocolectomy
- D) Mesalazinë

120. M 25 vjeç, gjatë bërjes të një numri shpejtësie ka pësuar një traumë të topit të pjesën e sipërme të abdomenit. Ai ka dhimbje në shpatullën e majtë dhe dhjimbje abdominale difuze. Ai paraqet takikardi në irritje, hypotension dhe shfaqen shenja peritoneale. Zgjidh mjekimin më specifik

- A) Panproctocolectomy
- B) Likide iv, antibiotikë iv dhe analgjezikë
- C) Laparatomy
- D) Cholecystectomy me laparoskop

121. F 40 vjeçe, obeze ankon për dhimbje në kuadratin e sipërm të djathë, temperaturë të lartë. Leukocite 14 000mm³ me deviacion të majtë e neutrofilozë. Eksaminimi radiologjik i pulmonit dhe abdomenit është negativ. Zgjidh mjekimin më specifik

- A) Likide IV, antibiotikë IV dhe analgjezikë
- B) Laparatomia
- C) Panproctocolectomy
- D) Cholecystectomy me laparoskop

122. F 50 vjeç, ka ethe, dhimbje në kuadratin e sipërm të djathë të abdomenit, ikter. ECHO: dilatacion i duktusit biliar komun. Zgjidh mjekimin më specifik

- A) Likide iv, antibiotikë iv dhe analgjezikë
- B) ERCP dhe sfinkterotomi endoskopike
- C) Panproctocolectomy
- D) Cholecystectomy me laparoskop

123. M 30 vjeç, ka dhimbje shumë të forta abdominale të pa dominuara. Ai ka temperaturë, takikardi dhe distension të shprehur të barkut. Në eksaminimin radiologjik koloni transvers ka diametër 7 cm. (Megakolon toksik). Zgjidh mjekimin më specifik

- A) Mesalazinë
- B) likide iv, antibiotikë iv dhe analgjezikë
- C) Subtotal colonectomy, fistul mukozale dhe ileostomi permanente
- D) Panproctocolectomy

124. M 40 vjeç, ankon për dhimbje të penisit. Objektivisht, lafsha është e tërhequr pas glans penis dhe ka enjtje glandulare. Diagnoza më e mundëshme:

- A) Sëmundja Peroni (Peyronie's)
- B) Kondiloma
- C) Paraphimosis
- D) Priapism

125. Fëmijë 12 vjeç, me histori të infeksioneve urinare të përsëritura, aktualisht ka vështirësi në urinim. Objektivisht, hapja e lafshës është e ngushtë dhe e skuqur. Diagnoza më e mundshme:

- A) Sëmundja Peroni (Peyronie's)
- B) Priapism
- C) Kondiloma
- D) Phimosis

126. M 50 vjeç me insuficiencë renale kronike, trajtohet me dializë; vjen tek mjeku i familjes se ka dhimbje të penisit. Objektivisht penisi është në ereksion: trupat kavernozi janë erektë, corpus spongios është i flashkët. Diagnoza më e mundëshme:

- A) Sëmundja Peroni (Peyronie's)
- B) Paraphimosis
- C) Priapism
- D) Balanitis xerotica obliterans

127. M 40 vjeç, me tyroidit Reidel, ankon se kontakti seksual është i dhimbshëm. Ai ka sjellë një foto ku duket curvatura e penisit në ereksion. Diagnoza më e munddëshme:

- A) Kondiloma
- B) Paraphimosis
- C) Sëmundja Peroni (Peyronie's)
- D) Priapism

128. M 52 vjeç, vjen tek mjeku sepse nuk arrin dot ereksion. Kohët e fundit ai ka bërë prostat ectomi totale. Diagnoza më e mundëshme:

- A) Sëmundja Peroni (Peyronie's)
- B) Paraphimosis
- C) Priapism
- D) Impotencë

129. F 30 vjeçe, paraqet një masë 3 cm, të fortë, të lëmuar, të pa adderuar me lëkurën. Citologjia realizuar me citopunksion të drejtuar nuk ka qeliza malinje. Diagnoza më e mundëshme

- A) Fibroadenoma
- B) Abces i gjirit
- C) Displazia mamare beninje
- D) Dukt ektasia

130. F 20 vjeçe, ankon se para ciklit ka gjëndra në gjinj dhe ka dhimbje të gjoksit. Në eksaminim gjokset janë të ndjeshëm në kuadratet e jashtëme me disa nodularitete. Citologjia me punksion të drejtuar tregoi fibrosis, adenosis dhe ndryshime cistike. Diagnoza më e mundëshme

- A) Displazia mamare beninje
- B) Fibroadenoma
- C) Sëmundja cistike
- D) Dukt ektasia

131. F 50 vjeçe, paraqet nodozitete të vogla të lëmuara diskrete të gjirit. Në aspirim doli lëng i verdhë. Citologjia nga Citopunksioni i drejtuarnuk ka qeliza malinje. Diagnoza më e mundshme

- A) Fibroadenoma
- B) Sëmundja cistike
- C) Displazia mamare beninje
- D) Duktekta

132. F 50 vjeçe, ankon për rrjedhje të vazhdueshme si gjizë nga thithi. Ajo ka vënë re tërheqje të thithit por nuk ka kokërr. Mamografia tregon ntrashje të duktusit. Diagnoza më e mundëshme

- A) Sëmundja cistike
- B) Dukt ektasia
- C) Displazia mamare beninje
- D) Fibroadenoma

133. F 65 vjeçe, ka karcinomë të gjirit; herë mbas here ka dhimbje barku. Ajo eleminon sasi të mëdha urine dhe pi ujë më shumë se zakonisht. Diagnoza më e mundëshme:

- A) Fibrozë post raddioterapi
- B) Diabetes mellitus
- C) Ankth
- D) Hypercalcemi

134. M 26 vjeç, vjen në urgjencë me dhimbje shumë të forta në ije që kanë 3 orë. Eksaminimi i urinës tregon hematuri. Diagnoza më e mundëshme:

- A) Kolikë renale
- B) cistitis
- C) Pielonefrit
- D) Hypercalcemi

135. F 33 vjeçë, kërkon vizitë shtëpie. Ajo flet për disuri për disa ditë, kurse tani ka ethe, dhimbje në ijen e djathtë. Diagnoza më e mundëshme:

- A) Hypercalcemi
- B) cistitis
- C) Kolikë renale
- D) Pielonefrit

136. M 38 vjeç, vjen për kontroll të zakonshëm. Ai ndihet mirë. BMI e tij është 24. TA 124/80 mmHg. Ai përmend se nëna e tij u diagnostikua si diabetike kur ishte 76 vjeç. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm:

- A) Të fillojë Metforminë
- B) Të fillojë hydrochlorthiasid
- C) Këshillim dietetik
- D) Të fillojë prep. të sulphanyluresë

137. M 60 vjeç, vjen se ka një glicemi të rastësishme 170mg/ dl dhe është i shqetësuar nëse është apo jo diabetik. Zgjidh trajtimin opsonin më të përshtatshëm:

- A) Të fillojë hydrochlorthiasid
- B) Testi i tolerancës së glukozës.
- C) Të fillojë sulphanylurenë
- D) Këshillim djetetik

138. Diabetik 60 vjeç; mer metformine 3x 0.5 në ditë. HbA1c vjetore është 8.8 dhe ju vini re se vitin e kaluar, në kohën kur nisi metforminën, ajo ishte 8.5. Pacienti referon se zakonisht nuk harron të marrë mjekimin. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm:

- A) Të fillojë insulinën
- B) Të fillojë hydrochlorthiasidin
- C) Këshillim djetetik
- D) Të fillojë prep. të sulphanyluresë (daonil)

139. Diabetik 58 vjeç. Ai e ka diabetin nën kontroll me djetë. Aktualisht paraqet TA 155/94 mmHg. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm:

- A) Të fillojë Metforminë
- B) Të fillojë glitazon
- C) Të fillojë preparate të sulphanyluresë
- D) Të fillojë hydrochlorthiasid

140. M 56 vjeç jo insulinovartës, trajtohet me glibenclamid. Ai ka rritje të moderuar të transaminazave si pasojë e përdorimit kronik abuziv të alkoolit, por aktualisht e ka lënë dhe hepari është stabël. HbA1c është duke u ngritur lart, (9,2) megjithëse merr dozën maksimale të glibenclamidit. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm:

- A) Këshillim djetetik
- B) Të fillojë hydrochlorthiasidit
- C) Të fillojë sulphanylurenë (daonil)
- D) Të fillojë insulinën

141. Vajzë astmatike 5 vjeçë, ndihet mirë duke përdorur 100µg beclomethason bd dhe salbutamol. Ajo ka një infeksion të sipërm respirator, por rrjedha kulmore e ajrit të saj (peak flow) vazhdon të jetë 80% e normales. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm

- A) Të fillojë beta2- agonistët me veprim të zgjatur

- B) Të vazhdojë të njëjtin trajtim
- C) Kërkohet të fillojë beta2- agonistët
- D) Të fillojë steroidët oralë

142. M 25 vjeç, përdor 200 μ g beclomethason bd dhe salbutamol sipas nevojës për të kontrolluar astmën. Muajt e fundit ai e ka përdorur salbutamolin ditën dhe natën e ka zgjuar nga gjumi kolla e thatë. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm

- A) Të vazhdojë të njëjtin trajtim
- B) Kërkohet të fillojë beta2- agonistët sipas nevojës
- C) Të fillojë beta2- agonistët me veprim të zgjatur
- D) Të fillojë steroidët oralë

143. Vajzë 15 vjeçe, është trajtuar për astmën e provokuar nga ushtrimet me terbutalinë sipas nevojës. Ajo e përdor atë mesatarisht 4 herë në javë. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm

- A) Kërkohet të fillojë beta2- agonistët
- B) Të fillojë beta2- agonistët me veprim të zgjatur
- C) Të vazhdojë të njëjtin trajtim
- D) Të fillojë steroidët oralë

144. M 51 vjeç, përdor 800 μ g beclomethason dita dhe eformoterol bd ai vjen te mjeku sepse ka kollë produktive me sputum mukopurulent, për të cilën ka nisur antibiotikë, si dhe dispne në sforcim të vogël. Rrjedha kulmore e ajrit (peak flow i tij) është 50% e vlerës së preddikuar. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm

- A) Të vazhdojë të njëjtin trajtim
- B) Të fillojë steroidët oralë
- C) Kërkohet të fillojë beta2- agonistët
- D) Të fillojë beta2- agonistët me veprim të zgjatur

145. Djalë 14 vjeç, ka filluar të ketë pak "Weezing" (frymëmarrje me fishkëllima) kur ai merr pjesë në gara sportive. Ai ka kollë të zgjatur pas virozave në dimër, por sidoqoftë ai ndihet mirë. Zgjidh trajtimin më të përshtatshëm

- A) Të vazhdojë të njëjtin trajtim
- B) Të fillojë beta2- agonistët me veprim të zgjatur
- C) Të fillojë steroidët oralë
- D) Kërkohet të fillojë të përdorë beta2- agonistët sipas nevojës

146. Fëmijë 3 vjeç, vetëm nga njëra vrimë e hundës ka rrjedhje me erë të keqe e të gjakosura. Cila është diagnoza më e mundëshme

- A) Hematomë septale
- B) Rinit alergjik
- C) Trup i huaj
- D) Rinit medikamentos

147. M 19 vjeç, është goditur në hunddë duke lozur si portier. Ai i ka të dy hundët e bllokuara. Në eksaminim ka një fryrje të kuqe të celur në linjën mediane që dallohet nga të dy dy vrimat e hundës. Cila është diagnoza më e mundëshme

- A) Trup i huaj
- B) Hematomë septale
- C) Rinit alergjik
- D) Rinit medikamentos

148. M 43 vjeç ,vuan nga bllokimi kronik i hudëve dhe rrjedhje. Ai ka përdorur shumë medikamente spray për muaj të tërë, por sheh që gjëndja është duke u pérkeqësuar. Cila është diagnoza më e mundshme

- A) Rinit medikamentos
- B) Rinit alergjik
- C) Hematomë septale
- D) Trup i huaj

149. M 78 vjeç, ka disa muaj me bllokim vetëm të anës së djathtë të hundës të shoqëruar me rrjedhje të gjakosura. Cila është diagnoza më e mundëshme

- A) Trup i huaj
- B) Rinit alergjik
- C) Carcinoma
- D) Hematomë septale

150. M 21 vjeç, ankon se cdo vit, në të njëjtën periudhë të vitit ka bllokim të hundëve shoqëruar me rrjedhje të ujshme të shumta. Cila është diagnoza më e mundëshme

- A) Rinit vazomotor
- B) Hematomë septale
- C) Rinit alergjik
- D) Rinit medikamentos

151. F 30 vjeçe, ankon për lodhje që ka ardhur duke u shtuar. Ajo ka 6 muaj me menstruacione të shtuara që kur lindi fëmijën e dytë. Cili është shkaku më i mundshëm

- A) Malinjitet
- B) Pamjaftueshmëria e zemrës
- C) Dobësia akute post virale
- D) Anemia

152. Grua 82 vjeçe, ka 6 javë me dobësi, rënie në peshë, diarhe. Cili është shkaku më i mundshëm

- A) Hypothyroidism
- B) Pamjaftueshmëria e zemrës
- C) Malinjitet
- D) Dobësia akute post virale

153. F 73 vjeçe, obeze, ka 2-3 muaj me loddhje, marrje fryme në sforcim. Ajo ka edema të lehta rrëth kyceve të këmbëve si dhe rale inspiratore krepitante në të dy bazat e pulmonit. Cili është shkaku më i mundshëm

- A) Isuficiencia renale
- B) Cirozë hepatike
- C) Pamjaftueshmëria e zemrës
- D) Miksedema

154. F 23 vjeçe, ankon për fryrjë barku dhe dhimbje që qetësohen pas defekimit. Pacientja defekon vetëm ditën. Nuk ka rënë në peshë. Cila është diagnoza më e mundëshme:

- A) Sëmundja inflamatore e zorrës
- B) Sëmundja e Celiakisë
- C) Hiperthyroidizmi
- D) Sindromi i zorrës së irritushme

155. F 25 vjeçe, ankon për diarhe që 4 muaj, ka rënë në pëshë, ndjen vapë, ka pagjumësi, tremor. Cila është diagnoza më e mundëshme:

- A) Sëmundja inflamatore e zorrës
- B) Sindromi i zorrës së irritushme
- C) Sëmundja e Celiakisë
- D) Hiperthyroidizmi

156. F 23 vjeçe, ka dirhe, rënie në peshë për pak muaj. Ajo ka një rash pruriginoz në të dy bërrylat. Cila është diagnoza më e mundëshme:

- A) Sëmundja e Celiakisë
- B) Sindromi i zorrës së irritushme
- C) Hiperthyroidizmi
- D) Malinjitet colo-rectal

157. M 80 vjeç, ka një javë me diarhe dhe krampe abdominale. Të njëjtën histori pati dhe gruaja, por asaj shqetësimet i zgjatën vetëm 2 ditë. Cila është diagnoza më e mundëshme:

- A) Gastrenterit infeksioz
- B) Sindromi i zorrës së irritushme
- C) Hiperthyroidizmi
- D) Sëmundja inflamatore e zorrës

158. M 67 vjeç, paraqet letargji të përgjithëshme, rënie në peshë, shpeshtim të defekimit që 4 muaj. Ka erithrosediment të lartë. Cila është diagnoza më e mundëshme:

- A) Sindromi i zorrës së irritushme
- B) Malinjitet kolorectal
- C) Hiperthyroidizmi
- D) Sëmundja e Celiakisë

159. M 67 vjeç, ka 2 muaj që është kaps, megjithëse përdor ushqime me fibra. Ka rënë në peshë. Nuk përdor medikamente që bëjnë kaps. Fece për gjak occult rezultoj pozitiv. Cila është diagnoza më e mundëshme:

- A) Sindromi i zorrës së irritushme
- B) Malinjitet colo-rectal
- C) Hiperthyroidizmi
- D) Sëmundja e Celiakisë

160. Cili mund të jetë efekti anësor fatal nga mbidoza e ferri sulphatit:

- A) Insuficiencë hepatike
- B) Konvulsione
- C) Insuficiencë respiratore
- D) Aritmi

161. Cili mund të jetë efekti anësor fatal nga mbidoza e paracetamolit

- A) Aritmi
- B) Insuficiencë hepatike
- C) Insuficiencë respiratore
- D) Insuficiencë kardiake

162. Cili mund të jetë efekti anësor fatal nga mbidoza e Diamorfinës

- A) Aritmi
- B) Insuficiencë respiratore
- C) Konvulsione
- D) Insuficiencë hepatike

163. Cili mund të jetë efekti anësor fatal nga mbidoza e acidit mefenamic (ponstanit):

- A) Aritmi
- B) Insuficiencë hepatike
- C) Insuficiencë respiratore
- D) Konvulsione

164. Cila është diagnoza më e mundëshme në qoftë se pacienti ka këto analiza:

- Biluribinë(N: <0.9) 5mg/dl
ALT (N: 5-35) 1250 U/L
FAL(fosfataza alkaline) (N: 30-300u/L) 500 U/L
Albumina g/l: normal
HB: normal
Retikulociti: normal
A) Anemia hemolitike autoimune
B) Ikter kolestatik
C) Sëmundje kronikë e mëlcisë nga alkoli
D) Hepatit viral akut

165. Cila është diagnoza më e mundëshme në qoftë se pacienti ka këto analiza:

- Biluribinë(N: <0.9) 10 mg/dl
ALT (N: 5-35) 195 U/L
FAL(fosfataza alkaline) (N: 30-300u/L) 900 U/L
Albumina g/l: normal
HB: normal
Retikulociti: normal
A) Hepatit viral akut
B) Anemia hemolitike autoimune
C) Sëmundje kronikë e mëlcisë nga alkoli
D) Ikter kolestatik

166. Cila është diagnoza më e mundëshme në qoftë se pacienti ka këto analiza:

- Biluribinë(N: <0.9) 4.5mg/dl
ALT (N: 5-35) 50 U/L
FAL(fosfataza alkaline) (N: 30-300u/L) 200 U/L
Albumina g/l: normal
HB (N 12-17 gr/dl): 8 gr/dl
Retikulociti(N: 8-20%)
A) Hepatit viral akut
B) Anemia hemolitike autoimune
C) Sëmundje kronikë e mëlcisë nga alkoli
D) Ikter kolestatik

167. Cila është diagnoza më e mundëshme në qoftë se pacienti ka këto analiza:

- Biluribinë(N: <0.9) 1.5mg/dl
ALT (N: 5-35) 80 U/L

FAL(fosfataza alkaline) (N: 30-300u/L) 400 U/L

Albumina(35-50 g/l)28g/l

HB (12-17gr/dl) 10.5 gr/dl

Retikulociti: normal

A) Hepatit viral akut

B) Ikter kolesterolistik

C) Anemia hemolitike autoimune

D) Dëmtim kronik i mëlcisë nga alkoli

168. Sa është mesatarish sasia më minimale e gjakut të humbur në hemoragjitet e sipërme GI që të ngjyrosjet fecja në të zi, pra të shfaqet melena:

A) 50 ml

B) 100 ml

C) 70 ml

D) 30ml

169. Vetëm një nga kushtet e mëposhtme nuk ndikon në falls pozitivitetin e ekzaminimit të feçeve për gjak ocult:

A) Dietë pa mish 3 ditë rresht

B) Ndalimi i terapisë me preparate hekuri

C) Fecja të merret 3 ditë rresht kur eksamini del negativ

D) Të përzihet fecja para marrjes së mostrës

170. Mbas një hemoragje të vetme gastro- intestinale dhe për sa ditë fecja do të jetë e errët:

A) Deri 1 ditë

B) Deri 3 ditë

C) Deri 2 ditë

D) Deri 7 ditë

171. Mbas një hemoragje të vetme gastro- intestinale dhe për sa ditë fece për gjak ocult do të jetë pozitive:

A) Deri 1 ditë

B) Deri 7 ditë

C) Deri 3 ditë

D) Deri 2 ditë

172. Ekzaminimi fece për gjak ocult mund të rezultojë falls pozitiv nga:

A) Marrja e hekurit

B) Marrja e bismuthit

C) Konsumi i spinaqit

D) Konsumi i mishit

173. Vendi i gjakrrjedhjes në melena mund të jetë në:

A) Proksimalisht colon transvers

B) Sigmë

C) Ampula rectale

D) Coloni zbritës

174. Kur kundërindikohet sildenafil (grup me viagrën):

A) Personi është mbi 68 vjeç

- B) Pacienti ka histori të sëmundjes ishemike të zemrës
- C) Personi ka deformime të penisit
- D) Pacienti merr nitrate

175. Kur mund të kundër indikohet sildenafil (grup me viagrën):

- A) Personi është mbi 68 vjeç
- B) Pacienti ka histori të sëmundjes ishemike të zemrës
- C) Personi ka deformime të penisit
- D) Pacienti ka bërë prostat ectomi totale.

176. Vetëm një nga medikamentet e më poshtëme nuk bën pjesë në mjekimin e anafilaksisë

- A) Adrenalina
- B) Chlorpheniramina 10 mg iv
- C) Lanatosid c
- D) Hydrocortison 100-200 mg iv

177. Cila është doza korrekte e adrenalinës në mjekimin e anafilaksisë.

- A) 1 ml të 1:1000 im
- B) 1ml të 1:1000 iv
- C) 10 ml të 1:1000 im
- D) 10 ml të 1:1000 im

178. Sa është sasia e gjakut që duhet të humbasë për tu bërë diagnoza objektive e Menorhagjisë

- A) 100 ml
- B) 40 ml
- C) 80 ml
- D) 20 ml

179. Cili nga medikamentet e më poshtëme përdoret me sukses në profilaksinë sekondare të insultit (TIA).

- A) Aspirina me dozë të lartë
- B) Warfarina edhe pa fibrilacion atrial
- C) Heparina
- D) Aspirina me dozë të ulët

180. Cili nga medikamentet e më poshtëme përdoret me sukses në profilaksinë sekondare të insultit (TIA) .

- A) Aspirina me dozë të lartë
- B) ACE inhibitorët për të pasur një TA më të ulët
- C) Sintron
- D) Warfarina edhe pa fibrilacion atrial

181. Cili nga medikamentet e më poshtëme mund të përdoret me sukses në profilaksinë sekondare të insultit (TIA) .

- A) Aspirina me dozë të lartë
- B) Warfarina edhe pa fibrilacion atrial
- C) Heparina
- D) Statinat

182. Në qoftë se për profilaksinë sekondare të insultit përdorim njërin nga medikamentet e më poshtëme, rreziqet kalojnë përfitimet:

- A) ACE inhibitorët për TA më të ulët
- B) Statina
- C) Aspirina me dozë të ulëta
- D) Aspirina me dozë të lartë

183. Në qoftë se për profilaksinë sekondare të insultit, përdorim njërin nga medikamentet e më poshtëme, rreziqet kalojnë përfitimet:

- A) Përdorimi i Warfarinës pa fibrilacion atrial
- B) Aspirina me dozë të ulëta
- C) Një statinë
- D) ACE inhibitor për TA më të ulët

184. Pacienti 63 vjeçar, del nga spitali pasi u trajtua për IAM (infarkt akut miokardi). Cili nga 4 medikamentet e më poshtëme është pranuar të jetë esencial në profilaksinë sekondare të IAM:

- A) Acidi folik
- B) Diltiazeni
- C) Aspirina
- D) Isosorbide mononitrate

185. Pacienti 63 vjeçar del nga spitali pasi u trajtua për IAM (infarkt akut miokardi). Cili nga 4 medikamentet e më poshtëme është pranuar të jetë esencial në profilaksinë sekondare të IAM:

- A) Doxazosin
- B) Diltiazeni
- C) Isosorbide mononitrate
- D) Atenololi

186. Pacienti 63 vjeçar del nga spitali pasi u trajtua për IAM (infarkt akut miokardi). Cili nga 4 medikamentet e më poshtëme është pranuar të jetë esencial në profilaksinë sekondare të IAM:

- A) Diltiazeni
- B) Ramipril
- C) Acidi folik
- D) Isosorbide mononitrate

187. Paciente 67 vjeçare del nga spitali pasi u trajtua për IAM (infarkt akut miokardi). Cili nga 4 medikamentet e më poshtëme është pranuar të jetë esencial në profilaksinë sekondare të IAM:

- A) Trinitrina
- B) Diltiazeni
- C) Simvastatina
- D) Acidi folik

188. Nga 4 mundësi, zgjidh antitrupin më specifik për vendosjen e diagnozës në aneminë pernicioze:

- A) ANCA
- B) Anti cardiolipinë
- C) dsDNA
- D) Anti qeliza parietale gastrike

189. Nga 4 mundësi, zgjidh antitrupin më specifik për vendosjen e diagnozës të lupusit eritematos sistemik:

- A) ANCA
- B) Anti cardiolipinë
- C) dsDNA
- D) Scl 70

190. Nga 4 mundësi, zgjidh antitrupin më specifik për vendosjen e diagnozës të sëmundjes së Celiakisë:

- A) dsDNA
- B) Anti cardiolipinë
- C) RhF
- D) Anti- retikulinë

191. Nga 4 mundësi, zgjidh antitrupin më specifik në rastin e aborteve të përsëritura:

- A) ANCA
- B) RhF
- C) Anti cardiolipinë
- D) dsDN

5. Neurologji dhe Psikiatri

1. Mënyra e transmetimit hereditar në distrofinë muskulare tipi Duchenne është si më poshtë:

- A) e lidhur me X-in
- B) autosomale recisive
- C) autosomale dominante
- D) e tipit mitokondrial
- E) recessive sporadike

2. Episodet e migrenës pa aura kanë një kohëzgjatje prej:

- A) 2-10 minutash
- B) mbi 4 orë deri në 7 orë
- C) deri në 4 orë
- D) 10-60 minutash
- E) më shumë se një javë

3. Një lezion ishemik në territorin e arteries cerebri media është përgjegjës për:

- A) hemiplegji dhe hemianestezi kontrolaterale me paralizë të shikimit drejt anës së kundërt
- B) hemiplegji homolaterale me predonim në anësinë e poshtme
- C) deficit të nervave kraniale homolaterale
- D) deficit të nervave kraniale homolaterale dhe shenja motore, sensitive e cerebelare kontrolaterale
- E) dizartri

4. Aksidenti ishemik tranzitor me përkufizim ka një kohëzgjatje prej:

- A) < 1 orë
- B) < 12 orë
- C) < 1 muaj
- D) < 1 javë

E) < 24 orë

5. Cili është shkaku më i shpeshtë i AVC-ve?

- A) diabeti
- B) trombo-embolia
- C) hipertensioni arterial
- D) aneurisma
- E) ateroskleroza

6. Një pacient pati një dhimbje të fortë mesi ndërkohë që po punonte me trupin në fleksion. Ditën tjetër, ai u zgjua me dhimbje të fortë dhe mpirje të gishtit të I-rë të këmbës së majtë. Ka shumë mundësi që ai të ketë hernie të diskut inter-vertebral:

- A) L1-L2
- B) S1-S2
- C) L5-S1
- D) L4-L5
- E) S2-S3

184. Cili nga këto trajtime duhet të aplikohet në trajtimin e preeklampsisë?

- A) diuretik
- B) dieta me pak kripë
- C) propanolol
- D) sulfat magnezi
- E) kalçium

185. Të gjithë barnat e mëposhtëm jepin anomali fetale me përjashtim të:

- A) tetraciklinës
- B) talidomidit
- C) litiumit
- D) sulfonamideve
- E) kumarinës

186. Cili prej tumoreve të më poshtme është përgjegjës për numrin më të madh të vdekjeve në çdo vit?

- A) endometrial
- B) mamar
- C) pulmonar
- D) intestinal
- E) cervikal

187. Në rrezik aboti rekomandohet të ndiqet terapia e më poshtme me përjashtim të:

- A) antibiotikoterapi
- B) progresteroni
- C) beta stimulues
- D) antispastik
- E) rregjim shtrati

188. Të gjitha parametrat laboratorik fiziologjik ulen në trimestrin e dytë te një shtatzanie normale me përjashtim të:

- A) frekuencës kardiakë
- B) hematokritit
- C) shpejtësisë të eritrosedimentit
- D) natremisë
- E) frekuncës respiratore në minutë

189. Në një shtatzani normale nëna shton në peshë:

- A) 8 kg
- B) 6 kg
- C) 12.5 kg
- D) 20 kg
- E) 16 kg

190. Një grua 25 vjeç, në javën e 13-të të shtatzanisë të parë, ankon për hemorragji vaginale. Në ekzaminim objektiv evidentohet një TA=160/95 mmHg, proteinuri 3, dhe fundusi uterin në nivel të umbelikusit. Cila është diagnoza e mundshme?

- A) diabet gestacional
- B) barrë gemelare
- C) anencefali fetale
- D) abort i paevitueshëm
- E) barrë molare

191. Maturimi i spermatozoideve ndodh në nivel të:

- A) epididimisit
- B) tubujve seminiferë
- C) kanalit vaginal
- D) duktusit deferent
- E) në kontakt me ovarin

192. Shenjet thelbësore të preeklampsisë janë:

- A) hipertensioni
- B) hipertensioni dhe edema
- C) hipertension, cefale, konvulsione
- D) hipertension dhe proteinuri
- E) asnjë nga përgjigjet

193. Pilula kontraceptive estro-progestinike vepron në nivel të:

- A) hipofizës
- B) tubujve
- C) qafës uterine
- D) ovarit

E) gjendrës mbiveshkore

194. Metoda më e mirë për identifikimin e placentës previa është:

- A) ekografja
- B) amniografa
- C) ekzaminimi gjinekologjik
- D) arteriografa e aa.uterine
- E) radiografia pelvike

195. Cila nga këto situat është e lidhur më shpesh me oligohidraminos?

- A) agenezia renale
- B) atrezia duodenale
- C) hidrops fetal
- D) anencefalia
- E) barrat e shumta

196. Gjatë shtatzanisë, përqëndrimi i fibrogjenit në gjakun e nënës:

- A) ulet në mënyrë sinjifikante
- B) ulet në mënyrë të moderuar
- C) nuk ndryshon
- D) rritet në mënyrë sinjifikante
- E) rritet në mënyrë të moderuar

197. Cili hormon stimulon maturimin e folikuillt ovarial?

- A) FSH
- B) LH
- C) Estrogen
- D) Progesteron
- E) Testosteron

198. Çfarë është onfalocela?

- A) hernie cerebrale
- B) aplazi e murit abdominal në regjionin umbelikal
- C) hernie inguinale kongenital
- D) divertikul
- E) hernie hiatale

199. Shkaku më i shpeshtë i vdekjes në një grua me eklampsi është:

- A) ruptura hepatike
- B) insuficiencia renale akute
- C) hemorragja cerebrale
- D) embolia pulmonare
- E) shoku septik

200. Në rast të perförimit të uterusit gjatë ekzaminimit instrumental duhet:

- A) të vazhdohet ekzaminimi i nisur
- B) të ralizohet histerektomia e menjëherëshme
- C) të aplikohet laparoskopji eksplorative
- D) të realizohet me urgjencë ekografia
- E) të ndërpritet ekzaminimi dhe të fillohet antibiotikoterpi

201. Vena ovariale e djathtë derdhet në venën:

- A) renale të djathë
- B) mesenterike inferiore
- C) cava inferiore
- D) iliakë të majtë
- E) femorale të majtë

202. Diabeti në shtatzani mund të shkaktojë:

- A) abort në trimujorin e parë
- B) vonesë në rritjen intrauterine
- C) polihidramnios
- D) placenta previa
- E) makrosomi fetale

203. Të gjitha pohimet e më poshtme jnaë të vërteta në lidhje me endometriozën me përjashtim të:

- A) endometriosa shkakton insuficience renale
- B) transformimi malinj i saj është i rrallë
- C) endometriosa është me e shpeshtë në periudhën e fertilitetit
- D) gratë e prekura nga endometriosa mund të shfaqin infertilitet
- E) shpesh herë diagnostikohet gjatë një kontrrolli të zakonshëm

204. Gjatë shtatzanisë fibromat uterine kanë tendencë të:

- A) zvogëlohen
- B) zmadhohen
- C) mos ndryshojnë
- D) kolabohen
- E) malinjizohen

205. Shtatzani ektopike vendoset më shpesh në:

- A) ovar
- B) fundusin uterin
- C) periton
- D) tubat uterin
- E) qafën e uterusit

206. Miomat shoqërohen me të gjithë elementët e më poshtëm, me përjashtim të:

- A) anemi
- B) pielonefrit
- C) polakiuri
- D) dismenore
- E) amenore

207. Amnicenteza për vlerësimin e kariotipit fetal mund të realizohet në:

- A) javën e 8-10
- B) javën 10-12
- C) javën 16-18
- D) javën 22-24
- E) në çdo periudhë të shtatzanisë

208. Cili nga parametrat e më poshtëm nuk ndryshon në trimestrin e dytë të një shtatzanie normale?

- A) frekuencia kardiake
- B) hematokriti
- C) shpejtësia e eritrosedimentit
- D) natremia
- E) vëllimi respirator në minutë

209. Përqindja e aborteve pasoje e realizimit të amniocentezës në trimestrin e dytë është:

- A) 1%
- B) 3%
- C) 4%
- D) 5%
- E) mbi 5%

210. Sa gjak humbet mesatarisht me një menstruacion:

- A) 10-15 ml
- B) 25-50 ml
- C) 75-100 ml
- D) 101-125 ml
- E) 135-150 ml

211. Në një grua me cikël të rregullt menstrual çdo 28 ditë, periudha më e përshtatshme e fekondimit është:

- A) dita 2-5
- B) dita 7-11
- C) dita 10-16
- D) dita 18-26
- E) dita 20-29

212. Placenta prodhon normalisht:

- A) estrogen dhe progresteron
- B) gonadotropinat korionike
- C) substanca të ngjashme me somatotropinat
- D) kortikosteroid
- E) të gjitha elementët e përmendur

213. Mastiti akut, në shumicën e rasteve evidentohet gjatë:

- A) pubertetit
- B) ushqyerjes me gji
- C) ciklit menstrual normal
- D) shtatzanisë
- E) menopauzës

214. Një grua 33 vjeç që ka lindur fëmijën e saj të parë para 5 javësh, paraqitet në ambulator ku të tregon se ndihet vazhdimisht e lodhur dhe në ankth. Ajo referon se ndihet e padobishme, rri gjithëditën kot dhe qan vazhdimisht pa ndonjë arsyе specifike si dhe ka pagjumësi gjatë natës. Cila është diagnoza e mundshme?

- A) Depresioni pas lindjes
- B) Çrregullime të ankthit

- C) Psikoza pas lindjes
- D) Sëmundje bipolare
- E) Pagjumsi

215. Pas menopauzës, dispareunia shkaktohet më shpesh nga

- A) tharja e sekrecioneve vaginale
- B) inkontinenca
- C) infekzionet nga kandida
- D) problemet e erekcionit të partnerit
- E) Të gjitha përgjigjet

216. Cilën nga këto neoplazi malinje ka tendencë të zhvillojë një grua shtatzane 35 vjeçare?

- A) Neoplazi të ovarit
- B) Neoplazi të qafës të mitrës
- C) Neoplazi të gjirit
- D) Neoplazi të vaginës
- E) Neoplazi të kolonit

217. Në kuloshtër predominojnë:

- A) IgM
- B) IgG
- C) IgA
- D) IgD
- E) IgE

218. Gjatë vlerësimit për një amenorre dytësore në një femër 24 vjeç, diagnostikohet hiperprolaktinemia. Cila nga këto situat mund të rritin sasinë e prolaktinës qarkulluese dhe të nxitin amenorrenë në këtë paciente?

- A) Stresi
- B) Hipertiroidizmi parësor
- C) Anoreksia nervore
- D) Hiperplazia kongenitale e gjendrave mbiveshkore
- E) Sëmundja e ovarit polikistik

219. Një femër 27 vjeç sapo ka patur një shtatzani ektopike. Cili prej elemetëve të mëposhtëm predisopzon zhvillimin e një shtatzanie ektopike?

- A) Malformimi i uterusit
- B) Sëmundja inflamatore pelvike
- C) Përdorimi i mjeteve kontraceptive
- D) Induktimi i ovulacionit
- E) Ekspozimi ndaj dietilstilbisterolit

220. Në rastin kur fetusi paraqitet i pozicionuar me shpatull, trajtimi i zgjedhur është:

- A) Përdorimi i oksitocinës me doza të larta
- B) Përdorimi i kapseve obstetrike (ventuza obstetrike)
- C) Nuk është e nevojshme të ndërhyet sepse bëhet fjalë për një paraqitje fiziologjike të bebit
- D) Kirurgjia cezariane
- E) Asnjë nga këto nuk përshtatet me këtë situatë.

221. Hormoni folikulostimulues prodhohet nga:

- A) Qelizat kromofobe të adenohipofizës
- B) Qelizat gonadotrope të adenohipofizës
- C) Qelizat acidofile të adenohipofizës
- D) Qelizat thekale interne
- E) Të gjitha përgjigjet janë të sakta

222. Shkaku më i shpeshtë i ambiguiteti gjenital në fëmijë është:

- A) Çrregullimet kromozomike
- B) Disgenezia gonadike
- C) Sindroma adrenogenitale
- D) Mozaicizmi
- E) Feminizimi testikular

223. Të gjitha janë simptoma të vdekjes intrauterine të fetusit me përjashtim të:

- A) mungesa e perceptimit të lëvizjeve fetale nga nëna
- B) mungesa e rritje të vëllimit të uterusit
- C) shtimi në peshë i nënës
- D) regredimi i simptomave të shtatzanisë
- E) mungesa e rrahjeve të zemrës fetale në ekografi

224. Vendlokalizimi më i shpeshtë i endometriozës është:

- A) siperfaqja peritoneale intestinale
- B) omentumi
- C) apendiksi
- D) vesika urinare
- E) hapsira Douglas

225. Të gjithë elementët e mëposhtëm janë të lidhur me rritjen e nivelit qarkullues të prolaktinës me përjashtim të:

- A) stresi
- B) hipotiroidizmi
- C) anoreksia nervore
- D) akromegalia
- E) shtatzania

226. Rritja e vlerave të beta HCG do të na orientonte për:

- A) tumor të gjirit
- B) tumor të ovarit
- C) cistoadenomë
- D) tumor me qeliza Sertoli-Leyding
- E) koriokarcinomë

227. Klinikisht karcinoma endometriale zakonisht paraqitet me:

- A) rritje të përmasave të uterusit
- B) dhimbje abdominale
- C) hemorragji
- D) leukorre
- E) të gjitha këto

228. Trupi i shkurtër te gratë mund të shoqërohet me:

- A) sindromën Turner
- B) hipotiroidizëm
- C) hiperplazi të gjendrave mbiveshkore
- D) Sëmundja Cushing
- E) Të gjitha këto

229. Cila anomali kromozomike karakterizon sindromën Klinefelter?

- A) XO
- B) Trizomia 15
- C) Delecion i krahut të shkurtër të kromozomit 18
- D) XXY
- E) XYY

230. Cili bar rekomandohet të përdoret në trajtimin e moniliazës?

- A) Metronidazoli
- B) Mikonazoli
- C) Dinestrol
- D) Sulfisoksazol
- E) Deoksiciklina

231. Shaku më i shpeshtë i dështimit të kontraceptivëve oral, duke rezultuar më pas me një shtatzani të padëshiruar është:

- A) Ovulimi në mes të ciklit
- B) Shpeshtësia e raporteve sksuale
- C) Përdorimi i gabuar i kontraceptivëve oral
- D) Malabsorbimi gastrointestinal
- E) Prodhimi i antitruapve

232. Terapitë hormonale zëvendësues që merren gjatë menopauzës mund të përmirësojnë:

- A) Sekrecionet vaginale
- B) Dispareuninë
- C) Dëshirën seksuale
- D) Mardhënien në çift

233. Shkaku më i shpeshtë i inkontinencës urinare në një grua në menopauzë është:

- A) Inkontinenca urinare nga stresi
- B) Prania e divertikujve uretral
- C) Inkontinenca nga grumbullimi i urinës
- D) Paqëndrueshmëria e vezikës urinare
- E) Fistulat

234. Cila nga substancat e më poshtme do të shkaktonin anomali të indit vaskular fetal dhe neonatal, nëse ato do të përdoreshin nga nëna gjatë shtatzanisë?

- A) Duhani
- B) Alkooli
- C) Narkotikët
- D) Amfetaminat
- E) Kokaina

235. Në një grua shtatzanë diagnoza e hepatitit mund të konfirmohet nga rritja e vlerave të:

- A) ERS
- B) Fosfatzës alkaline
- C) Leukocitozës
- D) SGOT
- E) Azotemisë dhe kreatinemisë

236. Cikli menstrual varet nga:

- A) Çlirimi i prolaktinës nga hipofiza anteriore
- B) Sekrecioni pulsues i hormonit stimulues të sekretimit të gonadotropinave (GnRH)
- C) Zgjatja e fazës folikulare
- D) Prodhimi i progresteronit nga trupi i verdhë
- E) Prodhimi i estrogenit nga ovaret

237. Shtatzania ektopike vendoset më shpesh në:

- A) ovar
- B) fundusin uterin
- C) periton
- D) tubat uterin
- E) qafën e uterusit

238. Rrtja fiziologjike e ERS në shtatzani vjen si pasojë e:

- A) uljes të gamaglobulinave
- B) rritjes të beta globulinave
- C) rritje të fibrinogenit plazmatik
- D) rritje të transferinës
- E) rritjes të prolaktinës

239. Cili prej pohimeve te me poshtme ne lidhje me sindromen vulvo-vestibulare, eshte i sakte:

- A) perfaqeson formen prevalentë te vulvodinise
- B) shoqerohet pothuajse gjithmone me dispareuni
- C) per gjithesisht mungojne lezionet vulvare ose infekzionet e dukshme vulvu-vaginale
- D) ndonjehere mund te verehet eriteme makulare per gjate sulkusit imenal dhe ne nivelin e hapjes se glandulave vestibulare major dhe minor
- E) te gjitha

240. Frekuencia e infekzionit fetal si pasoje e rozolise materne, eshte me e larte:

- A) nese rozolia materne ndodh ne trimestrin e pare te gravidances
- B) nese rozolia materne ndodh ne trimestrin e dyte te gravidances
- C) nese rozolia materne ndodh ne trimestrin e trete te gravidances
- D) ne rast reinfektimi matern
- E) asnijera

241. Cila prej patologjive te me poshtme shkakton nivele te larta materne te alfafetoproteines, ne javen e 17-te te gravidances:

- A) trizomia e kromozomit 18
- B) sindroma Down
- C) vonesa e rritjes intrauterine
- D) anencefalia

242. Shkaku organik me i shpeshte, qe ndodhet ne baze te çrregullimit te deshires hipoaktive femerore eshte:

- A) diabeti mellitus
- B) sindroma depresive
- C) hipotiroidizmi
- D) asnjera

243. Cila eshte simptome klinike e shpeshte e karcinomes endometriale:

- A) vaginiti rekurrent
- B) dispareunia
- C) metrorragjite
- D) amenorrea
- E) asnjera

244. Cili prej pohimeve te meposhtme eshte i sakte:

- A) kriteri diagnostik kryesor i DSM-IV per vaginizmin eshte prania e "spazmes te pavullnetshme rekurrente ose persistente te muskulatures se nje te tretes se jashtme te vagines, qe nderhyn ne marredheniet seksuale"
- B) ne rastin e sindromes vulvo-vestibulare, vestibulektomia ka si qellim rezekimin e indit qe shkakton shfaqjen e dhembjes se vestibulit vaginal
- C) dispareunia e thelle eshte karakteristike e endometriozes, e PID, e varikoceles pelvike, si edhe e aderencave fibrotike
- D) te gjitha per gjigjet jane te sakta
- E) ndonjehere spazma e vaginizmit pershkruhet si nje spazme aq e gjate dhe e rende sa qe shkakton shfaqjen e dhembjes

245. Cila eshte shenja dhe/ose simptoma me e shpeshte me te cilen paraqitet karcinoma endometriale:

- A) rritja vellimore e uterusit
- B) kolika abdominale
- C) hemorragjia
- D) leukorrea
- E) te gjitha

246. Shkaku endrokrin i trupit te shkurter te grave te reja perfshin:

- A) sindroma Turner
- B) hipotiroidizmi
- C) hiperplazia surrenaliene
- D) morbus Cushing
- E) te gjitha

247. Kardiotokografia:

- A) regjistrion njekohesisht me dy sensore frekuencen kardiake fetale dhe aktivitetin e kontraktimit te miometrit
- B) regjistrion njekohesisht me dy elektroda frekuencen kardiake materne dhe aktivitetin e kontraktimit te miometrit
- C) ben te mundur vleresimin e morfologjise kardiake fetale
- D) regjistrion njekohesisht me dy sensore frekuencen kardiake fetale dhe aktivitetin e kontraktimit te miometrit dhe ben te mundur vleresimin e morfologjise kardiake fetale
- E) te gjitha

248. Terapite zevendesuese hormonale vaginale per menopauzen mund te permiresojne:

- A) thatesine vaginale
- B) dispareunine
- C) deshiren seksuale
- D) raportin e çiftit
- E) te gjitha

249. Korpusi albikant eshte:

- A) folikul atrezik
- B) folikul i Graaf
- C) folikul primordial
- D) nje rrejdhje cikatriciale e korpusit luteum
- E) asnjera

250. Cila prej situatave te meposhtme perfaqeson nje avantazh te ekzaminimit te vileve korionike mbi amniocentezen, per percaktimin e anomalive fetale:

- A) mund te kryhet me perpara gjate shtatzenise
- B) mund te percaktoje me sakte defektet e tubit neural
- C) ka nje mundesi me te ulet per te provokuar abort
- D) aborti kryhet njekohesisht me ekzaminimin
- E) asnjera

251. Perforacioni i uterusit gjate eksplorimit instrumental te kavitetit uterin ndodh shpesh ne:

- A) retroversofleksionin uterin
- B) antifleksionin rigid
- C) neoplazine malinje te uterusit
- D) nje rast me sectio cesareo gjate koheve te fundit
- E) te gjitha

252. Cilat jane shenjat dhe/ose simptomat themelore te preeklampsise:

- A) hipertensioni dhe skotomat
- B) hipertensioni dhe edemat
- C) hipertensioni, cefalea dhe konvulsionet
- D) hipertensioni dhe proteinuria
- E) asnjera

253. Prolapsi i kordonit umbilikal mund te shkaktohet nga:

- A) prezantimet anormale
- B) disproporcionet fetus-pelvis
- C) gjatesise se madhe (mbi 75 cm)
- D) te gjitha

254. Diagnoza e ovulacionit mund te vendoset duke vezhguar:

- A) modifikimet ciklike te mukusit cervical
- B) modifikimet ciklike te citologjise vaginale
- C) modifikimet ciklike te temperatures bazale
- D) modifikimet sekretore te endometrit
- E) te gjitha

255. Te nje paciente me preeklampsi, cila prej anomalive te meposhtme ndeshet me shpesh gjate ekzaminimit te urines:

- A) proteinuria
- B) hematuria
- C) glukozuria
- D) ketonuria
- E) asnjera

256. Cili prej tumoreve ovariane te meposhtme, aktiv nga pikepamja endokrinologjike, shoqerohet me shpesh me pubertet te parakohshem te grate:

- A) disgerminoma
- B) ginandoblastoma
- C) fibrotekoma
- D) tumori i qelizave te granulozes-tekes
- E) asnjera

257. Amniocenteza per vleresimin e kariotipit fetal mund te kryhet:

- A) ne javet 8-10
- B) ne javet 10-12
- C) ne javet 16-18
- D) ne javet 22-24
- E) ne çdo periudhe te shtatzenise

258. Numri me i madh i vdekjeve nga karcinoma cervikale shkaktohet nga:

- A) ekstensioni lokal
- B) metastazat ne sistemin nervor qendror
- C) metastazat ne mushkeri
- D) shkaqet jatrogjene
- E) asnjera

259. pH vaginal korrelon me:

- A) perberjen e ekosistemit vaginal
- B) nivelin e estrogjeneve ne indet vaginale
- C) cenueshmerine e infeksioneve nga bakteret e kolonit
- D) moshen e pacientes
- E) te gjitha

260. Cila nga situatat e mëposhtme, eshte e lidhur me nje rritje te mundesise se hemorrhagjise postpartum:

- A) procesi i shpejte i lindjes
- B) procesi i gjate i lindjes
- C) stimulimi i lindjes me oksitocine
- D) gravidanza multiple
- E) te gjitha

261. Cila prej formacioneve te meposhtme anatomike e merr prejardhjen nga duktusi Wolff , te gruaja:

- A) tubat uterine
- B) uterusi
- C) vagina

- D) ligamenti i gjere
- E) asnjera

262. Gjate jetes fetale, duktusi arterioz i Botallit, sherben:

- A) si qark i shkurter per qarkullimin pulmonar
- B) per te shkembyer gjakun ndermjet gjymtyreve
- C) si qark i shkurter per heparin ne zhvillim
- D) per te parandaluar koarktacionin
- E) asnjera

263. Zgjidhni teknikën e përshtatshme të përdorur për diagnostikimin e anemisë drepanocitare në një fetus:

- A) kulturë e qelizave të lëngut amniotik
- B) kampione të gjakut fetal
- C) alfafetoproteina e likidit amniotik
- D) përqëndrimi i substancave kimike në urinën e nënës
- E) ekografi

264. Kundërindikohet përdorimi i pilulave kontraceptive në:

- A) endometriozë
- B) mastopati fibrocistike
- C) cist ovarii
- D) karcinoma mamare e operuar prej më shumë se 3 vjetësh
- E) nuliparita

265. Gjatë lindjes, dilatimi i qafës të uterusit do të konsiderohet i plotë kur ka arritur:

- A) 2-3 cm
- B) 6 cm
- C) 5 cm
- D) 10 cm
- E) 12 cm

266. Në cilën ditë LH arrin nivelin më të lartë në një grua që ka cikël menstrual të rregullt çdo 30 ditë?

- A) ditën e 12-të
- B) ditën e 14-të
- C) ditën e 16-të
- D) ditën e 18-të
- E) ditën e 27-të

267. Cili nuk bën pjesë në indeksin e Apgar?

- A) ngjyra e lëkurës
- B) tonusi muskular
- C) temperatura trupore
- D) frekuenca kardiake
- E) vlerësimi i frysëmarrjes

268. Qelizat e Leyding marrin pjesë në pordhimin e:

- A) spermatociteve
- B) estrogjenit

- C) testosteronit
- D) mineralokortikoideve
- E) glukokortikoideve

269. Eklampsia karakterizohet nga:

- A) cefale e moderuar, tranzitore
- B) hiper refleksi
- C) konvulsione të tipit grand mal
- D) konvulsione
- E) skotoma

270. Cila nga patologjitetë e mëposhtme nuk është shkak i amenorresë?

- A) Sindroma Turner
- B) Diabeti Mellitus
- C) Sindroma e ovarit polikistik
- D) Hiperplazia surenale kongenitale
- E) Hiperprolaktinemia

271. Çrregullimet seksuale të femrat hasen në prevalencën:

- A) 45%
- B) 25%
- C) 10%
- D) 5%
- E) ska studime në lidhje me këtë çështje

272. Në analizën e urinës të një paciente me preeklampsi do evidentohej:

- A) proteinuria
- B) hematuri
- C) glukozuria
- D) ketonuria
- E) asnje nga këto

273. Karcinoma e cerviksit të uteruist nga pikëpamja histologjike paraqitet si një;

- A) adenokarcinome
- B) karcinomë mukoepidermoide
- C) karcinomë epidermoide
- D) korionkarcinoma
- E) cistosakomë

7. Pediatri

1. Të gjitha pohimet e mëposhtme janë tregues prognostike pozitiv te Leuçemise Limfoblastike akute në moshën pediatrike përvç:

- A) Mosha 3-7 vjeç.
- B) Limfocitozë fillestare $<10\ 000/\text{mm}^3$
- C) Seksi mashkull
- D) Vlera e hemoglobinës $<7\text{g/dL}$
- E) Trombocitet $>100\ 000\ \text{mm}^3$

2. Kur dyshojmë për një invaginacion intestinal tek fëmija, cili është egzaminimi diagnostik që përjashton diagnozën?

- A) Invertogram
- B) Radiografi e drejtpërdrejtë e abdomenit
- C) Radiografi me kontrast bariumi
- D) Stratigrafi
- E) Klizma opake

3. Cili është simptomi më i shpeshtë me të cilin fillon kraniofaringioma te fëmijët?

- A) Strabizëm
- B) Dhimbjë koke
- C) Turbullime të shikimit
- D) Ngadalësim në rritje
- E) Marrje mendsh

4. Divertikuli i Meckel-it mund të jetë:

- A) Simptomatik vetëm në seksin mashkull
- B) Simptomatik vetëm në seksin femër
- C) Gjithnjë simptomatik
- D) Përcaktohet vetëm me autopsi
- E) Asimptomatik

5. Zhurma e pafajshme është zakonisht:

- A) Diastolike në pozicion të shtrirë
- B) E vazhdueshme
- C) Mezotelesistolike
- D) Protomezosistolike
- E) E pranishme vetëm mbas ushtrimit fizik

6. Terapia e krizave astmatike të moderuara:

- A) Parashikon përdorimin e a2 stimulantëve per os dhe në rast se nuk ka përmirsim për 12 orët në vazhdim, përdoret prednisolon.
- B) Parashikon përdorimin e b2 stimulantët në rrugë inhalatore dhe prednizolonit per os.
- C) Kërkon shtrim urgjent në spital.
- D) Parashikon përdorimin e a2 stimulantit ipratropium bromid në rrugë inhalatore dhe n.q.s nuk kemi përmirësim për 4 orë, përdoret prednisolon.
- E) Teofilina

7. Një vajzë me moshë 4 vjeç, po luante në një fushë të trajtuar me insekticid.

Prindërit e sjellin në ndihmën e shpejtë në gjëndje letargje, me sekrecione nga goja, miozë, lotim dhe inkontinencë urine dhe fekale, të vjella dhe dridhje. Mjeku dyshon për

- A) Atopina
- B) BAL (british antilewisite)
- C) Ca- EDTA
- D) Naloxon
- E) Pralidoxim (2- Pam)

8. Në rastin e një fëmije me gastroenterit akut, cili është hapi prioritar?

- A) Prick- test alergjik.
- B) Kërkim i oksiureve në feçë.

- C) Testi i absorbimit intestinal
- D) Fillimi i terapisë antibiotike.
- E) Vlerësimi i gjendjes së hidratimi dhe ekuilibri acidobazik.

9. Cili nuk është komplikacion i parotitit?

- A) Gastriti
- B) Pankreatiti
- C) Orkiti
- D) Adenit supurativ
- E) Meningoencefaliti

10. Cili simptom është tipik për sindromin nefrotik?

- A) Glukozuria
- B) Poliuria
- C) Hematuria
- D) Edema
- E) Hipertensioni

11. Infekzioni me *Mycoplasma pneumoniae* mund të shkaktojë të gjitha pathologjitet e mëposhtme, përveç:

- A) Bronkitit
- B) Bronkiolitit
- C) Faringotonsilitit
- D) Konjuktivitit
- E) Otitis media

12. Cili egzaminim përcakton gravitetin në diagnozën klinike të bronkiolitit?

- A) Ekzaminimi hemokromocitometrik.
- B) Rx e Toraksit
- C) Saturacioni O₂
- D) Temperatura
- E) Presioni arterial sistemik

13. Për cilën sëmundje hematologjike në pediatri rekomandohet heparina + plazma e freskët?

- A) DIC (KID- koagulimi intravazal i diseminuar)
- B) Hemofilia A
- C) Sëmundje von Willebrand
- D) Hemofilia B
- E) Difekt i koagulimit si pasojë e hepatopatisë

14. Një fëmijë 4 vjeç që merr mësime noti, shfaqet tek pediatri me dhimbje në veshin e djathtë. Ekzaminimi objektiv i veshit tregon edemë dhe eritemë të kanalit auditiv me praninë e sekrecioneve me ngjyrë të gjelbër. Dhimbja shtohet me prekje të aurikulës dhe shtypjes mbi tragus. Cili është shkaktari më i mundshëm i këtij infeksioni?

- A) *Hæmophilus Influenzae*
- B) Moraxella catarrhalis
- C) Pseudomonas aeruginosa
- D) *Streptococcus agalactiae*
- E) Escherichia coli

15. Një neonat i gjatë për moshën gestionale paraqitet me lëkurë të rrudhur dhe të deskuamuar. Thonjtë janë të gjata dhe të gjelbra. Nuk ka prezencë pushi. Sa është mosha gestionale e këtij fëmije?

- A) 34 javë
- B) 42 javë
- C) 38 javë
- D) 40 javë
- E) 36 javë

16. Cila nga ndërhyrjet e mëposhtme është e detyrueshme dhe prioritare tek një fëmijë me arrest kardiocirkulator?

- A) Ekzaminimi biokimik dhe instrumental.
- B) Administrimi i medikamenteve jetike.
- C) Monitorim i presionit arterial dhe diurezës
- D) Vendosja e vigonit dhe fillimi i serumit endovenoz.
- E) Lirimi i rrugëve të frymëmarrjes, ventilacion dhe masazh kardiak.

17. Intoleranca ndaj proteinave të qumështit mund të manifestohet me të gjitha kuadret klinike të mëposhtme, përveç:

- A) Formë akute me diarre dhe të vjella
- B) Formë kronike me kolit / ose anemi
- C) Diarre me gjak okult në feçë.
- D) Dermatit atopik dhe urtikarie
- E) Të vjella dhe acidozë metabolike.

18. Cila nga pathologjitë e mëposhtme te sistemit genital, mund të jetë shkaktar i abdomenit akut tek vajzat?

- A) Hipertrofia e klitorisit
- B) Hipotrofia e klitorisit
- C) Torsion i ovarit
- D) Hipertrofia e buzëve të vogla
- E) Hipertrofia e buzëve të mëdha

19. Sasia e yndyrnave në dietën e fëmijës së vitit të dytë të jetës, këshillohet në një nga opzionet e mëposhtme:

- A) Nën 10% të kalorive ditore.
- B) Jo më tepër se 30% të kalorive ditore
- C) Jo më tepër se 15% të kalorive ditore.
- D) Nën 15% të kalorive ditore.
- E) Më tepër se 40% të kalorive ditore.

20. Cili nga trajtimet e mëposhtme duhet të përdoret si medikament i linjës së parë në rastin e një ataku akut të astmës te fëmijët.

- A) beta2 agonist në rrugë inhalatore
- B) Kortikosteroid per os
- C) beta2 agonist per os
- D) Antihistaminikë per os
- E) beta2 agonist per os dhe bikarbonat natriumi.

21. Të gjitha pohimet e mëposhtme janë tipike për stenozën hipertrofike të pylorit, përveç:

- A) Alkalozës metabolike
- B) Haset më shpesh tek meshkujt
- C) Shfaqet mbas moshës 2-3 javëshe.
- D) Të vjella pa përbajtje biliare
- E) Të vjella me përbajtje biliare.

22. Në cilin rast nuk indikohet profilaksia antimeningokoksike?

- A) Kontakte familjare me të sëmurin
- B) Kontakte me të sëmurin në çerdhe gjatë 7 ditëve paraardhëse.
- C) Personeli sanitari që nuk ka pasur ekzpozim të drejtpërdrejt me pacientin.
- D) Subjekte në kontakt të drejtpërdrejt me sekrecionet e pacientit, ose që kanë. përdorur objekte të përbashkëta.
- E) Subjekte që kanë fjetur ose ngrënë me pacientin.

23. Hiperplazia gingivale mund të shfaqet tek një pacient i cili merr mjekim me:

- A) Meticilina
- B) Ampicilina
- C) Eritromicina
- D) Diphenylhydantoina
- E) Tetraciklina

24. Cili nga faktorët e mëposhtëm mendohet se lidhet me sindromin e vdekjes së papritur foshnjore (SIDS)?

- A) Luksacionet e lindura
- B) Përdorimi i biberonit
- C) Toksikoza e shtatzanisë
- D) Kardiopatia
- E) Pozicioni shtrirë mbi bark

25. Të gjitha sindromat e mëposhtme janë uropati malformative, përveç:

- A) Hipertrofia e klitorisit
- B) Ren polikistik
- C) Hidroureteronefroza
- D) Megaureter obstruktiv primar
- E) Refluksi vezikoureteral

26. Të gjitha komplikacionet e mëposhtme mund të gjenden tek neonati i një mamaje diabetike, përveç:

- A) Ikter
- B) Policitemia
- C) Trauma të lindjes
- D) Anomali kongjenitale
- E) Hernia umbilikale

27. Të gjitha të mëposhtmet janë manifestime ekstraintestinale të alergjive nga ushqimet, përveç:

- A) Dermatit atopik
- B) Onikomikoza
- C) Dhimbjes së kokës
- D) Bronkospazma, kolla e thatë e vazhduar.

E) Urtikaries

28. Cila është etiopatogjeneza e hernies inguinale te fëmija?

- A) Dobësi e paretit abdominal
- B) Mosmyllja e processus vaginalis peritonei
- C) Moszbritja e testikulit
- D) Traumë e lindjes
- E) Inflamacion e kanalit inguinal

29. Cili nga markerët e mëposhtëm identifikon pacientin me HBV kronik me risk më të lartë infektimi?

- A) HBeAg
- B) HBsAg
- C) IgM anti- HBc
- D) Antikorpe kundër HBc.
- E) Antikorpe kundër HBs.

30. Cila nga pohimet e mëposhtme është i saktë, për sëmundjen Lyme?

- A) Shkaktohet nga Borrelia vincenti
- B) Shkaktohet nga Adenovirus
- C) Mjekimi kryhet me aminoglikozide.
- D) Artriti është një nga manifestimet e para.
- E) Lëkura është vendndodhja fillestare e infeksionit.

31. N.q.s. një fëmijë ka një gjatësi më të shkurtër se percentili i tretë do të thotë:

- A) Më tepër se 3% e fëmijëve të moshës së tij janë më të shkurtër se ai.
- B) Më pak se 97% e fëmijëve të moshës së tij janë më të gjatë se ai
- C) Më tepër se 97% e fëmijëve të moshës së tij janë më të shkurtër se ai.
- D) Më pak se 3% e fëmijëve të moshës së tij janë më të gjatë se ai.
- E) Më tepër se 97% e fëmijëve të moshës së tij janë më të gjatë se ai.

32. Një vajzë 14 vjeçare, me një histori për hipotireoidizëm ka temperaturë, anoreksi, amenore dhe ikter që persiston prej 4 muajsh. Diagnoza më e mundshme është:

- A) Mononukleozë
- B) Hepatit autoimun
- C) Deficit i alfa1- antitripsinës
- D) Sëmundje e Wilsonit
- E) Kalkulozë biliare

33. Cila nga sëmundjet e mëposhtme karakterizohet me praninë e petekieve?

- A) Hemofilia klasike
- B) Sëmundja von Willebrand
- C) Purpura thrombocytopenike idiopathike
- D) Mungesë e faktorëve II, VII, IX, X
- E) Mungesa e faktorëve III, VI, VIII

34. Tek latantët me infeksione të rrugëve urinare, manifestimi klinik më i shpeshtë është:

- A) Dizuri
- B) Temperaturë
- C) Polakiuria

- D) Dhibjje të regjionit lumbar
- E) Inkontinenca

35. Të gjitha pohimet e mëposhtme janë të pranishme tek anemia B12 deficitare, përvçe:

- A) Ulje e numrit të eritrociteve
- B) MCV e ulur
- C) MCV e rritur
- D) Ulje e Hemoglobinës
- E) Retikulocite të rritura

36. Një fëmijë e moshës 10 muajshe me diarre akute të rëndë dhe dehidratim ka marrë vetëm qumësht të skremuar gjatë dy ditëve të para të diarresë. Cilën është vlera e pritshme e natriemisë?

- A) 102 meq/L
- B) 154 meq/L
- C) 136 meq/L
- D) 142 meq/L
- E) 124 meq/L

37. Infeksioni i rrugëve urinare tek fëmijët është shoqëruar i refluksit vezikoureteral:

- A) 30- 50% të rasteve.
- B) Në 100% të rasteve.
- C) Asnjëherë
- D) Në 98% të rasteve.
- E) Në 2-3 % të rasteve.

38. Cili infekzion tek fëmija nuk shkaktohet nga Streptococcus pneumoniae?

- A) Otiti
- B) Pneumonia
- C) Cistiti
- D) Meningiti
- E) Faringiti

39. Cili nga pohimet e mëposhtme është manifestimi më i shpeshtë i deficítit të alfa1- antitripsinës tek fëmijët?

- A) Kistet pulmonare
- B) Miokarditi
- C) Bronkiti Kronik Obstruktiv
- D) Insuficiencia pankreatike
- E) Cirroza hepatike

40. Cila nga pohimet e mëposhtme është "standarti i artë" për lokalizimin e një testikuli të papalpueshëm në moshën pediatrike?

- A) Eksplorimi laparoskopik
- B) Rx direkte e abdominit
- C) Rezonanca magnetike
- D) TAK (Tomografia Aksiale e kompjuterizuar)
- E) Ekzaminimi objektiv

41. Një fëmijë me sindromën Down, ka rrezik te rritur për:

- A) Malformacione të aparatit urogjenital.

- B) Malformacione kardiake
- C) Malformacione të aparatit digestiv.
- D) Malformacione cerebrale.
- E) Infeksione

42. Të gjitha simptomat dhe shënjet e mëposhtme bëjnë pjesë tek kriteret e madhore te Johns' it për diagnozën e sëmundjes rheumatike, përvëç:

- A) Eritema marginatum
- B) Karditi
- C) Korea
- D) Artralgji
- E) Nodule subkutane

43. Apendiciti akut te fëmija është arsyaja më e shpeshtë e abdomenit akut:

- A) Vetëm tek latantët
- B) Jo
- C) Po
- D) Vetëm tek fëmijët nën moshën 12 muajshe
- E) Vetëm tek fëmija në moshën e pubertetit.

44. Cili është shkaktari më i shpeshtë i gastroenteritit akut në moshën pediatrike, në vendet e industrializuara,

- A) E. coli
- B) Rotavirusi
- C) Salmonella spp.
- D) Adenovirusi
- E) Lamblia intestinale

45. Të gjithë të dhënrat laboratorike të mëposhtme janë karakteristike për aneminë feriprive, me përjashtim të:

- A) Ulje e nivelit të hekurit në serum
- B) Kapacitet i lidhjes së hekurit i rritur
- C) Ulje e nivele të feritinës në serum.
- D) Eritrocite mikrocytike
- E) Ulje e protoporfirinës eritrocitare të lirë

46. Cila thëniet e mëposhtme për vaksinën kundër fruthit është e saktë:

- A) Aplikohet te neonati.
- B) Nuk aplikohet te fëmijët e nënave diabetike.
- C) Nuk aplikohet te prematurët.
- D) Nuk aplikohet te subjektet alergjike.
- E) Aplikohet në moshën 15 muaj.

47. Një nënë që i jep gji foshnjës së saj 3 muajshe, diagnostikohet me mastit të gjirit të majtë. Gruaja nuk e di nëse duhet të vazhdojë t'i japi gji fëmijës. Cila është këshilla më e mirë që mund t'i jepni kësaj nënë?

- A) Të ndërpresë menjëherë gjirin fëmijës, sepse mund të infektohet.
- B) Të vazhdojë të japi gji duke përdorur të dy gjinjtë.
- C) Të vazhdojë të japi gji vetëm me gjirin e djathët.

D) Të ndërpresë mënjenëherë gjirin fëmijës, sepse ajo do të fillojë të marrë antibiotikë.
E) Të kalohet në ushqim artificial.

48. Cila nga sindromet e mëposhtme nuk manifestohet me shtat të shkurtër:

- A) Sindromi Turner
- B) Akondroplazia
- C) Sindrom Noonan
- D) Hypokondroplazia
- E) Sindrom De Soto

49. Cila nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë për vaksinimin antipneumokoksik:

- A) Kryhet mbas moshës 2 vjeç
- B) Kryhet duke filluar nga mosha 2-3 muajshe me vaksinë të konjuguar.
- C) Kryhet duke filluar nga moshe 3 muajshe me cdo tip vaksine.
- D) Nuk rekomandohet.
- E) Kryhet vetëm tek femrat.

50. Një fëmijë e moshës 12 vjeç shfaqet me lodhje, dhimbje gryke, dobësi, Temperaturë, hepatosplenomegali, limfoadenopati të gjeneralizuar diagnostikohet me një mononukleozë të shkaktuar nga virusi Epstein- Barr. Të gjitha komplikacionet e mëposhtme mund të shfaqen, me përjashtim të:

- A) Anemi aplastike
- B) Encefaliti
- C) Hepatit kronik aktiv.
- D) Rupturë e lienit
- E) Mieliti transvers

51. Një fëmijë 4 vjeç paraqet feçe ne sasi te shtuar (abondante), me ere te rende dhe me permbajtje yndyrore. Diagnoza me e mundshme është:

- A) Semundja celiaki
- B) Giardiasis
- C) Deficit i laktazës
- D) Fibroze kistike
- E) Hipotiroidizem

52. Cila nga karakteristikat e mëposhtëme është tipike per konvulsionet febrile te thjeshta:

- A) Kriza te gjeneralizuara ne rast rritje te Temperaturës trupore ne fëmijët e cdo moshe.
- B) Kriza parciiale pa humbje te ndergjegjes.
- C) Kriza toniko-klonike te gjeneralizuara ne rastet e episodeve febrile ne fëmijët nga mosha 6 muaj ne 5 vjeç
- D) Kriza te gjeneralizuara ne fëmijët me deficite neurologjike te evidentuara gjate Temperaturës
- E) Risk i larte per te zhvilluar epilepsi ne te ardhmen.

53. Te gjitha pohimet e mëposhtëm qe lidhen me infeksionin HBV gjate shtatëzanisë dhe periudhes neonatale janë të vërteta, përvëç:

- A) Vaksina anti HBV është e kunder indikuar ne shtatëzani, pavaresisht gjendjes serologjike të nënës
- B) Rreth 70-90% e te porsalindurve te infektuar me HBV do te behen bartes kronik te HBsAg

- C) Skema e rekomanduar per vaksinimin dhe profilaksine passive per HBV te te porsalindurit ndryshon ne varesi te gjendjes serologjike e nënës.
- D) Vaksina kunder hepatitit B është universalisht e rekomanduar per te gjithe te porsalindurit ne terme
- E) Infeksioni paralindjes me HBV mund te çoje ne te ardhmen ne zhvillimin e një carcinome hepatoqelizore

54. Cila nga diagnozat është me e mundshme në një fëmijë 3 vjeç me të dhëna thematologjike te mëposhtëme:HB 11.5 g/dl,MCV 60, eritrocite 5.5×10^6 ?

- A) Sëmundje kronike
- B) Mungese ne vit B12
- C) Mungese hekuri
- D) Mungese ne acid folik
- E) Profil talasemik

55. Cili test është gjërësisht i perdorur per te monitoruar terapine me heparine?

- A) Koha e pjesshme e tromboplastines(aPTT)
- B) Koha e trombines (TT)
- C) Dozimi i një faktori specifik
- D) Numrimi i trombociteve
- E) Koha e protrombines(PT)

56. Cila nga gjendrat limfatike është me shpesh e prekur ne limfomen Hodgkin?

- A) Limfonodujt laterocervikal
- B) Limfonodujt inguinal
- C) Limfonodujt aksilar
- D) Limfonodujt ilo-mediastinal
- E) Limfonodujt lumboaortal

57. Cila nga shenjat apo simptomat e mëposhtme mund te mungojë ne një te porsalindur me meningit?

- A) Temperaturë
- B) Rigiditeti nukal
- C) Kriza convulsive
- D) Te vjella
- E) PCR e rritur

58. Një latant 7 muajsh qe paraqet te qara intermitente, te vjella dhe fece me mucus dhe gjak ka nevoje per:

- A) Koprokulture dhe solucione gluko-elektrolitike
- B) Trajtim me prokinetike
- C) Rx direkte abdomeni dhe barium enema
- D) Rx me contrast(barium test)
- E) Pozicion antirefluks

59. Parvovirusi B19 shkakton:

- A) Sëmundjen VI
- B) Mononukleozen infektive
- C) Sëmundjen V
- D) Ekzantema subitum

E) Semundja e IV

60. Vlerat e hematokritit ne lindje janë:

- A) 25-35%
- B) mbi 85%
- C) 70-85%
- D) 65-85%
- E) 45-65%

61. Hematuria asimptomatike ne moshat shkollore është prezente ne:

- A) 0,5-2% te femijeve
- B) 0-0,1% te femijeve
- C) 3-5 % te femijeve
- D) 5-10% te femijeve
- E) 8-15% te femijeve

62. Cila nga alternativat e mëposhtme mund te jete nderlikim i interventit kirurgjikal te hernies inguinale te lindur tek fëmijët?

- A) Një infekzion i rrugeve urinare
- B) Gastroektazi jatrogjene
- C) Retension urinar
- D) Një kist ne duktusin tireo-gloss
- E) Atrofi testikulare jatrogjene

63. Per te arritur te ashtequajturen Imunitetin ne komunitet (herD)immunity) është e nevojshme te vaksinohet:

- A) 50% e popullates receptive
- B) >90% e popullates receptive
- C) 70% e popullates receptive
- D) >80 % e popullates receptive
- E) >60 % e popullates receptive

64. Nga cila prej deficiteve ushqimore te mëposhtëme janë te kercenuar latantet e ushqyer vetem me qumesht dhie?

- A) Deficit ne folate
- B) Deficit ne vit B6
- C) Deficit ne vit E
- D) Deficit/mungese ne vit A
- E) Deficit ne thiamine

65. Ne diagnozen definitive te sepsis neonatal, cila nga alternativat e mëposhtëme është vendimtare per vendosjen e diagnozes?

- A) Pozitiviteti i hemokultures
- B) Simptomatologjia e organit
- C) Eritrosedimenti
- D) Temperatura
- E) Pergjigjja klinike gjate antibiotiko-terapise

66. Cila nga sëmundjet e trashegueshme ka një kuader klinik qe karakterizohet nga infeksione te shpeshta dhe deficit te aftesise se neutrofileve per te shkatterruar bakteret e fagocituara?

- A) Semundja granulomatoze kronike
- B) Semundja Wilson
- C) Fibroza kistike
- D) Agamaglobulinemia
- E) Neutropenia kongenitale

67. Një te porsalinduri i behet një ekzaminim objektiv. Cila nga shenjat nuk sugjeron per ndryshime pathologjike?

- A) Akrocianoze
- B) Frekuencia respiratore=70/min
- C) Sufel sistolik I lehte 1-2/VI
- D) Hepar 2cm nen harkun brinjor
- E) Zona te pigmentuara ne nivelin lumbosakral

68. Te gjitha pohimet rreth infeksionit te Hemofilus influenza tipi b janë të vërteta përveç:

- A) I identifikueshem ne mikroskop pas ngjyrimit me Gram
- B) Godet kryesisht fëmijët mbi 7 vjeç
- C) Mund te shkaktoje celulit
- D) Toksidi tetanik sherben si proteine conjuguese per vaksinen.
- E) Është pergjejges per epiglotitin

69. Te gjitha pohimet e mëposhtëme janë të vërteta, përveç:

- A) Fontanela e perparme mbyllt ne vitin e pare te jetes
- B) Fontanela posteriorembyllt në moshën 3 mujore
- C) Fontanela e perparme (anteriore) është e gjere ne rastet me hipotiroidizem
- D) Fontanela e perparme mbyllt me vonese ne raktizem
- E) Fontanela e perparme mbyllt me shpejt ne hipertiroidizem

70. Një fëmijë 15 muajsh paraqet kolle paroksizmale e shoqëruar me vjella. Trajtimi me cilën nga medikamentet e mëposhtëme mund te jape rezultatet terapeutike me te mira?

- A) Ampicilinë
- B) Cefaclor
- C) Eritromicinë
- D) Kortikosteroid
- E) Rimfapicina

71. Një fëmijë 10 vjeç ka kaluar një infeksion te rrugeve te siperme respiratore para 5 ditesh, është trajtuar me aspirine si antipiretik dhe gjendja dukej e permirësuar. Tani shtrohet në urgjencëme Temperaturë, te vjella profuze dhe letargji. Ne ekzaminimin objektiv vihet re hepatosplenomegali e lehte. Ekzaminimet laboratorike tregojne per një rritje te bilirubines totale, te transaminazave dhe amonemise. Cila nga opzionet e mëposhtëme perben diagnozen me te mundshme?

- A) Hepatit A (HAV)
- B) Hepatit i shkaktuar nga barnat
- C) Mononukleoza infective
- D) Sindromi Reye
- E) Sindromi Gilbert

72. Te gjithe shenjat dhe simptomat e mëposhtëme janë tregues te dehidrimit akut ne fëmijë, përveç?

- A) Hipertension

- B) Oliguri
- C) Renie ne peshe >10%
- D) Tharje e mukozave dhe lekures
- E) Somnolence, asteni

73. Cilat nga psindromat e mëposhtme është shkaku kryesor i insuficences respiratore te fëmijët obeze?

- A) Pneumotoraksi
- B) Apnea e gjumit
- C) Insuficiencia cardiake congestive.
- D) Astma
- E) Refluksi gastroezofageal.

74. Cilat nga etapat e mëposhtë me te zhvillimit psikomotor karakterizojnë një fëmijë 10 muajsh?

- A) Te ecurit
- B) Te ulet vetem dhe te ngrihet ne kembe duke e ndihmuar
- C) Te shkarraviturit me një laps
- D) Te folurit
- E) Te ndertoje një kulle me 2-3 kuba

75. Cila nga anomalite e mëposhtëme kardiovaskulare është me shpesh e hasur ne sindromin Williams?

- A) Stenoze aortale supravalvulare
- B) Prolaps i valvules mitrale
- C) Difekt ne septumin atrio-ventrikular
- D) Koarktacion aorte
- E) Stenoze e a.pulmonare

76. Ne traumat e heparit, cila nga të dhënat mëposhtme diagnostike mund te perdoret?

- A) Cistografia
- B) Urografia
- C) Klizem me barium.
- D) TAC cerebrale
- E) Ekografia abdominale

77. Te gjitha pohimet e mëposhtëme shkojne me diagnozen e sindromit Turner ne një paciente adoleshente, përveç?

- A) Kariotipi 45,X
- B) Stature e shkurter
- C) LH e rritur dhe FSH e ulur
- D) Amenorre primare
- E) Koarktacion i aortes

78. Një adoleshent ve re një mase ne forme qese jo te dhimbshme ne anen e majte te skrotumit. Cila nga diagnozat e mëposhtme është me e mundshme?

- A) Hidrocele
- B) Epididimit
- C) Varikocele
- D) Torsion i testikulit

E) Torsion i appendix testis (hydatid Morgagni)

79. Cili është "standarti i arte", per diagnostikimin se sëmundjes se Hirschprung?

- A) Ph-Metria
- B) Klizma opake
- C) Manometria anorektale.
- D) Echografi abdominalne
- E) Biopsia rektale

80. Një nene sjell fëmijën 4 vjeçar tek pediatri sepse ka hemorragji nga hundet cdo dite, një gjakederdhje e vazhdueshme ne sasi te paket nga nares dexter. Cila nga mundesite e mëposhtme është shkaku me i shpeshtë i epistaksit ne popullaten pediatrike?

- A) Rinit alergjik
- B) Semundja Von Willebrand
- C) Zakoni i te futurit te gishtave ne hunde
- D) Purpura trombocitopenike idiopatike
- E) Angiofibrome nasale

81. Nena e një latanti 2 muajsh është e shqetesuar nga një artikull ne gazete qe flet per SIDS (Sindromi i vdekjes se papritur) dhe pyet cilet janë faktoret e riskut për këtë patologji. Te gjitha indikimet qe i jep nënës janë të vërteta, përveç?

- A) Ushqyerja artificial
- B) Hipertermia ambientale
- C) Duhanpirja e nënës ne shtatëzani
- D) Anamneze familjare positive per raste te meparshme me SIDS
- E) Qendrim permbysh ose anash jo i sigurte gjate nates

82. Cili është shkaku me i shpeshtë i hipoglicemise ne një femije<1vjeç?

- A) Malabsorbimi
- B) Hipopituitarizem
- C) Hipoglicemia këtotike
- D) Deficiti enzimatik i neoglukogenezes
- E) Hiperinsulinizem

83. Te gjitha pohimet e mëposhtme mbi renien ne peshe ne ditet e para te jetes janë korrekte, përveç?

- A) Mund te jete deri ne 15% ne prematuret.
- B) Vjen nga humbja e shprehur e mekoniumit dhe lengjeve
- C) Pesha e lindjes duhet te rekuperohet brenda dites se 5 te jetes
- D) Vjen nga mungesat relative kalorike ne 2-3 ditet e para
- E) Konsiderohet fiziologjike një humbje rrëth 10% te peshes se lindjes

84. Diagnoza e sëmundjes Werding-Hoffman është shumë e mundshme në një fëmijë me hipotoni te rende qe manifestohet me cilën prej shenjave te mëposhtëme?

- A) Reflekset tendinoze te thella normale
- B) Fashikulacion (dridhje) e gjuhes
- C) Konvulsione
- D) Temperatura te herepas'hereshme
- E) Atrofi e nervit optik

85. Gjaku komplet i një pacienti tregon ulje te vellimit korpuskular dhe ulje te numrit te retikulociteve. Cila nga diagnozat e mëposhtëme është me e mundshme?

- A) Anemia ferriprivë.
- B) Talasemia major
- C) Anemia ne sëmundjet kronike
- D) Profil talasemik
- E) Anemia nga deficit i acidit folik

86. Një fëmijë 3 vjeç paraqet Temperaturë 39 C, rigiditet nukal prej 3 ditesh. Ne ekzaminimin objektiv vihet re hiperemi e farinksit, shtim te konsistencies se limfonodujve cervical anterior dhe posterior si dhe rritje te rezistencies gjate fleksionit te qafes.

- A) Tampon faringeal dhe peniciline per 10 dite nga goja
- B) Test per anticorpet heterofile
- C) Tampon faringeal dhe peniciline per 7 dite nga goja
- D) Punksioni lumbar
- E) Tampon faringeal, formule leukocitare dhe rivleresim pas 24 oresh

87. Te gjithe faktoret e mëposhtëm janë te perfshire ne patogenezen e bronkodisplazise, përvëç:

- A) Infekzioni
- B) Ikteri i parakohshem.
- C) Prematuritet
- D) Oksigjenoterapia
- E) Ventilimi mekanik

88. Një vajzë 9 vjeçe ishte ne gjendje shendetesore shumë te mirë para 10 oresh, kur filloi te shfaqte letargji, te vjella, te qara intermitente me retraktim te gjymtyreve te poshtme ne nivel te barkut. Ne qendren ambulatore defekon fece me pak gjak dhe xhelatinoze. Diagnoza me e mundshme është:

- A) Stenoze pilori
- B) Invaginim intestinal
- C) Infekzion i rrugeve urinare
- D) Apendisitis
- E) Ulçer duodenale

89. Vleresimi klinik per te percaktuar pikezimin Apgar behet ne:

- A) 1min,3min ,6min
- B) 1min,5min,10min
- C) 1min,6min ,8min
- D) 3min,6min,9min
- E) 3min,10min,20min

90. Traumat abdominal mund të jenë shkak i abdomenit akut:

- A) Po, gjithmone
- B) Vetem nese shoqerohen me trauma kraniale
- C) Po, ndonjehere
- D) Vetem nese shoqerohen me trauma torakale
- E) Vetem ne prani te frakturave te gjymtyreve te poshtem

91. Cila nga pohimet e mëposhtme mbi sindromin Berger është korrekte:

- A) Nivelet serike te C3 janë te ulura

- B) Depozitimet mezangiale janë kryesisht te perbera nga IgG
- C) Është me e shpeshtë ne femra
- D) Proliferimi mezangial është I dokumentuar ne mikroskop optic
- E) Trajtimi nuk mund te behet me imunosupresore

92. Cila nga shenjet e mëposhtëme është e nevojshme per te bërë një diagnoze te ADHD (crregullim i hiperaktivitetit dhe deficit i vemandjes):

- A) Impulsivitet
- B) Paaftesi per te mesuar
- C) Shfaqje para moshes 10 vjeç?
- D) Anamneze per trauma ne lindje
- E) Moter/vella me diagnoze te ADHD

93. Një fëmijë me fibroze kistike ka pneumoni te shkaktuar nga *Staphylococcus aureus*. Femija pa pritur ben një detres respirator, zbehje te zhurmave respiratore ne anen e majte te toraksit dhe devijim te trakese ne te djathte. Cila nga pohimet e mëposhtëme është diagnoza me e mundshme:

- A) Emfizeme
- B) Versament pleuristik
- C) Infarkt pulmonar.
- D) Sindrom i detressit respirator tek i rrituri
- E) Rupture e një pneumatocele nen trysni

94. Cili është "shkaku me "i shpeshtë ne hipotiroidizmin juvenile?

- A) Mungesa ne jod
- B) Tiroiditi subakut
- C) Tiroiditi Hashimoto
- D) Struma e thjështë
- E) Karcinoma tiroidiene

95. Cili nga barnat e mëposhtëm mund te shkaktoje rash morbiliform ne mononukleozen infective?

- A) Meticilina
- B) Tetraciklina
- C) Eritromicina
- D) Ampicilina
- E) Difenilhydantoina

96. Një fëmijë 3 vjeç paraqet temperaturë, rash kalimtar, artrit, hepatosplenomegali, versament perikardiak, eritrosedimentacion te rritur, leukocitoze, neutrofili. Cila nga alternativat e mëposhtëme është me e mundshme?

- A) Ethe reumatizmale acute
- B) Artrit rheumatoid juvenile
- C) Lupus eritematoz sistemik(LES)
- D) Semundja Lyme
- E) Spondiliti ankilozant

97. Cila nga karakteristikat klinike te mëposhtëme është tregues i një urgjencë neurologjike-neurokirurgjike në një fëmijëme cefale akute?

- A) Prania e shenjave neurologjike shoqeruese
- B) Lloji i dhimbjes

- C) Prania e fotofobise
- D) Intensiteti i dhimbjes
- E) Zgjatja e dhimbjes

98. Cila nga këto rrregullime elektrolitike është tipike per fibrozen kistike?

- A) Acidoza metabolike
- B) Alkaloze e kompensuar
- C) Alkaloza hiperkloremike
- D) Alkaloza hipokloremike
- E) Acidoze respiratore

99. Cila nga gjendjet pasuese karakterizon sindromin TURNER?

- A) Hirsutizmi
- B) Vonese mendore
- C) Incidence e larte per sëmundje autozomike
- D) Incidence e larte per hipotiroidizem congenital
- E) Rrisk i larte per obezitet

100. Një latant tre javësh prezanton mikrocefali, kalcifikime cerebrale ne radiografine e kokes dhe verberi. Cila nga patologjite e mëposhtme është me e mundshme per te shpjeguar këto simptoma?

- A) Hemoragji subdurale bilaterale
- B) Agenesi cerebrale
- C) Eritroblastoze
- D) Infeksion nga citomegalovirusi
- E) Mikrocefali primitive

101. Cila nga anomalite kongenitale te mëposhtme haset me shpesh?

- A) Mielomeningocele
- B) Palatoskizi
- C) Fokomelia
- D) Hipospadia
- E) Deformime te kembeve

102. Cila nga pohimet e mëposhtme duhet ndjekur se pari ne ekzaminimet e femijes me traume te kraniunit?

- A) Inspeksion dhe palpacion te kokes
- B) Anamneze mbi rrethanat e traumes
- C) Kontroll i ekuilibrit acido-bazik
- D) Vlersimi i funksioneve jetesore
- E) Radiografi e kafkes

103. Per një rritje normale ne gjashte muajt e pare te jetes, cila nga vlerat e mëposhtme është me afer marrjes ditore te rekomanduar te proteinave?

- A) 0.2 g/kg
- B) 1.0 g/kg
- C) 10.0 g/kg
- D) 5.0 g/kg
- E) 2.0 g/kg

104. Cila nga manifestimet e mëposhtme do te pritej te gjendej në një fëmijëgjashte muajsh me një defekt te madh te septumit ventricular?

- A) Cianoze
- B) Predominim te hipertrofise se ventrikulit te djathë ne EKG.
- C) Zhurme e vazhdueshme
- D) Ulje te vaskularizimit pulmonar ne radiografi
- E) Zemer e zmadhuar

105. Cila është neoplazia malinjë me e shpeshtë tek fëmijët me te vegjel se pesembedhjete vjeçë?

- A) Leukemia
- B) Neuroblastoma
- C) Morbus HODGKIN
- D) Retinoblastoma
- E) Hepatoblastoma

106. Një bebe mashkull lindi ne javen e tridhjete e nente te shtatzanise me një peshe trupore 4500g. Te gjitha pohimet e mëposhtme mund të jenë shkak, përveç:

- A) Sindomi i Beckwith wiedman (hipoglicemja nga hiperinsulinemia, makroglosia etj)
- B) Diabet mellitus i nënës
- C) Pirja e duhanit nga nena
- D) Hidrops fetal
- E) Predispozite gjenetike

107. Shkaku me i shpeshtë i hipotiroidizmit congenital tek fëmijët është:

- A) Hipotiroidizem sekondar
- B) Deficit hipotalamik I TRH
- C) Defekt ne hormonogjeneze
- D) Diskinezia glandular
- E) Mungesa e jodit

108. Te gjitha shkaqet e mëposhtme janë pohime korrekte per anemine megaloblastike përveç:

- A) Malabsorbim intestinal
- B) Rezekcion i gjysmes distale te ileumit
- C) Dieta vegjetariane integrale
- D) Perdorim i zgjatur i trimetoprimes
- E) Hemoragji gastrointestinale

109. Si vihet diagnoza e Sëmundjes se Celiakise?

303. Femijet me obezitet te thjeshte prezantohen me shpesh:

- A) Pubertet te pershpejtuar
- B) Moshe kockore te vonuar
- C) Shtat me i shkurter sesa i moshatareve
- D) Shtat me i larte se i moshatareve
- E) Asnjera

304. Ne 10 ml urine te mbledhura ne kushte te fresketa, te egzaminuara ne terren ushqyes te mire, hematuria mikroskopike perkufizohet si prezenca e te pakten:

- A) 0-1 rruaza te kuqe per fushe
- B) 3-5 rruaza te kuqe per fushe
- C) 3-10 rruaza te kuqe per fushe
- D) >10 rruaza te kuqe per fushe
- E) Asnjera

305. Si parndalohen kompikacionet reumatizmale te Skarlatines?

- A) Me izolimin e femijeve te infektuar
- B) Me penicillin per 10 dite
- C) Me ampicillin per 6 dite
- D) Me vaksinimin masiv
- E) Asnjera

306. Cfare shenje ose simptome duhet kerkuar tek nje latant ne te cilin dyshohet per refluks gastro-ezofageal patologjik?

- A) Krizat e apnese
- B) Anemia ferodeficitare
- C) Hemoragjia gastro-intestinale
- D) Vonesa ne rritje dhe anoreksia
- E) Te gjitha

307. Mundesite e infektimit nga Toxoplasma per njeriun jane:

- A) Kontakti me macet
- B) Ngrenja e perimeve jo te lara mire
- C) Ngrenja e mishit te pa gatuar mire ose krudo
- D) Kontakti me delet
- E) Te gjitha

308. Zmadhimi i gjendrave limfatike ne semundjen e gervishtjes se maces regredon menjehere mbas:

- A) 1-2 muaj
- B) 1-2 javë
- C) 1-2 dite
- D) 6 muaj
- E) Te gjitha

309. Puberteti prekoks shoqerohet me:

- A) Rritje te nivelit te gonadotropinave
- B) Ulje te nivelit te gonadotropinave
- C) Vonese te moshes kockore
- D) Ritme te ulta rritje
- E) Te gjitha

310. Cila nga vitaminat keshillohet te shtohet ne muajt e pare te femija qe ushqehet me gji?

- A) Vitamina A
- B) Vitamina D
- C) Vitamina E
- D) Vitamina C
- E) Te gjitha

311. Kur ikteri konsiderohet fiziologjik?

- A) Kur shfaqet brenda 24 h
- B) Kur shfaqet mbas 24 h
- C) Kur bilirubina kalon vleren 20mg/dl
- D) Kur dominon bilirubina direkte
- E) Asnjera

312. Diarreja akute në foshnje duhet të trajtohet me:

- A) antibiotikë
- B) antiemetik
- C) antiviral
- D) rehidrim oral
- E) rehidrim endovenoz

313. Cili është shkaku më i shpeshtë i malabsorbimit kronik në një fëmijë në moshë shkolllore?

- A) Divertikuli Mekel
- B) Sëmundja Chron
- C) Celiakia
- D) Fibroza cistike
- E) Sindromi i zorrës të irrituar

314. Në fund të vitit të parë të jetës një fëmijë normal duhet të peshojë:

- A) 9-11 kg
- B) 13-14 kg
- C) 16-17 kg
- D) 19-20 kg
- E) 8-9 kg

315. Shkaktari më i shpeshtë i sepsis neonatal është:

- A) streptokoku beta hemolitik i grupit A
- B) streptokoku beta hemolitik i grupit B
- C) stafilokoku aureus
- D) H.Influenzae tip B
- E) N. Meningitis

316. Shkaku më i shpeshtë i hematurisë makroskopike tek fëmija është:

- A) sindroma nefritike
- B) tumori renal
- C) infekzioni i rrugëve urinare
- D) koagulopatia
- E) trauma renale

8. Gastrohepatologji e Mjekësia Ligjore, Etika e Deontologji

1. Cili është funksioni fiziologjik më i rëndësishëm i acideve biliare?

- A) Favorizon eskretimin e substancave toksike
- B) Favorizon absorbimin e vitaminës B12
- C) Ruan pH e duhur intestinal
- D) Favorizon absorbimin e aminoacideve
- E) Favorizon absorbimin e yndyrnave

2. Në cilin prej rasteve të mëposhtme është transmural lezioni intestinal?

- A) Morbus Crohn
- B) Celiakia
- C) Koliti ulçeroz
- D) Asnjëra prej këtyre
- E) Sëmundja e Whipple

3. Një punëtor 35 vjeçar bën një kontroll ambulator për të vlerësuar gjëndjën me diarre dhe rënië në peshë. Nëpërmjet ezofagogastroduodenoskopisë, që u realizua për marrijen e biopsisë në zorrën e hollë, u vu re eritemë e ezofagut, me disa eroziona, dy ulçera gastrike si dhe ulceracione të shumta duodenale. Në biopsi u vu re rrafshim i vileve intestinale. Cili prej ekzaminimeve të mëposhtmë do të krye si hapin pas ardhës diagnostikues?

- A) ERCP (Kolangiopankreatografi retrograde endoskopike)
- B) Kolonoskopi
- C) Kërkohen anti-trupat anti-endomisium dhe anti-gliadinë
- D) Gastrinemia
- E) Testin e Schilling

4. Kolangjitet shkaktohen më shpesh nga:

- A) Përdorimi i pijeve të ftohta nga pacientë me litiazë multiple të rrugëve biliare
- B) Bakteret Gram + dhe Gram - që vijnë nga zorrët
- C) Efekti detergjent i acideve biliare
- D) Disfunktioni i sfinterit të Oddit dhe autodigestioni nga enzimat pankreatike që kanë bërë refluks në rrugët biliare
- E) Bakteret Gram + që vijnë më shpesh nga arteria hepatike

5. Të gjitha gjendjet e mëposhtme janë shkaktare të pseudoobstrukzionit intestinal kronik, përveç:

- A) Sklerodermia
- B) Hipertiroidizmi
- C) Diabeti melitus
- D) Përdorimi i antidepresivëve triciklikë
- E) Amilidoza

6. Lezionet e Morbusit Celiak hasen në nivelin e:

- A) Stomakut
- B) Vetëm jejunum
- C) Ileusit
- D) Duodenit dhe jejunumit
- E) Vetëm duodenit

7. Cila prej patologjive mund të shfaqë ascit:

- A) Defiçiti i disakaridazës
- B) Retokoliti ulçeroz
- C) Steatoza hepatike
- D) Sindroma nefrozike
- E) Tireotosikoza

8. Cilët janë parametrat laboratorikë më të përdorshëm për të monitoruar procesin inflamator në hepatitin kronik:

- A) Kriprat biliare totale
- B) Transaminazat dhe gamaglobulinat sierike
- C) Bilirubinemia e fraksionuar
- D) Kohën e protrombinës
- E) Fosfataza alkaline

9. Të gjitha gjendjet e mëposhtme janë faktorë rreziku për kolelitiazën kolesterinike, përveç:

- A) Retokoliti ulçeroz
- B) Terapia me klofibrat
- C) Terapia me estrogjene
- D) Rezekzioni kirurgjikal i ileusit
- E) Obeziteti

10. Simptoma e djegies retrosternale është tregues specifik për:

- A) Ulçer gastrike
- B) Ulçer duodenale
- C) Refluksi ezofageal

- D) Gastriti autoimun
E) Gatrati nga Helicobacter pylori

11. Një murator 21 vjeçar, ka bilirubineminë totale= 2.3 mg/dl dhe me fraksionin e drejtë= 0.3mg/dl. Nuk ka histori familjare për hepatopati, nga anamneza evidentohet se pi rrëth 40 gr alkol në ditë, nuk ka simptoma të tjera ose shenja hepatopatie. Hemokromi, numërimi i retikulociteve, ALT, AST, fosfataza alkaline, dhe GGT janë në normë, sikurse elektroforeza dhe INR. Gjithashtu, rezulton HBsAg negativ, HBsAb pozitiv, HBcAb negativ. Ju do të orientoheshit drejt:

- A) Sëmundja e Gilbert
B) Hepatit B në shërim
C) Hepatit C
D) Hepatit alkolik
E) Hepatit B aktiv

12. Mund të shfaqet hipoglicemi pas ushqyerjes (postprandiale):

- A) Morbusi Celiak
B) Në ulçerën duodenale
C) Prej një fistule gastro-kolike
D) Prej lemzës së vazhdueshme
E) Pas gastrorezekzionit subtotal

13. Cila prej sëmundjeve të mëposhtme mund të jetë shkak i komës hepatike?

- A) Hepatiti kronik aktiv me zhvillim cirrotik
B) Ikteri obstruktiv nga kalkuloza cirrotike
C) Sëmundja e Gilbert
D) Cirroza hepatike e dekompenuar
E) Cirroza septale jo e plotë

14. Për cilën arsyе realizohet testi me ksilozium (xylosio)?

- A) Për verifikimin e funksionalitetit të disakaridazës intestinale
B) Për verifikimin e funksionalitetit të pankreasit
C) Për të verifikuar integritetin e sipërfaqes së zorrës së hollë
D) Për verifikimin e fosforilimit të karbohidrateve në zorrë
E) Për vlerësimin e absorbimit të glicideve

15. Të gjithë medikamentet e mëposhtëm mund të përdoren në trajtimin e ulçerës peptike, përveç:

- A) Sucralfat
B) Omeprazol
C) Salazopirina
D) Ranitidin
E) Pirenzepin

16. Zotëria 52-vjeçar ka rrëth 2 vite me diarre dhe rënie të theksuar në peshë. Nuk ka histori për gjakderdhje gastroenterike dhe gjaku ocult në feçe në tre kampionë. Rrëfen se në të kaluarën ka qënë përdorues i rregullt i alkolist, por prej disa vitesh referon se nuk e ka përdorur më. Eshtë diabetik dhe mjekohet me insulinë. Para gjashtë vitesh ka bërë kolecistektomi. Ekzaminimet laboratorike rezultojnë normal, përveç një anemie të lehtë dhe nederkohë ekzaminimi radiologjik i zorrëve të holla e të trasha rezultoi normal. Cfarë do të sugjeronit:

- A) ERCP (kolanxhopankreatolografia retrograde endoskopike)
- B) Dozimi i yndyrnave në feçë
- C) Biopsia e jejunumit
- D) Testi i frymëmarries për disakaride
- E) Kolonoskopi me biopsi

17. Sëmundja e Crohn përfshin:

- A) Ilesusin, kolonin dhe pjesë të tjera të aparatit tretës
- B) Vetëm ileusin dhe kolonin
- C) Vetëm kolonin
- D) Vetëm ileusin
- E) Ileus, kolon dhe rektum

18. Sindroma e Mallory-Weiss verifikohet në rastin e:

- A) Tumori endokrin i pankreasit
- B) Të vjellat e vazhdueshme
- C) Diarrea sekretore
- D) Tumori hipofizar
- E) Polipoza xhiovanile

19. Në Morbusin Crohn më shpesh litiaza e kolecistës është e lidhur me:

- A) Rritje e absorbimit të kriprave biliare në ileus
- B) Hipovitaminoza
- C) Rritja e absorbimit të kolesterolit nga ileusi
- D) Bashkë shoqërimi me kolecistitin
- E) Reduktim i pool-it të kriprave biliare

20. Në cilën pjesë të traktit intestinal realizohet absorbimi i hekurit?

- A) I gjithë trakti intestinal
- B) Ileus
- C) Kolon
- D) Stomaku
- E) Duodeni

21. Cili është përbërësi kryesor i kalkujve biliarë radiotrasparentë:

- A) Kolesteroli
- B) Kripa biliare
- C) Urobilina
- D) Bilirubina
- E) Lecitina

22. Cili është tumor beninj më i shpeshtë i heparit?

- A) Neurofibroma
- B) Fibroma jaline
- C) Fibroadenoma
- D) Hemangioma kapilare
- E) Adenoma e duktuseve biliare

23. Peritoniti bakterial spontan përfaqëson një komplikancë të cilës prej patologjive të mëposhtme:

- A) Apendisiti akut
- B) Cirroza hepatike
- C) Divertikuloza e kolonit
- D) Sëmundja e Crohn
- E) Kolecistiti

24. Në cilët limfonoduj metastatizon më shpesh karcinoma e junksionit rekto-sigmoidal?

- A) Hipogastrikë
- B) Inguinalë
- C) Tripodit celiak
- D) Mezenterikët e sipërm
- E) Mezenterikët e poshtëm

25. Të gjithë parametrat e mëposhtëm përdoren për klasifikimin Child-Pugh të cirrozës hepatike, përveç:

- A) Kolineraza
- B) Asciti
- C) Bilirubina
- D) Albuminemi
- E) Encefalopatia

26. Cilat janë karakteristikat e Sindromës Plummer-Vinson?

- A) Dizfagi me glosit e pa alternime hematike
- B) Odinozagji me anemi sideropenike
- C) Eshtë përfshirja e ezofagut (dizfagi) e shoqëruar me anemi mikrocitike dhe glosit (inflamacion i gjuhës)
- D) Dizfagi paradoksale me anemi sideropenike dhe glosit
- E) Akalazi ezofageale me anemi makrocitike

27. Sindroma e Carolit përkufizohet si:

- A) Patologji neoplazike të rrugëve biliare intrahepatike
- B) Patologji biliare post-inflamatore
- C) Patologji e rrugëve biliare intrahepatike, karakterizuar nga zgjerime cistike multiple të duktuseve biliare segmentare
- D) Litiazë të rrugëve biliare intrahepatike
- E) Litiazë të rrugës principale biliare

28. Sindroma e Reye shoqërohet shpesh me cilën prej gjëndjeve?

- A) Diabeti
- B) Bruceloza
- C) Përdorimi i heparinës
- D) Hemokromatoza
- E) Përdorimi i acidit acetilsalicilik

29. Alternativat rreth sekretimit të acidit nga stomaku në kushtet e ulçerës peptike gastrike janë të gabuara, përveç:

- A) Mungon pas stimulimit maksimal
- B) Si në ulçerën duodenale
- C) Si në gjendjen normale
- D) Më e rritur se normalisht në kushtet e stimulimit bazal

E) Më e ulët se në gjendjen normale

30. Të gjithë elementët e mëposhtëm janë karakteristikë e kuadrit klinik të Morbusit të Wilson, përveç:

- A) Simptoma dhe shenjat e përfshirjes hepatike
- B) Unaza e Kayser-Fleischer
- C) Manifestime neurologjike
- D) Ulje të nivitet sierik të ceruloplazminës
- E) Ngjyra bronx e lëkurës

31. Cila prej shenjave ose simptomave të mëposhtme mundësojnë diagnozën diferenciale midis ulçerës duodenale të preföruar dhe pankreatitit kronik:

- A) Zhdukja e otuzitetit hepatik
- B) Shok hipovolemik
- C) Dhimbre të forta abdominale
- D) Masë e palpueshme e mezogastrit
- E) Të vjella të vazhdueshme

32. Të gjitha gjendjet e mëposhtme shoqërohen me rritje të incidencës së hepatokarçinomës, përveç:

- A) Infekzioni kronik nga virusi C
- B) Infekzion kronik nga virusi B
- C) Angioma hepatike
- D) Hepatopatia alkolike
- E) Hemokromatoza

33. Koloni absorbon në lidhje me masën që i vjen nga ileusi:

- A) Më pak se 50% të ujit dhe elektrolitëve
- B) Midis 50% dhe 90% të ujit dhe elektrolitëve
- C) Më shumë se 90% të ujit dhe elektrolitëve
- D) Më shumë se 90% të ujit dhe 50% të elektrolitëve
- E) 50% të ujit dhe të gjithë elektrolitet

34. Cila prej karakteristikave të mëposhtme përcakton "early gastric cancer"

- A) Prek të gjithë paretin gastrik
- B) Prek tunikën muskulare
- C) Prek tunikën sieroze
- D) Prek mukozën ose submukozën gastrike
- E) Prek të gjithë stacionet limfonodale satelitare

35. Cila prej gjendjeve shoqërohet me praninë e antitrupave anticitoplazminë të neutrofileve (ANCA)?

- A) Cirroza biliare primare
- B) Hepatiti autoimun tip I
- C) Kolangiti sklerozant primitiv
- D) Hepatiti autoimun tip II
- E) Hepatokarcinoma

36. Cili prej medikamenteve është i përfshirë në zhvillimin e insuficencës hepatike akute:

- A) Kontraceptive të orale

- B) FANS
- C) Rifampicina
- D) Tetraciklina
- E) Paracetamoli

37. Qelizat oxintike (parietale) janë të lokalizuara në mukozën e:

- A) Trupit dhe fundusit
- B) Antrumit dhe trupit
- C) Fundusit dhe antrumit
- D) Antrumit dhe pjesës circumkardiale
- E) Zona prepilorike

38. Cila prej alternativave është e vërtetë:

- A) Merkaptanet derivojnë nga metabolizmi intestinal i glutaminës
- B) Aminoacidet aromatike janë: triptofani, fenilalanina, tirozina dhe metionina
- C) Era e një pacienti me cirrozë është sekondare nga hiperamoniemia
- D) Encefalopatia hepatike është çrregullim cerebral me rritje të komponentit neuroinibitor
- E) Terapia diuretike përmirëson encefalopatinë hepatike

39. Simptoma kryesore e pankreatitit akut është:

- A) Ikter
- B) Nauze e të vjella
- C) Diarre
- D) Dhimbja
- E) Temperaturë

40. Pankreatiti akut shkaktohet më shpesh nga:

- A) Litiaza e kolecistës
- B) Kalkuj intrahepatik
- C) Hiperlipidemi
- D) Litiaza e koledokut
- E) Abuzimi me alkolin

41. Të gjitha janë forma të diarresë sekretore, përveç:

- A) Diarrea nga infekzioni me vibrio cholerae
- B) Diarrea nga sindromi karcinoid
- C) Diarrea nga defiçiti i disakaridazës
- D) Diarrea nga VIPoma
- E) Diarrea nga infekzioni me Escherichia coli

42. Të gjithë këta parametra mund të shprehin një kolesterol, përveç njërit:

- A) Fosfataza alkaline
- B) 5-nukleotidaza
- C) Bilirubina
- D) Gamaglutamiltranspeptidaza
- E) Diamino-oksidaza

43. Cili është faktori etiologjik më i rëndësishëm i hipertensionit portal nga cirroza hepatike?

- A) Reduktimi i qarkullimit hepatik
- B) Nekrozë të qelizave hepatike

- C) Infiltrimi limfocitar
- D) Depozitimi biliar
- E) Septe fibrotike

44. Simptomatologja e dhimbjeve në ulcerën duodenale përmirësohet nga:

- A) Të rrish shtrirë në anën e majtë
- B) Jashtëqitja
- C) Gjumi
- D) Pas ushqimit
- E) Aktiviteti fizik

45. Në insuficencën hepatike akute të rëndë cili prej ekzaminimeve të mëposhtëm ka rëndësi prognostike?

- A) Transaminazat
- B) Koha e Quick
- C) Latikodeidrogjenaza
- D) Albuminemia
- E) Fosfataza alkaline

46. Kalkujt biliarë prej bilirubinat kalçiumi shfaqen më shpesh tek pacientët e prekur nga:

- A) Morbusi Crohn në ileus
- B) Rezekzioni ileal
- C) Retokoliti ulçeroz
- D) Ulçera peptike
- E) Anemja hemolitike kronike

47. Një pensionist 72 vjeçar (që ka punuar si marangoz) me kardiopati iskemike dhe SPOK, shtrohet në spital për bronkopneumoni dhe i përgjigjet mjekimit empirik me cefotaxime. Në ditën e gjashtë të shtrimit rishfaqet temperatura dhe nis dhimbja abdominale me diarre të ujshme. C'do të bënët në këto rrethana:

- A) Zëvendësimin e cefotaxime me clindamicine
- B) Test imunologjik duke kërkuar toksinat e clostridium difficile
- C) Klizmën e zorrëve të holla
- D) Kërkoni ezofagogastroduodenoskopinë me biopsi të jejunumit
- E) Kolonoskopi

48. Asciti i pa komplikuar tek një pacient cirrotik është gjithnjë i karakterizuar nga:

- A) Albuminemia $<3\text{g/dl}$
- B) Mungesa totale e qelizave inflamatore
- C) pH <7
- D) Pamje të turbullt
- E) 250 polimorfonukleatë/cc

49. Të gjitha sëmundjet e mëposhtme shkaktojnë cirrozë, përvëç:

- A) Deficiiti i alfa 1-antitripsinës
- B) Skistozomiaza
- C) Sëmundja e Gaucher
- D) Hepatiti nga virusi A
- E) Hepatiti nga virusi C

50. Cila prej alternativave të mëposhtme nuk është shenjë e apendisitit akut:

- A) Stranguri
- B) Anoreksi
- C) Dhimbe në kuadratin iliak të djathë
- D) Të vjella
- E) Temperaturë

51. Gastrinemia $> 1000 \text{ pg/ml}$ (norma $< 100 \text{ pg/dl}$) sugjeron më shumë për:

- A) Sindroma e Verner-Morrison
- B) Sindroma Menetrier
- C) Sindroma e Mallory-Wiss
- D) Sindroma e Zollinger-Ellison
- E) Sindroma e antriumit të ngetur

52. Kolestaza prej medikamenteve karakterizohet nga:

- A) Hiperbilirubinem kryesisht indirekte
- B) Hiperbilirubinem direkte që zgjat prej kohësh
- C) Mungesë të rritjes së gamaGT
- D) Mungesa e pruritit
- E) Eozinofili e theksuar ($> 20\%$)

53. Të gjitha manifestimet janë pjesë e kuadrit klinik të temperaturës mesdhetare familjare, përveç:

- A) Ikter
- B) Dhimbe abdominale
- C) Pleuriti
- D) Temperaturës
- E) Artralgji

54. Në rastin e sëmundjes divertikulare të zorrës së trashë, nuk ka asnjëherë lezione të tillë në:

- A) Ciekum
- B) Koloni ashendent
- C) Rektum
- D) Flesurën hepatike e të lienis
- E) Mund të formohen kudo

55. Një pacient paraqet rritje të kohës së protrombinës me 6 sek më shumë se normalja dhe trombocitet $45,000/\text{cc}$. Cili prej ekzaminimeve është i kundërindikuar?

- A) Paracenteza për diagnostikim
- B) Pozicionimin e sondës së Sengstaken-Blakemore
- C) Biopsi hepatike perkutane
- D) Kolonoskopia
- E) Gastroskopia

56. Në cilën prej sëmundjeve gjenden më shpesh komplikanca si fistulat (enteroenterike, enterokutane etj.)

- A) Celiakia
- B) Ulçera gastrike
- C) Koliti ulçeroz
- D) Kancer i zorrës së trashë

E) Morbusi Crohn

57. Stimulimi maksimal i sekretimit të acidit gastrik realizohet me anë të:

- A) Vip
- B) Glukagone
- C) Sekretina
- D) Kolecistokinina
- E) Pentagastrina

58. Alternativat e mëposhtme për sindromën e Zollinger-Ellison janë të sakta, përvëç:

- A) Shoqërohet me ulçerën peptike, që shpesh i përgjigjet shumë pak terapisë
- B) Shërohet pas zhdukjes së Helicobacter pylori
- C) Shoqërohet me hipergastrinemi të theksuar
- D) Ulçerat peptike mund të jenë të shumta
- E) Shoqërohet me diarre kronike

59. Në retokolitin ulçeroz, cila prej gjendjeve rrit rrezikun për kancer të kolonit?

- A) Rezistencë ndaj terapisë steroide
- B) Histori për megakolon toksik
- C) Prezencë të pseudopolipeve gjatë ekzaminimit endoskopik
- D) Prania e sëmundjes prej shumë kohësh
- E) Zhvillim të ashpër të sëmundjes

60. Nga cila prej gjendjeve të mëposhtme shkaktohet më shpesh obstruksioni i kolonit?

- A) Aderencat
- B) Volvolusi
- C) Hernia
- D) Divertikuliti
- E) Karcinoma

61. Cila prej alternativave të mëposhtme rrëth sindromës së Gilbert është e saktë?

- A) Ikteri spjegohet pjesërisht nga hemoliza
- B) Përdorimi i fenobarbitalit rrit nivelin e bilirubinës
- C) Përdorimi i kortizonit rrit nivelin e bilirubinës në gjak
- D) Biopsia tregon për alternime të kanalikulave biliare
- E) Përdorimi i fenobarbitalit shkakton në 4-8 ditë një ulje të dukshme të bilirubinës në gjak

62. Të gjitha alternativat e mëposhtme rrëth sëmundjes së Menetrier janë të sakta, përvëç:

- A) Mund të shkaktoj anemi nga gjakderdhja e fshehur
- B) Eshtë patologji e stomakut
- C) Mund të shoqërohet me hipoalbuminemi
- D) Eshtë patologji e zorrës së hollë
- E) Diagnoza bazohet tek ekzaminimi endoskopik ku merret biopsi

63. Sindroma e Crigler-Najjar karakterizohet kryesisht nga rritja në gjak e:

- A) Bilirubinës direkte
- B) Kripgrave biliare
- C) Bilirubinës indirekte
- D) Fosfatazës alkaline
- E) Gama-GT

64. Cili prej parametrave të gjetura në likidin e ascitit është tregues për diagnostikimin e peritonitit bakterial spontan:

- A) Pamja si qumësht
- B) Prania e 300 leukociteve totale/mm³
- C) Prania e 300 granulociteve neutrofile/mm³
- D) Prania e më shumë se 3g% e proteinave
- E) Pamje hemorragjike

65. Të gjitha alternativat e mëposhtme rreth cirrozës biliare primare janë të sakta, përvëç:

- A) Shoqërohet shpesh me prurit
- B) Një përqindje e lartë e pacientëve rezultojnë pozitivë për antitrupat antimitokondër
- C) Trajtimi më efikas është ai me D-penicilaminën
- D) Eshtë më e shpeshtë tek femrat
- E) Përdorimi i acideve biliare mund të jetë i dobishëm kontrollin e simptomave

66. Virusi delta është virus difektoz, që për tu replikuar ka nevojë për:

- A) Citomegalovirus
- B) Virusi i hepatitit A
- C) Virusi i hepatitit B
- D) Virusi i Epstein-Barr
- E) Hepatiti G

67. Të gjitha shenjat e mëposhtme gjenden në insuficencën hepatike si pasojë e heparitit kronik C, përvëç:

- A) Purpura e palpueshme në ekstremitetet e poshtme
- B) Unaza e Kayser-Fleischer
- C) Flapping tremor
- D) Otuzitet që zhvendoset dhe është dekliv gjatë perkusionit të abdomenit
- E) Nishanet arakniformë

68. Hemorragja nga varicet ezofageale është komplikancë e:

- A) Hipertensionit arterial
- B) Insuficença hepatike
- C) Insuficencës kardiake të djathë
- D) Kakezia nga neoplazia
- E) Hipertensionit portal

69. Cili është efekti që jep gastrina gjatë aktivitetit të saj fiziologjik:

- A) Stimulon rritjen e cck (kolecistokinina)
- B) Stimulon sekretimin e acidit klorhidrik
- C) Përshpejton zbrazjen gastrike
- D) Stimulon sekretimin e bikarbonateve
- E) Stimulon e skretimin e lëngut biliar

70. Cili prej alternimeve hematokimike është më i shpeshtë në morbusin Celiak:

- A) Hiposideremi
- B) Hipolipemi
- C) Hipoalbuminemi
- D) Hipokalçemi

E) Hipofosforemi

71. Në kushtet e malabsorbimit të gjeneralizuar, cila është alternativa e saktë?

- A) Steatorrea është gjithnjë prezent
- B) Jashtëqitja karakterizohet nga vëllim fekal i ulët dhe numër i lartë i herëve të jashtëqitjes
- C) Në pankreatitin kronik malabsorbimi i gjeneralizuar është paraprakisht prezent
- D) Steatorrea shoqërohet me steatozë hepatike
- E) Feçet janë gjithnjë likide

72. Cila është metodika më e përshtatshme për të diagnostikuar refluksin gastroezofageal acid?

- A) pH-metria ezofageale e 24 orëve
- B) Manometria ezofageale
- C) Ekzaminimi radiologjik i ezofagut
- D) Ezofagogastroduodenoskopija
- E) Testi i Bernstein

73. Të gjitha alternativat e mëposhtme rreth akalazisë janë të sakta, përveç njëris:

- A) Mund të shkaktojë dizfagi, dhimbje toraksi, regurgitim
- B) Karakterizohet nga alternimet gjatë relaksimit të sfinterit ezofageal të poshtëm
- C) Mund të trajtohet me toksinën e botulinës
- D) Nifedipina kontrollon simptomat tek shumë pacientë
- E) pH-metria ezofageale është ekzaminimi më i domosdoshëm për ta diagnostikuar

74. Të gjitha alternativat e mëposhtme janë shkak i malabsorbimit tek një pacient me sëmundjen e Crohn, përveç njëris:

- A) Lokalizimi i gjere në jejunum-ileal
- B) Fistula jejunum-kolike
- C) Kontaminimi bakterial i zorrës së hollë
- D) Sëmundja rekto-sigmoide aktive
- E) Mbetje nga rezekzioni intestinal i gjerë

75. Sekretimi gastrik i theksuar dhe ulcerat peptike përsëritëse vërehen në:

- A) Hipoparatiroidizëm
- B) Sindroma Dumping
- C) Sindroma e Mallory-Weiss
- D) Sindroma e Zollinger-Ellison
- E) Sindroma e Verner Morrison

76. Litiaza pigmentare e kolecistës ndodh më shpesh në:

- A) Aneminë hipokromike
- B) Aneminë hemolitike
- C) Hiperkolesterolemienë
- D) Ateroskleroza
- E) Pankretiti kronik

77. Cili prej medikamenteve është më i përshtatshmi për trajtimin e kolitit pseudomembranoz?

- A) Vancomicine
- B) Ceftazidime
- C) Streptomicine
- D) Mesalazine

E) Lincomicine

78. Në urinë nuk gjendet asnjëherë bilirubina indirekte sepse:

- A) Eliminohet nga veshka
- B) Pesha molekulare nuk e lejon filtrimin e saj glomerular
- C) Absorbohet tërësisht nga tubujt
- D) Nga kontakti me ajrin oksidohet menjëherë
- E) Nuk është hidrosolubil

79. Cila prej patologjive komplikohet më shpesh me megakolon toksik?

- A) Polopoza e përhapur e kolonit
- B) Retokoliti ulçeroz
- C) Megakoloni kongenital
- D) Divertikuliti i kolonit
- E) Koliti granulomatoz

80. Nuk shkakton hipertension portal?

- A) Cirroza biliare primitive
- B) Obstruksioni i fluksit venoz hepatik
- C) Tromboza e venës splenike
- D) Steatoza hepatike
- E) Cirroza hepatike post-hepatike

81. Nuk ka vlerë diagnostikuese realizimi i biopsisë intestinale në cilën prej sëmundjeve?

- A) Kompleksi Mycobacterium avium
- B) Sëmundja e Whipple
- C) Abetalipoproteinemia
- D) Agamaglobulinemia
- E) Defiçiti i folateve

82. Cili prej komplikacioneve nuk i bashkangjitet sëmundjeve inflamatore intestinale kronike:

- A) Eritema nodoze
- B) Spondiloartroza
- C) Uveiti
- D) Perikolangiti
- E) Ragada (fisura) anale

83. Sa është koha e inkubimit të një toksiinfekzioni ushqimor nga toksina stafilocokksike:

- A) 1 ditë
- B) 3-6 orë
- C) 20-30 minuta
- D) 2 ditë
- E) 5-8 ditë

84. Cili prej alternimeve metabolike favorizon neurotoksicitetin nga amoniaku?

- A) Hipersodiemia
- B) Hiperglicemja
- C) Acidoza
- D) Alkaloza
- E) Hiperkalçemja

85. Cili është komplikacioni më i shpeshtë i morbusit Crohn?

- A) Hemorragjia
- B) Obstruksioni
- C) Perforacioni
- D) Peritoniti
- E) Dermatiti herpetiform

86. Në sëmundjen e refluksit gastroezofageal, dizfagia kur është e pranishme mund të jetë:

- A) Vetëm funksionale
- B) Vetëm organike
- C) Dizfagia nuk është asnjëherë e pranishme
- D) As funksionale dhe as organike, duke qënë se dizfagia nuk është simptomë e kësaj sëmundjeje
- E) Funksionale dhe organike

87. Cili prej ekzaminimeve laboratorike është i vlefshëm për vlerësimin e shkallës së aktivitetit inflamatori tek hepatiti kronik:

- A) Dozimi i fasfatazemisë alkaline
- B) Dozimi i albuminemisë
- C) Dozimi i bilirubinemisë
- D) Dozimi i imunoglobulinave në gjak
- E) Gama-GT

88. Vitamina B12 orale, absorbohet në:

- A) Ileus
- B) Jejunum
- C) Stomak
- D) Kolon
- E) Duoden

89. Cila prej gjendjeve shoqërohet më shpesh me adenokarcinomën e ezofagut?

- A) Ezofagu i Barret
- B) Alkolizmi
- C) Tiloza
- D) Akalazia
- E) Duhanpirja

90. Cila prej alternativave rrith hepatitit kronik autoimun të tipit I nukl është e saktë:

- A) Eshtë më i shpeshtë tek femrat
- B) Prek kryesisht të moshuarit
- C) Shoqërohet me praninë e antitrupave antinukël
- D) Shoqërohet me hipergamaglobulinemi
- E) Në përgjithësi i përgjigjet terapisë imunosupresive

91. Cfarë do të thotë dizfagi?

- A) Pirrozë
- B) Vështirësi në artikulimin e fjalës
- C) Pamundësi absolute në kalimin e ushqimit në ezofag
- D) Dhimbje krampiforme retrosternale pas deglutimit

E) Vështirësi në deglutim

92. Kuadri i një koleciste të zmadhuar të palpueshme tek një pacient pa ikter, sugjeron për:

- A) Kalkul në duktusin cistik
- B) Karcinoma e pankreasit
- C) Kalkuli i koledokut
- D) Karcinoma e ampulë së Vater
- E) Kalkulozë e kolecistës

93. Aktualisht cili është ekzaminimi më i dobishëm për diagnostikimin dhe trajtimin e kalkulozës së koledokut?

- A) Kolangio-RMN
- B) ERCP (kolangio pankreatografia retrograde endoskopike)
- C) Kolangiografja e.v
- D) TAC
- E) Ecotomografja e abdomenit superior

94. Kush nuk e karakterizon sëmundjen e heparit të yndyrosur jo alkolik (NAFLD):

- A) Shoqërimi me obezitet, diabet e hipertrigliceridemi
- B) Prevalencë e lartë në popullatën në përgjithësi
- C) Alternime të shpeshta të indekseve të metabolizmit të hekurit
- D) Zhvillim sistematik drejt insuficencës hepatike
- E) Parenkima hepatike bëhet hiperecogjene

95. Cila prej gjendjeve mund të ndërhyjë duke maskuar rritjen e amilazës në pankretitin akut?

- A) Hiperglicemja
- B) Hipertriglyceridemia
- C) Hipokalçemja
- D) Hiperamoniemia
- E) Hiperkolesterolemia

96. Cili prej medikamenteve nuk sugjerohet në zhdukjen e Helicobacter pylori:

- A) Sucralfati
- B) Omeprazoli
- C) Amoxicilina
- D) Claritromicina
- E) Bismuthi koloidal

97. Cili prej ekzaminimeve është më i pranueshëm për të diferencuar ikterin kolestatik prej obstruksionit të rrugëve biliare ekstra-hepatike nga ikteri kolestatik intrahepatik:

- A) Përcaktimi i bilirubinës direkte
- B) Ecografja hepatike
- C) Përcaktimi i fosfatazës alkaline
- D) Përcaktimi i gama-GT
- E) Dozimi i acideve biliare

98. Të gjitha sëmundjet shkaktojnë ascit, përvèç njërisë:

- A) Skompensi me stazë
- B) Mixedema
- C) Hipertiroidizmi

- D) Cirroza hepatike
- E) Tuberkuloza intestinale

99. Sindroma e Zollinger-Ellison shoqërohet me të gjitha gjendjet e mëposhtme, përvèç njëris:

- A) Sëmundja ulçeroze e rëndë
- B) Diarrea
- C) Hipersekrecioni acid gastrik, në kushtet bazale
- D) Hipergastrinemi
- E) Reduktimi i gastrinemisë pas stimulimit me sekretinë

100. Kush nuk e shkakton cirrozën hepatike?

- A) Hemokromatoza
- B) Infeksioni nga virusi C
- C) Inflamacioni kronik i rrugëve biliare
- D) Infeksioni nga virusi A
- E) Infeksioni nga virusi B

101. Anemia makrocitike shpesh shkaktohet nga:

- A) Gastriti atrofik i trupit gastrik
- B) Polipi rektal
- C) Hipertiroidizmi
- D) Sindroma me humbje të proteinave
- E) Karcinoma e ezofagut

102. Tre studentë kanë ngrënë së bashku dy ditë më parë (supë, mish me zarzavate dhe ëmbëlsirë me krem kanë paraqitur episodin e gastroenteritit febril. Analizat laboratorike tregojnë për hipopotasemi dhe qeliza inflamatore në feçë. Ky kuadër të bën të mendosh për:

- A) Kolera
- B) Toksiinfektion nga clostridium
- C) Toksiinfektion nga stafilocoku
- D) Salmoneloza
- E) Toksiinfektion nga Bacillus cereus

103. Si konfermohet diagnoza e infeksionit nga HCV?

- A) Prania e anti-HCV
- B) Transaminazat rriten të paktën 7 herë më shumë se vlera normale
- C) Prania e anti-HBc
- D) Prania e HCV-ARN
- E) Prania e anti-HBs

104. Diarrea e udhëtarit shkaktohet më shpesh nga:

- A) Staphylococcus aureus
- B) Herpes virus
- C) Escherichia coli enterotoksigjene
- D) Mycobacterius bovis
- E) Campylobacter jejuni

105. Infeksioni kronik nga virusi i hepatitit C shoqërohet më shpesh me:

- A) Panarteriti nodoz
- B) Sëmundja e Churg-Strauss

- C) Leuçemia me qeliza kapelute
- D) Purpura krioglobulinemike
- E) Polimialgja reumatike

106. Për qëllime anatomopatologjike dhe mjekoligjore, asnjë kufomë nuk mund ti nënshtrohet kryerjes së autopsisë pa kaluar të paktën:

- A) 4 orë nga vdekja
- B) 6 orë nga vdekja
- C) 24 orë nga vdekja
- D) 18 orë nga vdekja
- E) 12 orë nga vdekja

107. Cila nga shënjat e mëposhtme është patognomonike në vërtetimin e saktë dhe me vlerë ligjore të instalimit te vdekjes biologjike:

- A) Shfaqja e njollave hipostazike
- B) Ndalimi i frymëmarrjes dhe të qarkullimit të gjakut
- C) Humbja e ndërgjegjies
- D) Paraliza ndjesore dhe motore
- E) Humbja e refleksit corneal

108. Kush ka të drejtë të plotesojë një skedë vdekjeje, në rast të një vdekje natyrore :

- A) Vetëm mjeku ligor
- B) Vetëm mjeku kurues
- C) Vetëm mjeku anatomopatolog
- D) Vetëm mjeku i familjes
- E) Çdo mjek i zakonshëm

109. Në plagët e shkaktuara nga armët e zjarrit, vrima e hyrjes ndryshon nga vrima e daljes:

- A) Ka diametër të barabarte me kalibrin e predhës (plumbit)
- B) Paraqet gjithmonë një rrëth dërmishtjeje
- C) Paraqet përmasa më të mëdha
- D) Ka gjithmonë pamjen e një ylli

110. Forma e ekimozës :

- A) Varet nga struktura e veçantë anatomike e regionit dhe sasisë së gjakut të derdhur.
- B) Tregon intensitetin e forcës goditëse
- C) Varet nga mosha e të dëmtuarit
- D) Riprodhon gjithmonë në mënyre të saktë sipërfaqjen e mjetit goditës
- E) Varet nga seksi i të dëmtuarit

111. Njollat kufomore:

- A) Gjënden gjithmonë vetëm në pjesët e poshtme të trupit
- B) Janë tregues të një vdekje nga dhuna
- C) Paraqesin gjithmonë të njëjtën ngjyrë
- D) Janë shënjë e sigurtë e vdekjes biologjike
- E) Janë gjithmonë të domozdoshme për të kuptuar shkakun e vdekjes

112. Asnjë personel mjekësor nuk mund ti nënshtrohet një ndjekje penale, në se veprimi ose mosveprimi i tij në dëm të pacientëve nuk është i parashikuar në:

- A) Kodin e Punës

- B) Kodin Penal
- C) Kodin Deontologjik
- D) Kodin Civil

113. Shenjet e menjëhershme të vdekjes konsiderohen:

- A) Zbehja dhe humbja e elasticitetit të lëkurës.
- B) Njollat kufomore
- C) Shtangësia kufomore
- D) Ftohja kufomore

114. Të ashtëquajturat "plagë mbrojtëse", janë karakteristike:

- A) Për rastet fatkeqe
- B) Për vetvrasjet.
- C) Për aksidentet.
- D) Për vrasjet.

115. Plaga prerëse karakterizohet nga:

- A) Kënde të gjera.
- B) Buzë të rregullta.
- C) Mbizotërim i thellësisë ndaj përmasave të gjatësisë.
- D) Buzët të kontuzionuara

116. Kufoma dekompozohet më shpejtë

kur qëndron:

- A) I zhytur në ujë.
- B) I groposur nën tokë.
- C) Në mjeshtësi të jashtëm në siperfaqen e tokës.
- D) Lundron në siperfaqen e ujit

117. Në rastet e vdekjeve të dhunëshme, "Skeda e Vdekjes" plotesohet nga:

- A) Mjeku i familjes.
- B) Mjeku i poliklinikës.
- C) Prokurori.
- D) Mjeku ligjor.

118. Zhvillimi i "procësit të sapunifikimit" të një kufome të varrosur ndodh në mjeshtësi:

- A) Tokë me aciditet te lartë.
- B) Tokë rënore
- C) Tokë argjilore.
- D) Tokë moçalore.

119. Të ashtëquajturat "plagë hezituese", janë karakteristike:

- A) Për vrasjet
- B) Për aksidentet.
- C) Për vetvrasje
- D) Për rastet fatkeqe

120. Vrima e daljes në qitjet me armë zjarri në largësi, karakterizohet:

- A) Prania e brezit të fshirjes .
- B) Depozitim i faktoreve plotësues të qitjes.

- C) Permasa të mëdha të plagës.
- D) Buzët e plagës janë të përveshura nga brënda

121. E ashtuquajtura "lekura e pates" është shenjë karakteristike që shihet në siperfaqen e lëkurës së kufomës :

- A) Në rastin e mbytjes në lëngje
- B) Në rastin e djegjes nga zjarri (djegjet)
- C) Në rastin e varrjes në litar
- D) Në rastin e elektrotraumës

122. Vepra penale e mjekimit të pakujdeshëm ka për bazë :

- A) Gabimin mjekësor.
- B) Jatrogjenitë.
- C) Fatkeqsinë mjekësore.
- D) Vetëbesimin e tepruar mjekësor.

123. Prova materiale biologjike është:

- A) Predha
- B) Pështyma.
- C) Gjurmët e gishtërinjve.
- D) Teshat.

124. Sa duhet të jetë përqëndrimi i karboksihemoglobinës në gjak (helmimet nga oksidi karbonit) që të japë vdekje:

- A) deri ne 10%,
- B) deri 20%,
- C) deri 40%
- D) deri 30%,

125. Asifiksia mekanike nga varrja haset në praktikë si rast :

- A) Vetëvrasjeje
- B) Vrasjeje
- C) Aksidentale
- D) Fatkeqësi

126. Flokët (qimet) merren si mostra për të përcaktuar llojin e helmit në rastet e helmimeve me:

- A) Arsenik.
- B) Fostoksinë.
- C) Oksid karboni.
- D) Cianide.

127. E ashtuquajtura "Lafsha hemoragjike" është shenjë karakteristike e:

- A) Mbytjes me duar
- B) Mbytjes me lak
- C) Mbytja në lëngje
- D) Varjes

128. Shenja e figurës së Lichtenbergut është karakteristike në vdekjet nga:

- A) Helmimet.
- B) Hipotermia

- C) Mbytja në lëngjet
- D) Rrufeja.

129. Ngjyra e kuqe e celur e lëkurës së një kufome të helmuar është karakteristike për helmimet nga:

- A) Oksidi karbonit
- B) Heroina
- C) Fostoksina
- D) Zhiva

130. Në varrjen e plotë, fytyra e viktimës paraqitet :

- A) E zbehtë
- B) E mavjosur
- C) E zbehtë me pika hemoragjike,
- D) E mavjosur me pika hemoragjike

131. E ashtuquajtura shenjë e "çorapeve dhe dorezave te vdekjes" është karakteristike në vdekjet nga:

- A) Mbytja në lëngjet
- B) Elektriciteti
- C) Helmimi
- D) Rrufeja
- E) Djegja

132. Konsiderohen helmet të gazta që merren me anën e frymëmarrjes:

- A) Arseniku
- B) Fostoksina
- C) Parationi
- D) Mërkuri

133. Termi "bumper fracture", në rastet e aksidenteve automobilistike është shenjë patognomonike në:

- A) Thyerje të eshtrave të kokës.
- B) Thyerje të eshtrave të gjymtyrëve të poshtëm
- C) Thyerje të eshtrave të gjymtyrëve të sipërm.
- D) Thyerje të brinjëve.

134. Në ç'vënd dhe kur është kryer operacioni i parë transplantiv i zemrës:

- A) Në Afrikën e Jugut në vitin 1967
- B) Në Angli në vitin 1970
- C) Në Sh.B.A në vitin 1965
- D) Në Japoni në vitin 1971
- E) Në Francë në vitin 1969

135. "Maska ekimotike" e shkaktuar nga shtrëngimi i qafës krijohet nga shtypja:

- A) Vetëm e arterieve
- B) Arterieve dhe venave njëkohësisht
- C) Vetëm e venave
- D) Tubit të frymëmarrjes

136. Brazda e strangulacionit në qafë në rastin e varrjes është:

- A) Gjysëm rrethore vertikale
- B) Gjysëm rrethore oblike
- C) Gjysëm rrethore horizontale
- D) Rrethore e plotë

137. Sindroma e ashtuquajtura "Vdekja blu" shihet në rastet e vdekjeve nga:

- A) Rrufeja
- B) Hipotermia
- C) Hipertermia
- D) Mbytja në lëngje

138. Diatomet (planktomet) janë të rëndësishme për të përcaktuar shkakun e vdekjes në rastet:

- A) Të mbytjes në lëngje
- B) E hipotermisë
- C) E helmimit
- D) Djegjes?

139. Përcaktohet si plagosje e lehte, humbja e aftësisë së përkohshme në punë:

- A) Mbi 9 ditë
- B) Deri në 3 ditë
- C) Deri në 9 ditë.
- D) Mbi 19 ditë

140. E ashtuquajtura "Pozë e boksjerit në mbrojtje" është shenjë karakteristike në vdekjet nga :

- A) Rrufeja
- B) Mbytja në lëngje
- C) Droga
- D) Helmimi
- E) Djegja

141. Dukuria e "metalizimit" në lëkurë është karakteristike në :

- A) Traumat mekanike
- B) Traumat elektrike
- C) Traumat kimike
- D) Traumat asfiktike

142. Cila është detyra më parësore e një mjeku që kryen një autopsi mjekoligjore:

- A) Të leshojë skedën e vdekjes
- B) Të përcaktojë shkakun e vdekjes
- C) Të marrë pjesë në kqyrjen e kufomës në vendin e ngjarjes
- D) Të kryejë procedura konservuese mbi kufomën
- E) Të përcaktojë natyrën juridike të vdekjes

143. Bazuar në nenin nr.8 të ligjit "Për autopsitë" autopsia e një kufome duhet të kryhet:

- A) Menjëherë pas vdekjes
- B) 2 orë pas vdekjes
- C) 8 orë pas vdekjes
- D) 24 orë pas vdekjes
- E) 12 orë pas vdekjes

144. Cila është pjesa më e rëndesishme e aktit mjekoligjor:

- A) Hyrja
- B) Diskutimi mjekoligjor
- C) Përshkrimi
- D) Konkluzioni

145. Miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë për krijimin e Urdhërit të Mjekut është bërë:

- A) Në vitin 2000
- B) Në vitin 1996
- C) Në vitin 2005
- D) Në vitin 2008
- E) Në vitin 1994

146. Etika Mjekësore është shkenca që studion:

- A) Zbatimin e rregullave të protokolleve klinike të trajtimit të pacientit
- B) Parimet dhe normat e moralit mjekësor
- C) Zbatimin e rregullave mjekësore të parandalimit të sëmundjeve
- D) Normat ligjore penale në fushën e mjekësisë.

147. Në cilin dokument ndërkombëtar përcaktohen kriteret lidhur me të Drejtat e Pacientit:

- A) Në Deklaratën e Lisbonës
- B) Në Deklaratën e Helsinkit
- C) Në Deklaratën e Manilës
- D) Në Deklaratën e Tokios

148. Pakujdesia mjekësore e mjekut në trajtimin e pacientit ka për bazë:

- A) Paaftësinë profesionale
- B) Vetëbesimin e tepruar
- C) Infrastrukturën mjekësore të pamjaftueshme
- D) Mungesën e etikës së sjelljes
- E) Mungesën e iniciativës

149. Në cilin rast personeli mjekësor duhet të rruajë sekretin mjekësor të pacientit ndaj opinionit publik:

- A) Në gravidancat ekstrauterine jashtëmartesore
- B) Në sëmundjet tumorale
- C) Në sëmundjet infektive
- D) Në sëmundjet psikike
- E) Në sëmundjet e rënda dhe të pakurueshme

150. Cila konsiderohet vdekje biologjike:

- A) Vdekja klinike
- B) Vdekja celulare
- C) Vdekja letargjike
- D) Vdekja cerebrale

151. Një ikter i lehtë, i cili evidentohet duke parë sklerat e pacientit në drithë natyrale karakterizohet nga cilat vlera të bilirubinës serike:

- A) 1.5-2 mg/dl

- B) 3.5-4.5 mg/dl
- C) 2.5-3 mg/dl
- D) 1-1.5 mg/dl
- E) > 5 mg/dl

152. Në fazat fillestare të ileusit mekanik të kolonit kuadri klinik karakterizohet nga:

- A) të vjella fekaloide
- B) krampe abdominale
- C) mbrojtje muskulare abdominale
- D) mungesë e peristaltikës
- E) temperaturë subfebrile

153. Një pacient paraqitet në shërbimin ambulator me likid të lirë peritoneal, splenomegali, hemorroide, hiperaldosteronizëm, mungesë e faktorëve të koagulimit dhe hipoalbuminemi. Drejt cilës patologji duhet të orjentohemi ne kete rast?

- A) Insuficience kardiake kongenitale
- B) Neoplazi abdominale
- C) Sindrome nefritike
- D) Cirroze hepatike
- E) Sëmundje limfoproliferative

154. Cili prej markuesve të mëposhtëm është tipik për periudhën fillestare të hepatitit B?

- A) HbsAg; HbeAg; anti HBc-IgM
- B) HbsAg; anti HBc-IgG
- C) HbsAg; HbcAg; anti HBe
- D) HbsAg; anti HBe
- E) Anti HBs; anti HBc

155. Janë përgjegjës për defiçitin e vitaminës B12 të gjithë faktorët e mëposhtëm me përjashtim të:

- A) Dieta ushqimore e papërshtatshme (p.sh. dieta vegjetariane)
- B) Përthithja e pakët
- C) Eleminimi i shtuar
- D) Ulçera e ezofagut
- E) Keqpërdorimi

156. Metoda më e mirë për të vlerësuar një steatorre është:

- A) Testi me sakarozë
- B) Testi me ksilozë
- C) Dozimi i kriprave biliare
- D) Dozimi i yndyrnave fekale
- E) Biopsia e intestinit

157. Të gjitha pohime e më poshtme në lidhje me karcinomën e ezofagut janë të vërteta me përjashtim të:

- A) Incidenca është më e madhe në meshkuj (raporti mashkull/femër 3:1)
- B) Preket më shpesh segmenti i poshtëm i ezofagut
- C) Faktor riskant për zhvillimin e karcinomës është padyshim hernia hiatale
- D) Shpesh herë shoqërohet me fenomene disfagie
- E) Rreziku i sëmundjes është më i madh në njerëzit që pinë duhan se sa te ata që nuk pinë

158. Në urgjencë paraqitet një pacient 35 vjeç, që ka përdorur alkool për një kohë të zgjatur, i cili ankon për një dhimbje të fortë të menjëherëshme në regionin perumbelikal dhe epigastrik që përhapet në të dy flanket dhe në segmentin e poshtëm torakal të kolonës vertebrale. Cila është diagnoza më e mundshme në këtë rast?

- A) Ulçera gastrike
- B) Ulçera duodenale
- C) Sëmundje e kolon trasvers
- D) Pankreatit akut
- E) Sëmundje e kolonit zbritës

159. Pacientët që vuajnë nga refluksi gastro-ezofageal:

- A) Vetëm shqetësimë simptomatike pa sekela të rëndësishme
- B) Duhet të konsumojë sai të mëdha të karameleve me mente dhe çokollata
- C) Kanë rrezik për të zhvilluar astëm, SPOK (Sëmundje Pulmonare Obstruktive Kronike), fibrozë pulmonare
- D) Nuk kanë rrezik për të zhvilluar neoplazi
- E) Të gjitha pohimet janë të vërteta

160. Megakolon toksik paraqitet si ndërlikim i një prej këtyre situatave:

- A) Rektokoliti ulçeroz
- B) Sëmundja Crohn
- C) Divertikuloza e kolonit
- D) Enterokliti
- E) Stenozi neoplastike të kolonit

161. Pankreatiti akut mund të shkaktohet nga të gjitha elementët e poshtëshënuar me përshtim të:

- A) Kalkulozës biliare
- B) Abuzimit me alkool
- C) Ndërhyrjeve kirurgjikale në rrugët biliare ose në stomak
- D) Toksina
- E) Hipertrofia e pilorit

162. Shkaku më i shpeshtë i kolestazës ekstraheaptike është:

- A) Kalkuloza e koledokut
- B) Parazitozat
- C) Ligatura aksidentale e koleokut
- D) Pankreatiti akut
- E) Pankreatiti kronik

163. Shkaku i hipertensionit portal presinusoidal ekstrahepatik është:

- A) Parazitozat
- B) Leuçemia mieloide
- C) Cirroza heaptike
- D) Tromboza e venës porta
- E) Cirroza heaptike

164. Cili është një funksion i rëndësishëm fiziologjik i acideve biliare?

- A) favorizimi i ekskretimit të substancave toksike

- B) favorizimi i absorbimit të vitaminës B12
- C) ruajtja e Ph intestinal në normë
- D) favorizon përthihtjen e yndyrnave
- E) favorizon përthithjen e aminoacideve

165. Parametrit laboratorik më të nevojshëm për monitorimin e aktivitetit të një procesi inflamatori në hepatitin kronik janë::

- A) kriprat biliare
- B) bilirubina
- C) transaminazat dhe gamaglobulinat
- D) koha e protrombinës
- E) fosfataza alkaline

166. Simptoma e "pirozës retrosternale" është karkateristike për:

- A) ulçerën gastrike
- B) ulçerën duodenale
- C) gastritet autoimune
- D) sëmundjen e refluksit gastro-ezofageal
- E) gastritin nga Helikobakter pilori

167. Cila nga këto sëmundje mund të jetë shkaktare e komës hepatike?

- A) hepatiti kronik që ka evoluar drejt cirrozës
- B) ikteri obstruktiv nga kalkuloza
- C) cirroza hepatike e dekompenuar
- D) sëmundja Gilbert
- E) cirroza nga hepatiti B

168. Të gjithë barnat e poshtëshënuar përdoren në trajtimin e ulçerës peptidike, me përjashtim të:

- A) salazopirinës
- B) omeprazolit
- C) sukralfatit
- D) ranitidinës
- E) pirenzepinës

169. Cili është një element tjeter i rëndësishëm, përveç anamnezës, në vendosjen e diagnozës të pneumokoniozës?

- A) shinitgrafia pulmonare
- B) provat funksionale
- C) lavazhi bronkoalveolar
- D) radiografia torakale
- E) astrupograma

170. Silikoza shkaktohet nga:

- A) bioksidi i lirë i silicit
- B) bioksidi i lidhur i silicit
- C) tetraoksidi i silicit
- D) silici i lirë
- E) asnje nga përgjigjet

171. Ndërlikimi më i shpeshtë i asbestozës pulmonare është:

- A) pneumotoraksi
- B) mezoltelioma pulmonare
- C) karcinoma spinoqelizore
- D) adenokarcinoma pulmonare
- E) Asnjë nga përgjigjet

172. Prania e kalçifikimit në formën e "lëvozhgës të vezës" e limfonodujve hilar, është tipike e cilës pneumokoniozë?

- A) asbestozës
- B) beriliozës
- C) silikozës
- D) talkozës
- E) asnë nga përgjigjet

173. Plani Kombëtar i Shëndetësisë përfaqëson:

- A) bashkësinë e ligjeve që rregullojnë aktivitetin mjekësor kombëtar
- B) rregullat për organizimin e shërbimit shëndetësor
- C) rregullat për aplikimin e terapive mjekësore
- D) bashkësinë e ligjeve, normave, rregullave të nevojshme për realizimin korrekt të veprimtarisë mjekësore në të gjithë vendin
- E) të gjitha pohimet

174. Funksioni kryesor i Institutit të Shëndetit Publik është:

- A) të mbështesi veprimtarinë mjeksore rajonale
- B) të këshilloj qeverinë në lidhje me hartimin e linjave guidë të trajtimit
- C) të këshilloj ministrinë e shëndetësisë në lidhje me mënyrat e përmirësimit të shëndetit të qytetarëve
- D) të realizojë punë kërkimore të vazhdueshme në drejtim të vlerësimit dhe kontrollit të shëndetit publik
- E) të bashkëpunoj me ministrinë në realizimin e kontrollit të barnave

175. Ku është qendra e Organizatës Botërore të Shëndetësisë?

- A) Strasburg
- B) Bruksel
- C) Londër
- D) Gjenevë
- E) Stokholm

176. Faktorët përcaktues të shëndetit përfshijnë:

- A) faktorët biologjik dhe gjenetik
- B) stilin e jetesës
- C) faktorët social-ekonomik
- D) shtrirjen dhe natyrën e shërbimeve shëndetësore
- E) të gjitha pohimet

177. Qëllimi i edukimit shëndetësor është:

- A) të ndryshojë sjelljet shëndetësore
- B) të përmirësojë gjendjen shëndetësore
- C) A dhe B janë të sakta

- D) të informojë në lidhje me shëndetin
- E) të realizojë projekte shëndetësore

178. Mjeku ligjor ka për detyrë të:

- A) realizojë plotësimin e skedës të vdekjes
- B) realizojë verifikimin e rrethanave të ngjarjes
- C) përcaktojë vdekjen
- D) të gjitha janë të vërteta
- E) asnë nga këto

179. Mumifikimi është:

- A) formë e konservimit të kufomës
- B) faza e fundit e kalbëzimit të kufomës
- C) faza e lëngëzimit të kufomës
- D) faza e ngjyrimit të kufomës
- E) njëlloj si sapunifikimi

180. Në ekzaminimin mjeko-ligjor të kufomës bëjnë pjesë:

- A) kqyrja e kufomës në vendin e ngjarjes
- B) autopsia mjekoligjore e kufomës
- C) autopsia e dytë ose e përsëritur
- D) zhvarrosja e kufomës
- E) të gjitha pohimet

181. Marrëdhënia seksuale konsiderohet krim atëhere kur:

- A) kryhet me disa persona njëkohësisht
- B) kryhet me persona të ndryshëm në kohë të ndryshme
- C) kryhet duke përfituar nga pazotësia e të dëmtuarës/it për tu mbrojtur
- D) kur kryhet pa përdorur masa mbrojtëse
- E)asnë nga këto

182. Ekspertimi mjekoligjor i gjakut merr vlera të mëdha në:

- A) çeshtje civile për zgjidhje të padive për njohje ose kundërshtim të atësisë apo mëmësisë
- B) çeshtjet e pronësisë
- C) përcaktimin e shkakut të vdekjes të foshnjës
- D) të gjitha alternativat janë të vërteta
- E)asnë nga alternativat nuk është e vërtetë

9. Sëmundje Infektive dhe Alergologji - Imunologji

1. Cila është vatra infektive më e shpeshtë që shkakton sepsi tek pacientët jo të hospitalizuar:

- A) Infeksion që nis nga rrugët e frymëmarrjes
- B) Infeksion që nis nga trakti gastroenterik
- C) Infeksion i endokardit
- D) Infeksion i aparatit urinar
- E) Infeksion/kolonizim i CVC

2. Cila prej sëmundjeve përkufizohet si zoonosë:

- A) Askaridiazza

- B) Ankilostomiaza
- C) Amebiaaza
- D) Enterobiaza
- E) Toxoplazmoza

3. Temperaturë 38-39° celsius, prurit të trupit, rash vezikular me prurit të gjeneralizuar me makula, papula, vezikula, flluska e kore, anoreksi, frisone, cefale. Ky kuadër klinik të bën të mendosh për:

- A) Fruthi
- B) Lija e dhenve
- C) Rubeola
- D) Skarlatina
- E) Mononukleoza

4. Profilaksia e pneumonisë nga P. Carinii tek personat me HIV bëhet me:

- A) Cotrimosazol
- B) Meflokine
- C) Amfotericina B
- D) Amoxicilina dhe ac. Clavulanic
- E) Fluconazol

5. Nëpërmjet cilit prej likideve trasmetohet HIV-i:

- A) Djersa
- B) Gjak
- C) Lotë
- D) Urina
- E) Pështyma

6. Polmoniti lobar i mirëfilltë shkaktohet kryesisht nga:

- A) Streptococcus pyogenes
- B) Listeria monocytogenes
- C) Stafilococcus aureus
- D) Streptococcus pneumoniae
- E) Mycoplasma pneumoniae

7. Botulizmi nga ushqimi shkaktohet kryesisht pas konsumimit të:

- A) Ushqim kutie i konservuar në vaj ose i marinuar në kushte shtëpie
- B) Mish i pa bërë ose pak i bërë
- C) Ushqim i konservuar në uthull
- D) Ujë i ndotur
- E) Midhje ose peshk të gjallë

8. Hepatiti akut nga virusi A:

- A) Dyshohet pas përdorimit të ushqimeve të konservuara
- B) Diagnostikohet vetëm nëse ka pozitivitet për antitrupat anti-HAV të klasës IgG
- C) Nuk ka asnjëherë zhvillim fulminant
- D) Shkakton rritje të bilirubinemisë por që nuk shkon më shumë se 25mg/dl
- E) Trasmetohet me rrugë oro-fekale

9. Hepatitet që transmetohet me rrugë oro-fekale janë:

- A) Hepatiti C dhe D
- B) Hepatiti B
- C) Hepatiti A dhe D
- D) Hepatiti A dhe B
- E) Hepatiti A dhe C

10. Në tripanozomiazën amerikanëcilat janë manifestimet më të rënda dhe më të shpeshta të sëmundjes kronike?

- A) Megaezofagu
- B) Megakolon
- C) Insufiçenca hepatike
- D) Insufiçenca reanle
- E) Kardiomiopatia

11. Sепси karakterizohet nga:

- A) Prezenca tranzitore e baktereve në gjak
- B) Hiporeaktiviteti ndaj një infeksioni
- C) Reaksion i ekzagjeruar i organizmit ndaj një infeksioni
- D) Lokalizim i infeksionit në një ose dy organe
- E) Lëshimin apo hedhjen në gjakun qarkullues të baktereve nga një vatër infektive e lokalizuar

12. Oksiuraza shkaktohet nga:

- A) Echinococcus granulosus
- B) Taenia solium
- C) Necator americanus
- D) Enterobius vermicularis
- E) Hymenolepis nana

13. Cili prej agjentëve etiologjikë është shkaktari më i shpeshtë i osteomielitit akut?

- A) Salmonella tifo
- B) Haemophilus influenzae
- C) Streptococco
- D) Stafilococco aureus
- E) Gonococco

14. Cili prej agjentëve etiologjik është më shpesh shkaku i miokarditit akut?

- A) Coxackie virus
- B) Stafilococco aureus
- C) EBV
- D) Streptococcus viridans
- E) Lija e dhenve

15. Herpes Zoster:

- A) Shkaktohet nga një enterovirus
- B) Shkaktohet nga një virus i ngashëm me atë të lisë së dhenve
- C) Shkaktohet nga një rinovirus me ADN
- D) Shkaktohet nga i njëjtë virus i lisë së dhenve
- E) Shkaktohet nga coxackie

16. Cili prej këtyre baketereve shkakton leukopeni?

- A) Klensiella oxitoca
- B) Pseudomonas
- C) Streptococco i grupit A
- D) Enterococco
- E) Salmonella typhi

17. Neoplazia më e shpeshtë gjatë AIDS është:

- A) Adenokarcinoma gastrike
- B) Adenokarcinoma e laringut
- C) Leucemia limfatike kronike
- D) Sarkoma e Kaposit
- E) Adenokarcinoma e pulmonit

18. Gjatë mononukleozës infektive, në ekzaminim hemokromocitometrik vihet re:

- A) Limfopeni
- B) Neutrofili relative
- C) Limfocitozë me prani të limfociteve aktive
- D) Eozinofili
- E) Policitemi

19. Meningiti purulent karakterizohet nga cila gjendje e likidit cerebrospinal:

- A) Hipoproteinorraki, pleiocitozë neutrofile, glikorraki normale
- B) Hiperproteinorraki, pleiocitozë nutrofile, hipoglikorraki
- C) Hiperproteinorraki, pleiocitozë limfocitare, hipoglikorraki
- D) Proteinorraki në normë, mungesë të pleiocitozës, hipoglikorraki
- E) Hiperproteinorraki, pleiocitozë limfocitare, glikorraki normale

20. Një i ri toksikodipendent (per i.v) ka shfaqur prej 4 muajsh hepatitin akut dhe koinfekzionin HBV+HDV. Mjeku i familjes i keshillon të kryej disa analiza laboratorike për të vlerësuar gjendjen e sëmundjes. Rezultatet janë: transaminazat normal; antitrupat anti HDV pozitiv; HBV-ADN plazmatike negative; antitrupat anti HBs pozitive; antitrupat anti HBe pozitive. Mbi bazën e këtyre të dhënave mjeku i thotë të riut se është shëruar. Mbi cilat të dhëna bazohet mjeku për të dhënë këtë përgjigje, se ai është shëruar:

- A) Transaminazat në normë
- B) Antitrupat anti HBs pozitive
- C) HBV-ADN plazmatike negative
- D) Antitrupat anti HDV pozitiv
- E) Antitrupat anti HBe pozitive

21. Cilat janë alternimet laboratorike që vihen re gjatë mononukleozës infektive?

- A) Leukopeni dhe piastrinopeni
- B) Leukocitozë neutrofile dhe rritje të transaminazave
- C) Leukopeni dhe rritje të bilirubinës
- D) Leukocitozë limfocite dhe rritje të transaminazave
- E) Anemi dhe piastrinopeni

22. Mbledhja e sekrecioneve për ekzaminimin në kulturë mund të kryhet:

- A) Vetëm në mëngjes, edhe pse pacienti nuk ka kollë
- B) Cdo moment të ditës, mjafton që pacienti të ketë kollë me sekrecione
- C) Preferohet nëse pacienti ka qëndruar gjatë i shtrirë

- D) Vetëm në mëngjes kur je pa ngrënë
E) Disa herë gjatë ditës në momentet kur ka pikun e temperaturës

23. Vdekja e zezë (peste bubbonica) transmetohet nga:

- A) Miza
- B) Morri
- C) Mushkonja
- D) Pleshti
- E) Grenxa

24. Shfaqja më e shpeshtë e infeksionit të parë nga herpes simlex tip 1 është:

- A) Herpes labial
- B) Hepatit
- C) Ezofagit
- D) Gengivo-stomatit
- E) Encefalit

25. Sепси karakterizohet nga:

- A) Prania në gjak e baktereve në proces shumimi aktiv
- B) Prania në gjak e antigjeneve bakteriale
- C) Alternimi i termorregullimit në nivelin qëndror
- D) Prania në gjak e grimcave virale difektive
- E) Mungesa e një përgjigje inflamatore sistemike

26. Virusi Ebola ka shkaktuar epidemi në

- A) Europën veriore
- B) Europën lindore
- C) Azi
- D) Amerikën e jugut
- E) Afrikë

27. Cfarë shenjash paraqet një pacient i prekur nga botulizmi?

- A) Shenja të një polmoniti
- B) Shtim të pështymës
- C) Crregullime sensitive
- D) Diarre persistente
- E) Shenja neurologjike me paralizë

28. Cila prej sëmundjeve shkaktohet nga chlamidie?

- A) Trakoma
- B) Temperatura Q
- C) Myku
- D) Sëmundja e Weil
- E) Sporotrikoza

29. Cili prej viruseve është shkaku më i mundshëm për Sarkomën e Kaposit?

- A) Herpesvirusi human 8
- B) Virus coxackie
- C) Virusi T-limfotrop
- D) Citomegalovirus

E) Echo-virus

30. Cili është trajtimi i dizanterisë nga ameba:

- A) Cefalosporina
- B) Vancomicina
- C) Albendazoli
- D) Metronidazoli
- E) Fluorokinoloni

31. Tek një pacient të prekur nga kolera, ndërhyrja e parë terapeutike bazohet në:

- A) Dhënen e antibiotikëve
- B) Dhënen e dizinfektantëve intestinalë
- C) Rehidrimin e pacientit me solucione elektrolitike dhe ruajtjen e hidratimit.
- D) Pastrimin me anë të kripave
- E) Edhe pse nuk ka të vjella pacienti duhet mbajtur pa ngrënë

32. Polmoniti lobar shkaktohet në përgjithësi nga:

- A) Pneumococcu
- B) Enterococcu
- C) Stafilococcu
- D) Virusi respirator sincicial
- E) Mycoplasma pneumonie

33. Pacienti me temperaturë, eritemë migruese, cefale dhe dhimbje artikulare me shumë mundësi është prekur nga:

- A) Reumatizmi artikular akut
- B) Ricketsioza
- C) Fruthi
- D) Sëmundja e Lyme
- E) Lija e dhenvë

34. Cili ushqim shkakton më lehtësisht intoksikim nga Stafilococcus aureus?

- A) Uji i ndotur
- B) Mishi i zier
- C) Frutat e freskëta
- D) Fruta të thata
- E) Kremi i pasticerisë

35. Meningiti është proces inflamatori:

- A) Përfshin parenkimën cerebrale
- B) Përfshin leptomeninget
- C) Përfshin durën
- D) Përfshin vetëm bazën e kranit
- E) Përfshin vetëm pjesën e sipërme të kranit

36. Për cilin prej hepatiteve ekziston vaksinë?

- A) Hepatiti A dhe C
- B) Hepatiti A dhe B
- C) Hepatiti D
- D) Hepatiti C

E) Hepatiti G, A dhe B

37. Temperaturë 40° celsius, konxhuktivit, fotofobi, rash makulo-papular eritematoz (nga fytyra në trup, në ekstremitete, duar e kembë). Ky kuadër klinik ju bën të mendoni për:

- A) Lija e dheneve
- B) Fruthi
- C) Skarlatina
- D) Rubeola
- E) Mononukleoza

38. Tek bruceloza, temperatura:

- A) Mungon
- B) Eshtë periodike
- C) Eshtë onduluese
- D) Rritet me shkallë gjatë javës së parë të sëmundjes
- E) Kap maksimumin në ditën e tretë të sëmundjes

39. Forma më e rëndë e malaries është ajo që shkaktohet nga:

- A) Plasmodium malaria
- B) Plasmodium vivax
- C) Plasmodium oval
- D) Plasmodium falciparum
- E) Plasmodium oval tek një person që ka vuajtur dhe më parë nga P. Malaria

40. Për cilën nga patologjitetë sugjerohet terapi me antibiotikë?

- A) Mononukleoza infektive
- B) Hepatiti B akut
- C) Ethet e verdha
- D) Bruceloza
- E) Ethet tropikale

41. Malaria është e përhapur në:

- A) Në zona tropikale dhe subtropikale
- B) Vetëm në vende bregdetare
- C) Zona në lartësinë mbi 1800 m
- D) Vetëm në disa zona afrikane
- E) Vendet e Mesdheut

42. Për një pacient dyshohet të ketë tifon abdominale. Për të konfirmuar këtë diagnozë kërkojmë:

- A) Reaksionin e Wasserman-it
- B) Sierodiagnozën e Wright
- C) Antitrupat jo të plotë
- D) Reaksionin e Widal-it
- E) Reaksionin e Paul Bunnel

43. Sëmundjet me origjinë virale, në shumicën e rasteve shoqërohen me:

- A) Leukocitozë neutrofile
- B) Leukocitozë limfocite
- C) Leukocitozë bazofile

- D) Trombocitozë
- E) Limfocitozë

44. Hemokultura konsiston në kulturën e gjakut për të kërkuar agjentët patogenë që shkaktojnë sëmundje që përhapen (si sepsi, endokarditi etj.):

- A) Eshtë i mjaftueshëm marrja e një kampioni gjaku kur pacienti ka temperaturë
- B) Eshtë i mjaftueshëm marrja e kampionit të gjakut në mënyrë rastësore
- C) Marrja e gjakut bëhet vetëm herët në mëngjes dhe pa ngrënë
- D) Shpeshtësia e marrjes së kampionëve të gjakut varet dhe nga agjenti patogen për të cilin dyshojmë
- E) Eshtë e domosdoshme marrja e përsëritur e disa kampionëve të gjakut gjatë 24 orëve, pasi prania e baktereve në gjak nuk është e përherëshme

45. Cila patologji e lëkurës ka rrezik më të lartë për të zhvilluar herpex simlex të rëndë:

- A) Psoriaza
- B) Dermatiti atopik
- C) Ekzema nga kontakti
- D) Dermatiti
- E) Lytha

46. Cila nga alternativat rreth toxoplazmës nuk është e vërtetë:

- A) Në format intrauterine ka shpesh përfshirje të trurit
- B) Macja është mbartësi përfundimtar
- C) Mund të ketë encefalit tek pacientët imunodepres
- D) Macja është mbartësi i ndërmjëm dhe njeriu ai përfundimtar
- E) Shpesh është asimptomatike

47. Cfarë është influenca aviare?

- A) Transmetohet nga insektet
- B) Sëmundje e kafshëve shkaktuar nga virusët aviar, që normalisht infektojnë vetëm zogjtë
- C) Eshtë sëmundje pandemike
- D) Trasmetohet nga flebotomi
- E) Eshtë sëmundje bakterial

48. Si do të ishte më e saktë të veprohej kur duam të vaksinojmë kundër rubeolës një grua në moshë fertile?

- A) Injektim të vaksinës në mes të ciklit
- B) Injektim të vaksinës në ditën 24-26 të ciklit
- C) Injektim të vaksinës në fund të ciklit
- D) Injektim i vaksinës gjatë çdo faze të ciklit dhe dhënia e kontraceptivëve për gjashtë muaj me rradhë
- E) Injektim të vaksinës gjatë ciklit mestruaj dhe dhënia e kontraceptivëve për tre muaj me rradhë

49. Shfaqja kryesore klinike e brucelozës akute e sub-akute është:

- A) Temperatura terciane (e tre ditëve)
- B) Temperatura me stade
- C) Temperatura anfibolike (me luhatje)
- D) Temperatura kuintane (e pesë ditëve)
- E) Temperatura onduluese

50. Si quhen kushtet në të cilat ndalohet kalimi i mikrorganizmave në ambiente sterile?

- A) Antisepsi
- B) Bonifikimi i ambientit
- C) Bakteriostazë
- D) Zona filtër
- E) Asepsi

51. Cili prej infeksioneve nuk mund të përkufizohet si një infekzion oportunist tek pacienti me AIDS?

- A) Meningiti criptocoxik
- B) Pneumocistoza pulmonare
- C) Toxoplazmoza cerebrale
- D) Korioretiniti citomegalik
- E) Retokoliti ulçeroz

52. Cila është simptoma më e shpeshtë e mononukleozës infektive:

- A) Faringodini
- B) Anoreksi
- C) Mialgji
- D) Nauze
- E) Kollë

53. Një fëmijë 6 muajsh, pas 3 ditësh me temperaturë të lartë shfaq ekzantemë të kuqërrëmtë në të gjithë lëkurën dhe ndërkohë temperatura ulet në mënyrë të menjëherëshme. Nga se mund të jetë prekur ky fëmijë?

- A) Fruthi
- B) Infekzion kongenital nga citomegalovirus
- C) Rubeola
- D) Toxoplazmoza kongenitale
- E) Ekzantema kritike

54. Në një person të imunizuar kundrejt hepatitit B, infekzioni nga virusi delta (HDV) shfaqet:

- A) Asnjëherë
- B) Më pak se 10% të rasteve
- C) Midis 10-50% të rasteve
- D) Më shumë se 50% të rasteve
- E) Në 10% të rasteve

55. Rast klinik: Rreth 5 orë pas një dasme, disa prej të ftuarve shfaqën dhimbje abdominale, të vjella, diarre. Cila mund të jetë diagnoza?

- A) Gastroenterit viral
- B) Enterit nga campylobacter jejumi
- C) Infekzion nga salmonela
- D) Intoksikim nga stafilococcus aureus
- E) Amebiazë

56. Cilin ekzaminim do të kryenit nëse dyshoni për tenian?

- A) Urinokulturë
- B) Tampon rektal

- C) Koprokulturë
- D) Analizë parazitologjike të feçeve
- E) Analizë urine

57. Cila nuk është ndër simptomat e shpeshta të infekzionit primar nga HIV?

- A) Temperaturë
- B) Faringodini
- C) Alopeci
- D) Rash kutan makulo-papular
- E) Artralgji

58. Sterilizim do të thotë:

- A) Shkatërrim të agjentëve patogenë
- B) Shkatërrim të gjithçkaje që mbart një agjent mikrobiq
- C) Shkatërrim të agjentëve jo patogenë
- D) Shkatërrim vetëm të agjentëve bakterialë
- E) Shkatërrim të agjentëve patogenë e jo patogenë

59. Në aspektin epidemiologjik, hepatiti A lidhet më shumë me:

- A) Përdorimi i ujit ose frutave të detit të kontaminuara
- B) Përdorimi i hemoderivuesve
- C) Marrëdhëniet heteroseksuale jo të mbrojtura
- D) Shkëmbimi i lugëve që janë përdorur nga persona të sëmurë me HAV
- E) Kontakti i ngushtë respirator me persona të sëmurë

60. Manifestimi më i shpeshtë tek një i rritur imunokompetent është:

- A) Retiniti
- B) Hepatiti akut
- C) Limfoadeniti
- D) Hepatiti kronik
- E) Encefaliti

61. Leukopenia është e shpeshtë në rastin e:

- A) Kolera
- B) Ethet tifoide
- C) Shigeloza
- D) Enteriti nga Escherichia coli enterohemorragjik
- E) Leptospiroza

62. Orkiti është komplikim i munshëm i njërsës prej sëmundjeve infektive. Cilës prej tyre?

- A) Rubeola
- B) Fruthi
- C) Parotiti (shytat)
- D) Lija e dhenve
- E) Ekzantema kritike

63. Të sapolindurit nga nëna të infekstuara me HIV janë:

- A) Gjithnjë HIV-Ab negativ
- B) Gjithnjë HIV-Ab pozitiv
- C) Gjithnjë HIV-ARN negativ

- D) Gjithnjë HIV-ARN pozitiv
- E) HIV-Ab pozitiv në 50% të rasteve

64. Cili prej këtyre agjentëve shkakton më shpesh hepatit fulminant?

- A) Virusi i fruthit
- B) Pneumocysti carini
- C) HIV
- D) HBV
- E) Leishmania donovani

65. Cili prej virusëve nuk shkakton sindromën e mononukleozës?

- A) Kor onavirus
- B) Virusi i Epstein-Barr
- C) Herpes virus human tipi 6 (HHV6)
- D) HIV
- E) Virusi i rubeolës

66. Hepatiti nga virusi delta verifikohet vetëm në rast se ekziston njëkohësisht dhe infekzioni nga:

- A) HBV
- B) HAV
- C) Virusi Epstein-Barr
- D) HCV
- E) Citomegalovirus

67. Cila strukturë preket më shpesh nga infekzioni i citomegalovirusit?

- A) Gjëndrat e pështymës
- B) Heparin
- C) Pulmoni
- D) Pulmoni dhe hepari
- E) Gjëndrat e pështymës dhe veshkat

68. Terapia për meningitin tuberkular përfshin 4 medikamente antituberkualre. Cili prej këtyre medikamenteve nuk përfshihet?

- A) Isoniazidi
- B) Claritromicina
- C) Pirazinamidi
- D) Etambutoli
- E) Rifampicina

69. Pneumonitë e komunitetit janë:

- A) Merren pas një episodi gripi (influence)
- B) Merren në komunitetet e toksikodipendentëve
- C) Merren në spital
- D) Tek të sapolindurit
- E) Merren jashtë spitali, në jetën e përditshme

70. Chikungunya e njojur dhe si "sëmundja e njeriut të përkulur" transmetohet nga:

- A) Ushqimi

- B) Nga insektet
- C) Kontakti seksual
- D) Pickimi i mushkonjës së infektuar, Aedes Albopictus dhe Aedes Aegypti
- E) Inhalimi

71. Cili është agjenti etiologjik i etheve Q?

- A) Clamidia
- B) Legionela
- C) Coxiela burneti
- D) H.influenca
- E) Streptococcus

72. Në cilën shtatë ditësh të etheve tifoide hemokultura është më shpesh pozitive?

- A) Shtatë ditëshi i IV
- B) Shtatë ditëshi i II
- C) Shtatë ditëshi i III
- D) Shtatë ditëshi i I
- E) Shtatë ditëshi i V

73. Kondilomat (lythat) shkaktohen nga:

- A) HSV
- B) HPV
- C) Enterovirus
- D) HIV
- E) Baktere

74. Vaksinimi kundër kolerës jep:

- A) Imunitet për 6 muaj
- B) Imunitet për 5 vjet
- C) Imunitet për 10 vjet
- D) Imunitet për 18 muaj
- E) Imunitet të përhershëm

75. Cili prej markuesve të gjakut mundëson diagnozën etiologjike për hepatitin akut tip B?

- A) HBsAg
- B) IgM anti HBc
- C) AntiHBc
- D) IgG antiHBc
- E) HBeAg

76. Streptocoket viridant shkaktojnë më shpesh:

- A) Meningit
- B) Cistopielit
- C) Endokardit
- D) Kolecistik
- E) Enterit

77. Medikamentet parësore për trajtimin e brucelozës janë:

- A) Antibiotikët glikopeptidikë
- B) Tetraciklina

- C) Cefalosporina të gjeneratës së II
- D) Cefalosporina të gjeneratës së III
- E) Metronidazoli

78. Cila prej sëmundjeve nuk transmetohet nëpërmjet rrugëve seksuale:

- A) Ulçera e butë venere
- B) HBV
- C) Limfogranuloma venere
- D) Limfoma e Lennert
- E) Herpes simplex tip 2

79. Shënja e Koplik është e pranishme në:

- A) Lija e dhenve
- B) Rubeola
- C) Fruthi
- D) Skarlatina
- E) Tifo

80. Endokarditi infektiv tek toksikodipendentët që marrin drogë nga vena shkaktohet më shumë nga:

- A) Gonococu
- B) Streptococu viridans
- C) Escherichia coli
- D) Enterococu
- E) Stafilococu aureus

81. Të gjitha gjendjet e mëposhtme mund të jepin fals pozitiv për reaksionin ndaj sifilizit, përveç njërisë:

- A) Mononukleoza infektive
- B) Tripanozomiaza
- C) Bruceloza
- D) Malaria
- E) Lupus eritematoz sistemik

82. Erisipela shkaktohet nga:

- A) Agjenti nuk është identifikuar ende
- B) Stafilococu aureus
- C) Streptococu piogenes
- D) Në shumicën e rasteve izolohet agjent i ngjashëm e prionet
- E) Proteus vulgaris

83. Cili prej alternimeve të likidit cerebro-spinal diferencon meningitin bakterial nga ai viral?

- A) Hiperproteinorraki
- B) Pleiocitozë likidi
- C) Prevalencë limfocitare
- D) Hipoglikorraki
- E) Rritje të presionit në likid

84. Flora bakteriale normale e pranishme në organizëm:

- A) Eshtë e pranishme vetëm tek personat që janë shëruar nga një sëmundje infektive

- B) Prania e saj tregon se personi është i sëmurë
- C) Eshtë e pranishme vetëm tek personat imunodepres (AIDS, neoplazi, trapiante etj.)
- D) Eshtë e rëndësishme, sepse ka funksion mbrojtës
- E) Eshtë e pranishme vetëm tek personat me sëmundje infektive kronike

85. Një person i vaksinuar për hepatitin B është:

- A) Anti HBs pozitiv
- B) AntiHBe pozitiv
- C) AntiHBe dhe Anti HCb pozitiv
- D) AntiHBe, antiHCb dhe anti HBs pozitiv
- E) HBsAg pozitiv

86. Cestodet:

- A) Nuk janë patogjen për njeriun
- B) Janë protozoarë
- C) Janë krimba të sheshtë të segmentuar
- D) Janë krimba cilindrike
- E) Janë krimba të sheshtë jo të segmentuar

87. Cila prej vaksinave përmban virus të gjallë të dobësuar?

- A) Anti ethet e verdha
- B) Antidifteriku
- C) Antipolio tip Salk
- D) Anti hepatiti A
- E) Antitifo

88. Perforimi intestinal është pjesë e komplikimeve të:

- A) Kolitit pseudomembranoz
- B) Enteriti nga Campylobacter jejunum
- C) Kolera
- D) Ethet tifoide
- E) Shigeloza

89. Imuniteti pasiv gjatë një infeksioni është ai i fituar nga:

- A) Pasi e hasur infeksionin dhe më pas është shëruar
- B) Pasi e ka hasur infeksionin por pa klinikë
- C) Mamaja
- D) Pasi e ka hasur infeksionin dhe më pas është shëruar, pavarësisht nga kuadri klinik
- E) Pasi është vaksinuar për këtë infeksion

90. Një e re 25 vjeçare shfaqi temperaturë, faringodini dhe asteni. Pas 24 orëve ku temperatura rritet, ajo vuri re praninë e disa limfonodujve në qafë. Konsultohet me mjekun dhe vihet re: limfonoduj të zmadhuar në të gjitha stacionet limfatike sipërfaqësore, subikter të sklerave, skuqje të faringut dhe disa pllaka të bardha tek tonsilat. Nga analiza e gjakut vihet re: Hb 13.5g/dl, eritrocite 4.260.000/mmc, leukocite 25.000/mmc me formulë: N 21%; E 2,5%; B 0,5%; L 39%; M 28%; qeliza të mëdhaja limfocitare 9%. Trombocitet 350.000/mmc; AST 250UI/L; ALT 900UI/L; Bilirubin tot 3.5mg/dl; Bilirubin direkt 1.8mg/dl. Cili mund të jetë agjenti patogen më i mundshëm për këtë gjendje:

- A) Mycoplazma hominis
- B) Streptococcus gr A

- C) Virusi i Epstein-Barr
- D) Neisseria gonorrhoea
- E) Escherichia coli

91. Profilaksia ndaj meningitit meningokoksik për ata që janë kontakt të ngushtë me të bëhet me:

- A) Gamaglobulina
- B) Cloramfenikol
- C) Peniciline
- D) Ertromicine
- E) Rifampicine

92. Spiroketet e llojit Borrelia mund të shkaktojnë:

- A) Stomatit
- B) Tifon murine
- C) Temperaturën periodike
- D) Gripin
- E) Gastritin

93. Cila është terapia për Morbusin e Hansen, në formën tuberkulare:

- A) Dapsoni
- B) Rifampicina
- C) Clofazimina
- D) Dapsoni+Rifampicina
- E) Claritromicina

94. Skarlatina shkaktohet nga:

- A) Stafilocoku
- B) Streptokoku i gr A
- C) Treponema pallidum
- D) Nuk njihet etiologjia
- E) Pneumokoku

95. Idatidoza shkaktohet nga:

- A) Agjentë të ngjashëm me prionet
- B) Tenia
- C) Hymonelepis nana
- D) Leptospira
- E) Echinokoku

96. Në botulizmin nga ushqimi, sëmundja shkaktohet nga:

- A) Toksina e prodhuar në zorrë
- B) Toksina citotonike
- C) Nga produktet që çlironen gjatë lizës së bakterit në stomak
- D) Bakteri në fazë replikuese
- E) Toksina e formuar paraprakisht tek ushqimi

97. Në infekzionin nga HIV, niveli i viremisë është i lartë dhe keshtu që rreziku për transmetim i sëmundjes është më i madh:

- A) Kur infekzioni merret me rrugë seksuale

- B) Si gjatë fazës akute dhe më vonë, ku niveli i CD4 është shumë i ulët
- C) Gjatë fazës së latëncës klinike
- D) Në 24 orët e para pas kontaktit
- E) Pas trajtimit me zidovudine, lamivudine dhe ndinavir

98. Një pensionist 76 vjeçar, ish minator, me silikozë pulmonare, pas 2 ditësh me temperaturë të lartë e otalgji të djathë, me delir e i hutuar bie në koma. Në ekzaminimin objektiv evidentohen shenja meningeale, herpes labial dhe membrana timpanike e djathë e turbullt. Në analizat e gjakut vihet re leukocitozë neutrofile. Analiza e likidit cerebro-spinal tregon për pleiocitozë neutrofile, hipiglikorraki, hiperprotidorraki. Cili mund të jetë agjenti patogen më i mundshëm?

- A) Meningit nga gram negativët
- B) Meningit meningokoksik
- C) Meningit nga echo virus
- D) Meningit tuberkular
- E) Meningit pneumokoksik

99. Tek pacienti me AIDS, trimetoprim/sulfametazolo (cotrimosazolo) përdoret në terapinë e:

- A) Aspergilozës së përhapur
- B) Pneumonisë nga *P. Carinii*
- C) Tuberkulozit extrapulmonar
- D) Meningiti nga criptokoku
- E) Retiniti nga citomegalovirus

100. Cila prej alternativave nuk është shenjë e amebiazës intestinale nga *E. Histolytica*?

- A) Feçe me gjak
- B) Temperaturë modeste ose që nuk ka fare
- C) Prania e mukusit në feçe
- D) Dhimbre abdominale
- E) Leukocitozë në gjakun periferik

101. Kuadri hematologjik tek Leshmanioza karakterizohet nga:

- A) Rritje të neutrofileve
- B) Anemi mikrocitike
- C) Leukocitozë
- D) Rritje të trombociteve
- E) Leukopeni

102. Trizmusi (trisma) tek tetanozi është:

- A) Hiperton të muskujve maseter
- B) Spazma të sfintereve
- C) Relaksim muskular të gjeneralizuar
- D) Hiperton i muskujve dorsalë
- E) Hiperton të muskujve sternokleidomastoide

103. Cila mund të trasmetojë sëmundjen nga mbartësi i tifos i shëruar:

- A) Pështyma
- B) Feçet
- C) Lotët
- D) Djersa
- E) Gjaku

104. Cila prej sëmundjeve infektive nuk trasnmetohet nga kontakti direkt me të sëmурin?

- A) Lija e dhenve
- B) Bruceloza
- C) Ethet tifoide
- D) HAV
- E) Poliomeliti

105. Gastroenteriti i shkaktuar nga rotavirus është i përhapur në të gjithë botën. Cila është rruga kryesore e transmetimit të virusit?

- A) Hematike
- B) Respiratore
- C) Oro-fekale
- D) Limfatike
- E) Kontakti me sipërfaqe të kontaminuara

106. Një grua e re do të shkojë në Afrikën qëndrore për turizëm. Profilaksia kundër malarias me mefloquine:

- A) Nuk duhet bërë pasi efikasiteti i saj është i diskutueshëm
- B) Duhet bërë një javë para se të niset, të vazhdojë gjatë gjithë qëndrimit në atë vend dhe të përfundohet 4 javë pas kthimit në vendin e saj
- C) Duhet bërë një ditë para se të niset dhe duhet përfunduar një javë para se të kthehet
- D) Bëhet vetëm nëse do të shkojë në vende endemike për P. Vivax
- E) Nuk bëhet tek gratë shtatzëna, pasi është treguar se rreziku për tu pickuar nga mushkonja Anopheles është mjaft i vogël për këtë gjendje

107. Leishamania është:

- A) Elmint (krimb)
- B) Virus me ARN
- C) Bakter gram +
- D) Micetet (kërpudhë)
- E) Protozoar

108. Simptoma ose shenja pothuajse konstante gjatë sëmundjes së rubeolës është:

- A) Zmadhimi i limfonodujve retronukal
- B) Kolla
- C) Temperaturë $>40^{\circ}$ celsius
- D) Hopistoton
- E) Diarre sekretore me gjakosje

109. Reaktiviteti imunologjik dhe imunopatologjik, për tu kompletuar kanë nevojë përveç reaksiونit antigen-antitrip dhe për ndërhyrjen e të gjithë elementëve të mëposhtëm, përveç njërit:

- A) Komplementi
- B) Granulocitet
- C) Aminat vazoaktive
- D) Ndërmjetësit e dhimbjes
- E) Limfocitet T

110. Tek purpura e Schonlein-Henoch mund të vihen re mjaft shpesh dëmtime të të gjitha strukturave të mëposhtme, përveç njërsës:

- A) Hepari
- B) Artikulacionet
- C) Veshkat
- D) Lëkura
- E) Zorra

111. Cila nga alternativat rreth sëmundjeve nga imunokomplekset është e saktë:

- A) Shfaqjet në lëkurë janë shrehja më e rëndë klinike e këtyre sëmundjeve
- B) Kanë të njëjtën etiologji specifike
- C) Formimi i imunokompleksit qarkullues, përkon me rritjen e nivelit të komplementit në gjak
- D) Hemoderivatët dhe antisiereret heterologjike janë shkaku më i shpeshtë i këtyre sëmundjeve
- E) Zhvillohet kur imunokompleksi depozitohet në inde, duke shkaktuar inflamacion dhe dëmtim të indit

112. Ulja e imunitetit të ndërmjetësuar nga qelizat, është zbuluar gjatë sëmundjes:

- A) Fruthi
- B) Tifo andominale
- C) Hepatosteatoza
- D) Gotta
- E) Diabeti melit

113. Komponentët kryesorë të sistemit imunitar, përgjegjës për mbrojtjen e organizmit dhe patogjenezën e sëmundjeve autoimune janë të gjitha alternativat e mëposhtme, përveç njërsës:

- A) Qelizat B dhe imuniteti humorali
- B) Qelizat T, monocitet dhe imuniteti i ndërmjetësuar nga qelizat
- C) Sistemi i kimazave
- D) Komplementi
- E) Qelizat fagocituese dhe sistemi retikulo-endotelial

114. Prania e angioedemës ereditare të bën të mendosh për deficitin e:

- A) Sistemi fagocitar (Sindroma e Chediak-Higashi)
- B) Sistemit të antirupave (deficiti i IgA-ve)
- C) Sistemit komplementar (C1-inibitor)
- D) Funksioni i timusit
- E) Sistemi i antirupave dhe sistemi fagocitar

115. Cila është alternativa e saktë rreth agamaglobuminemisë lidhur me gjininë:

- A) Limfocitet B qarkullues janë shumë të reduktuar në numër, ose mungojnë totalisht
- B) Janë të reduktuara të gjitha klasat e imunoglobulinave, përveç IgM
- C) Organet limfoide janë normal
- D) Janë të shpeshta infeksionet urinare
- E) Nuk vërehet kuadër klinik i poliarteritit

116. Cila prej shfaqjeve klinike të mëposhtme është më pak e mundur në gjendjen e imuno-deficencës?

- A) Infekzioni i rrugëve urinare
- B) Infekzioni meningegal
- C) Diseminimi (shpërhapja) bakterial

- D) Infeksioni i përsëritur ose kronik i rrugëve respiratore
E) Manifestimet autoimune

117. Cila prej alternativave rreth IgE nuk është e saktë?

- A) Shkaktojnë degranulimin e bazofileve dhe mast-cell, duke çliruar ndërmjetësit që shkatërrojnë qelizën
B) Fiksohen mbi sipërfaqen e bazofileve dhe mast-cell pas kontaktit me antigenin
C) Janë përgjegjëse për sëmundjet nga hipersensibiliteti i tipit të menjëherëshëm
D) Janë shumë të rritura tek personat alergjik të rracës së bardhë, kundrejt atyre jo alergjik
E) Kanë nivele më të larta tek personat atopik që vuajnë nga astma, në krahasim me personat me shfaqje alergjike të një rëndësie shumë më të vogël

118. Cila prej qelizave nuk mund të kreyjë aktivitet makrofagik?

- A) Plasmacell (qelizat plazmatike)
B) Qelizat e Kuppfer
C) Osteoklastet
D) Qelizat e mikroglis
E) Istiocitet

119. Në cilën prej sëmundjeve mund të shfaqet shpesh atrofia e lienit tek i rrituri?

- A) Temperatura onduluese
B) Hemopoieza extramidulare
C) M. Celiak
D) Tuberkuloza miliare akute
E) S.e Banti

120. Cila është alternativa e gabuar rreth rinitit alergjik?

- A) Në sipërfaqen e mukozës nazale janë të pranishme vetëm IgA
B) Kuadri klinik mund të zgjasë gjithë vitin
C) Në sipërfaqen e mukozës nazale janë të pranishme IgA dhe IgE
D) Personat me kuadër klinik të pranishëm gjatë gjithë vittit janë kryesisht të rritur
E) Imunoterapia (terapia hiposensibilizuese) i drejtohet vetëm formave alergjike sezonale, që nuk i përgjigjen medikamenteve

121. Reaksionet nga medikamenteve anti-inflamatorë jo steroid (FANS) veprojnë me mekanizëm IgE ndërmjetës. Cila është përgjigja e saktë:

- A) Po, në 30% të rasteve
B) Jo, në 80% të rasteve
C) Po, nëse është e bashkangjitur me alergjinë nga antibiotikët
D) Jo
E) Po, në 100% të rasteve

122. Deficiti selektiv i IgA paraqet të gjitha karakteristikat e mëposhtme, përvèç njërisë:

- A) Eshtë forma më e shpeshtë e deficitit imunologjik primitiv
B) Ka episode të shpeshta të infeksiioneve të rrugëve respiratore
C) Shesh shoqëohet me sindromën e malabsorbimit
D) Ka incidencë <20%, në krahasim me gjithë difektet e tjera imunologjike primitive
E) Shpesh shoqërohet me sëmundje autoimune dhe atopike

123. Cila është alternativa e saktë rreth amiloidozës?

- A) Tek amiloidoza fijet amiloide janë të lokalizuara brenda qelizave
- B) Bazohet në depozitimin jashtë-qelizor të një proteine fibroze (amiloide) në një ose më shumë zona të organizmit
- C) Prekja e organeve endokrine nga substanca amiloide shkakton mosfunkcionim të tyre
- D) Në amiloidozën ereditare familjare, përfshirja e sistemit nervor ka prognozë të mirë
- E) Sekuencat aminoacide të proteinës së amiloides primare ka N- mbetje terminale identike me ato të krahëve të rëndë të imunoglobulinave

124. Cila prej patologjive nuk ka karakteristikë eozinofilinë?

- A) Astma
- B) Filarioza
- C) Pneumonia lobare
- D) Sindroma e Sezary
- E) Sindroma e Churg-Strauss

125. Amiloidoza nga krahët e lehtë të imunoglobulinave është ajo që zbulohet tek:

- A) Tuberkulozi
- B) Osteiti bakterial kronik
- C) Pielonefriti kronik supurativ (qelbëzuar)
- D) Mieloma multiple
- E) Hodgking

126. Në të ashtuquajturën përgjigje "primare" cilat janë imunoglobulinat e para që sintetizohen plasmacell?

- A) IgE
- B) IgM
- C) IgA
- D) IgD
- E) IgG

127. Cila prej alternativave është e saktë rrith imunodeficiencës sekondare?

- A) Janë më të rralla se format primitive
- B) Janë patologji të rralla e kryesisht me interes pediatrik
- C) Janë më të shpeshta se format primitive
- D) Janë gjithnjë të pa kthyeshme (ireversibel)
- E) Karakterizohen nga rritja e incidencës së faktorëve gjenetikë

128. Cila prej së mundjeve inflamatore kronike nuk ka karakteristike reaksionin nga hipersensibiliteti:

- A) M. Crohn
- B) Artriti reumatoid
- C) Osteomieliti
- D) Enteriti rajonal
- E) Sarkidoza

129. Cila prej sëmundjeve të syrit është autoimune?

- A) Retiniti pigmentoz
- B) Iridocikliti
- C) Trakoma
- D) Glaukoma

E) Kongiuntiviti folikular

130. Cila prej alternativave nuk është e saktë?

- A) Sindroma Down nuk shoqërohet nga imunodeficiiteti
- B) Deficiiteti më i shpeshtë i imunoglobulnave është ai i deficiitetit të IgA
- C) Timoma shoqërohet me imunodeficiitet
- D) Infeksionet nga candida albicans shoqërohen nga difekti i imunitetit të ndërmjetësuar nga qeliza
- E) Sindroma e Di George bazohet kryesisht tek deficiiteti i qelizave T

131. Cila alternativë nuk është e saktë rrith sarkoidozës?

- A) Limfocitet T helper dhe fagocitet mononuklear grumbullohen në organet e prekura
- B) Granuloma e sarkoidozës është një strukturë kompakte e përbërë nga qel. Mononukleare, qelizat T dhe B
- C) 90% e personave të prekur shfaq alternime radiologjike të toraksit në një nga fazat e sëmundjes
- D) Intradermoreaksioni i tuberkolinës është gjithnjë pozitiv
- E) Dominimi i qelizave T helper në nivelin e organeve të prekura nga sëmundja është përgjegjës për përgjigjen në lëkurë ndaj tuberkulinës

132. Cila alternativë nuk është e vërtetë rrith Sindromës Sjogren?

- A) Faktori reumatoid është i pranishëm në 80% të rasteve
- B) Diagnoza klinike vendoset disa vite pas shfaqjes së simptomave aspecifike
- C) Ka ulje të funksionit sekretues të gjëndrave të pështymës
- D) Përfshirja hepatike është e pashmangshme
- E) Keratokongiuntiviti i thatë shkaktohet nga shkatërrimi i epitelit kongiuntival bulbar dhe të kornes

133. Deficieti imunologjik i varjueshëm (agamaglobulinemi komune e varjueshme) paraqet të gjitha karakteristikat e mëposhtme, përvèç njëris:

- A) Shoqërohet me hiperplazi limfoidale tonsilare dhe intestinale
- B) Dëmtimi artikular është i pakët ose mungon
- C) Mbizotërojnë infeksionet bronkopneumonike
- D) Sensibiliteti ndaj infeksioneve shfaqet rrith moshës 7 vjeçare
- E) Episodet e diarresë janë të pakta ose mungojnë

134. Të gjithë agjentët patogen të poshtë shënuar janë shkaktar të shokut septik me përashtim të:

- A) kokeve gram + (stafilokok, enterokok)
- B) leptospirës
- C) enterobaktereve
- D) pseudomonas
- E) neisseria meningitis

135. Infekzioni nga HIV shoqërohet me të gjitha alterimet imunologjike të shënuar më poshtë me përashtim të:

- A) ulje e numirt të limfociteve T4 (helper) qarkullues
- B) raporti i qelizave T4 dhe T8 (supresor) >1
- C) ulje të veprimtarisë të qelizave T citotoksike
- D) rritje të funksionit të beta2 mikroglobulinës

E) mungesa e antigenëve në lëkurë për të gjithë testet kutane

136. Cila sëmundje infektive transmetohet me rrugë orofekale?

- A) difteria
- B) malaria
- C) sifilisi
- D) herpesi
- E) tifo

137. Për cilin infeksion kongenital do të dyshonim në një të porsalindur me mikrocefali, kalçifikime cerebrale, korioretinit?

- A) varicella zoster virus
- B) herpes simplex virus
- C) toksoplazma
- D) citomegalovirus
- E) HIV

138. Në helmimin ushqimor nga Clostridium perfringens simptomat shfaqen:

- A) menjëherë pas ngrënies
- B) 1-6 orë pas përdorimit të ushqimit të kontaminuar
- C) 6-24 orë
- D) 1-2 ditë
- E) 3-4 ditë

139. Parazitozat shoqërohen me:

- A) mungesë të IgM
- B) mungesë të IgG
- C) rritje të IgE
- D) rritje të IgA
- E) mungesë të IgA

140. Cila prej këtyre sëmundjeve është një zoonozë?

- A) askaridoza
- B) shistosomiaza
- C) amebiaza
- D) toksoplazmoza
- E) enterobiaza

141. Sepsis karakterizohet nga:

- A) prania e përkohshme e baktereve në gjak
- B) hiporeaktiviteti ndaj një infeksioni
- C) hedhja e vazhdueshme e baktereve në gjakun qarkullues, nga një vatër e lokalizuar infeksioni
- D) lokalizimi i infeksionit në një apo dy organe
- E) përgjigje e egzagjeruar e organizmit ndaj një infeksioni

142. Herpes Zoster shkaktohet nga:

- A) i njehti virus me atë të varicelës
- B) nga një virus i ngjashëm me atë të varicelës
- C) nga një Rinovirus me ADN

- D) nga një Enterovirus
- E) nga një Koksaki virus

143. Neoplazia më e shpeshtë në AIDS është:

- A) sarkoma e Kaposit
- B) adenokarcinoma e laringut
- C) leuçemia limfatike kronike
- D) adenokarcinoma gastrike
- E) adenokarcinoma pulmonare

144. Diarrea e udhëtarëve shkaktohet më shpesh nga:

- A) Stafilocoku aureus
- B) Herpes virus
- C) Mycobakterium bovis
- D) Eschericia coli enterotoksike
- E) Campylobacter jejuni

145. HIV transmetohet me anë të:

- A) Djersës
- B) Pështymës
- C) Lotëve
- D) Urinës
- E) Gjakut

146. Hepatitet që transmetohen me rrugë oro-fekale janë:

- A) Hepatiti A dhe E
- B) Hepatiti B
- C) Hepatitit C dhe D
- D) Hepatiti a dhe B
- E) Hepatiti A dhe C

147. Manifestimet më të shpeshta që shfaqen nga infekzioni fillestar me Herpes Simplex tip 1 janë:

- A) Herpes labial
- B) Gingivo-stomatite
- C) Ezofagite
- D) Hepatite
- E) Encefalite

148. Të gjitha pohimet e mëposhtme në lidhje me astmen bronkiale janë të vërteta, me përjashtim të:

- A) është një sëmundje që karakterizohet nga inflamacioni i mukozës bronkiale
- B) është një sëmundje me natyrë kronike me riakutizime të shkaktuar nga faktorë të ndryshëm
- C) është një sëmundje e karakterizuar nga aksese dispneje dhe ndjesia e shtrëngimit në nivel të toraksit
- D) është një sëmundje e karakterizuar nga bronkospazma reversibile
- E) është një sëmundje që në mënyrë të pashmangshme shoqërohet me pamjaftueshmeri të zemrës për të kryer funksionin e saj

149. Nga barnat e poshtëshënuar rretho ato që ka efekt më të fuqishëm bronkodilatator:

- A) kortikosteroidët inhalator
- B) kortikosteroidët me rrugë orale
- C) beta 2 mimetikët
- D) antihistaminikët
- E) teofilina

150. Cili është kuptimi etimologjik i fjalës "alergji":

- A) një reaksion i zakonshëm i organizmit
- B) një reaksion jo normal i organizmit
- C) një reaksion favorizues i organizmit
- D) një reaksion specifik i organizmit
- E) një reaksion i izoluar i organizmit

151. Polinozat para-pranverore janë pasojë e:

- A) Poleneve të pemëve
- B) Graminetë
- C) Shkurret
- D) Parietaria Judaica
- E) Dermatofagët

152. Polenet janë:

- A) struktura mashkullore riprodhimi të bimës
- B) struktura femërore riprodhimi të bimës
- C) struktura femërore dhe mashkullore riprodhimi të bimës
- D) asnje nga këto

153. Astma bronkiale:

- A) përpara adoleshencës prek kryesisht femrat
- B) përpara adoleshencës prek kryesisht meshkujt
- C) përpara adoleshencës prek njëloj të dy gjinitë
- D) është më e shpeshtë pas 40 vjeç
- E) është më e shpeshtë tek duhanpirësit se sa tek joduhanpirësit

154. Gjatë krizës të astmatike:

- A) FEV1 është i rritur
- B) FVC është e rritur
- C) PEF është i ulur në mënyrë të parikthyeshme
- D) FEV1 është i ulur
- E) Raporti FEV1/FVC është normal ose i rritur

155. Hipersensibiliteti i vonuar është karakteristik në të gjitha patologjite e mëposhtme, me përjashtim të:

- A) Dermatiti i kontaktit
- B) Hipersensibiliteti nga tuberkulina
- C) Riflakja gjatë transplantit
- D) Sëmundja graft-versus-host pas transplantit të palcës kockore
- E) Sëmundja e serumit

156. Shkaku më i shpeshtë i angioedemës të izoluar që vihet re në të rriturit është:

- A) mungesa e inhibitorit të C1

- B) mungesa e funksionit fagocitar
- C) mungesa e IgA
- D) terapia me ACE-inhibitor
- E) Terapia me beta-bllokues

157. Rinit alergjik klinikisht karakterizohet nga:

- A) Rrjedhja e sekrecioneve të ujshme nga hundët, dispne ne qetësi, teshtima, bllokim të hundëve
- B) Kruarje hundëve, dispne ne qetësi, teshtima, bllokim të hundëve
- C) Rrjedhja e sekrecioneve të ujshme nga hundët, dhimbje gjoksore, dispne ne qetësi, teshtima
- D) Rrjedhja e sekrecioneve të ujshme nga hundët, teshtima, kruarje të hundëve, bllokim të hundëve
- E) Kruarje të hundëve, dhimbje koke, teshtima, bllokim të hundëve

10. Nefrologji e Reumatologji

1. Artriti tuberkular është tipik:

- A) Poliartikular
- B) Nuk bën abses
- C) Me zhvillim hiperostozues
- D) Nuk duket radiologjikisht
- E) Monoartikular

2. Cila prej alternativave nuk është e vërtetë rreth artritit psoriazik:

- A) >70% e pacientëve janë të prekur nga psoriaza e lëkurës shumë vite përpara se të zhvillohet artri
- B) Në pak raste prek artikualcionin sakro-iliak
- C) Kolona vertebrale mund të shfaqë entezit që ngjason me artritin
- D) Terapia me metotresat, drejtuar dëmit artikular, përmirëson gjithnjë dhe lezionet e lëkurës
- E) Bën pjesë tek Spondiloartropatitë siero-negative

3. Simptoma më karakteristike e sëmundjes së Horton është:

- A) Nuk ndjehet mirë
- B) Dhimbje artikulare
- C) Cefale intense, parosistike
- D) Ambliodipi
- E) Marrje mendsh

4. Në artritin reumatoid cilat janë artikulacionet që preken më shpesh?

- A) Të baçinit
- B) Tibio-tarsike
- C) Artikulacionet e vogla të duarve
- D) Bërrylit
- E) Temporo-mandibulare

5. Mbi bazën e cilëve prej elementëve laboratorik, spondiloartriti konsiderohet si sieronegativ?

- A) Mungesa e faktorit reumatoid dhe ANA negativ
- B) Indekset aspecifike të inflamacionit negativ
- C) ANCA negativ

- D) ANA negativ
- E) Faktori reumatoid negativ

6. Cili prej antitrupave antinukleojanë tipikë për diagnozën e Lupus Eritematoz Sistemik

- A) Antiperinuklearë
- B) Anti RNP
- C) Anti-ADN me helikë teke
- D) Anti mukoza gastrike
- E) Anti-ADN me dopio helikë

7. Në artritin reumatoid, përvëç artikulacione, cili organ në përgjithësi nuk është i përfshirë?

- A) Lëkura
- B) Pulmonet
- C) Hepar
- D) Sistemi nervor
- E) Zemra

8. Glikozaminoklianet janë:

- A) Përbërës normalë të substancës bazë të kartilagjenit artikular
- B) Substanca patologjike që gjenden në likidin sinovial kur ka artrit septik
- C) Përbërës normalë të membranës sinoviale
- D) Produkte të degradimit të fibrave të kolagjenit
- E) Përbërës jo normalë të kartilagjenit tek personat me kodrokalçinozë

9. Cili është kuadri radiologjik tipik i artritit reumatoid?

- A) Osteofite
- B) Mikrofrakturna iuxtartikulare
- C) Osteosklerozë subkondriale
- D) Geoide diafizare
- E) Erozione të epifizës

10. Lumbalgja ose dorsalgja nocturne, që zgjon personin në orët e vona të natës, të orienton drejt diagnozës së:

- A) Skolioza
- B) Spontiliti ankirozant
- C) Spondilolistiza
- D) Osteoartroza
- E) Artriti reumatoid

11. Pozitiviteti për ANCA (antitrupa anti-citoplazëm të neutrofileve) është markues diagnostik për:

- A) Vaskulit sistemik
- B) Sarkoidozë
- C) Artrit reumatoid
- D) Sëmundje mikse e indit lidhor (MCTD)
- E) Lupus Eritematoz Sistemik

12. Cila prej sëmundjeve artikulare mund të prek trakin cervical të kolonës vertebrale?

- A) Sindroma fibromialgjike
- B) Sindroma e Reiter

- C) Artriti reumatoid
- D) Osteoporoza
- E) Polimialgja reumatike

13. Antitrupat anti-nukël (ANA) kërkohen kur dyshohet për?

- A) Artrit reumatoid
- B) Konektiviti
- C) Sarkidoza
- D) Osteoartroza
- E) Tiroiditi autoimun

14. Cila prej simptomave të sëmundjes reumatike haset më rrallë:

- A) Temperaturë
- B) Endokarditi reumatik
- C) Miokarditi reumatik
- D) Pleuriti reumatik
- E) Takikardi persistuese

15. Kuadri klinik me dhimbje artikulare, të paktën tre artikulacione të enjtura, ngurtësi në mëngjes >30 min, pozitivitet për faktorin reumatoid ose antitrupat anti-CCP të bën të mendosh për:

- A) Artrit gotoz
- B) Artrit reumatoid
- C) Spondiloartrit
- D) Polimialgji
- E) Osteoartrozë

16. Cila nga zonat është tipike që preket nga frakturat e shkaktuara nga osteoporoza e tipit II?

- A) Vertebrat lumbare
- B) Vertebrat dorsale
- C) Radiusi
- D) Qafa e femurit
- E) Vertebrat cervikale

17. Sindroma e Sjogren:

- A) Shfaqet kryesisht tek femrat në moshë të mesme
- B) Eshtë patlogji pediatrike
- C) Eshtë më e shpeshtë tek femrat e reja
- D) Nuk shoqërohet asnjëherë me artritin reumatoid
- E) Mund të shkaktojë shtim të lotëve

18. Cila prej sëmundjeve mund të konsiderohet si "artrit reaktiv" sieronegativ?

- A) Gotta (podagra)
- B) M. Crohn
- C) Diabeti
- D) Hepatiti viral
- E) M. Paget

19. Tek artriti reumatoid, dëmtimi artikular fillon nga:

- A) Kartilagjeni artikular
- B) Membrana sinovjale

- C) Kocka nënkonduale
- D) Asnjëra prej përgjigjeve
- E) Kpsula artikulare

20. Cila prej karakteristikave klinike nuk ndodh tek fibromialgja?

- A) Cefalea e tipit tensiv
- B) Emikrania
- C) Vaskuliti
- D) Vështirësitë konjitive
- E) Sindroma e kolonit të irrituar

21. Cfarë është piku i masës kockore?

- A) Vlera e densitetit mineral kockor para menopauzës
- B) Vlera mesatare e densitetit mineral kockor e gjetur gjatë densimetrisë me rreze X
- C) Vlera minimale e densitetit mineral kockor e gjetur në rastin e një frakture
- D) Vlera maksimale e densitetit mineral kockor e gjetur gjatë terapisë për osteoporozën
- E) Vlera e densitetit mineral kockor e arritur në moshën 25 vjeçare

22. Alternimi karakteristik i ezofagut në prani të sklerozës sistemike, është:

- A) Devijimi i saj në disa drejtime
- B) Formimi i divertikujve nga tërheqja
- C) Hipotoni dhe ngurtësi të pareteve dhe zgjerim të saj
- D) Formimi i divertikujve nga pulsimi
- E) Zbrazje e vonuar prej spazmave kardiale

23. Sëmundja reumatike shkaktohet nga:

- A) Streptokoku viridans
- B) Enterokoku
- C) Pneumokoku
- D) Stafilokoku
- E) Streptokoku beta-hemolitik i gr A

24. Cila prej alternativave nuk është karakteristike e spondilitit ankilogant?

- A) Dhimbre të kolonës, që përmirësohen gjatë lëvizjes
- B) Dhimbre akute të orbitës, unilaterale
- C) Fillim i ngadaltë i simptomave
- D) Lezione papulo-skuamoze në pëllëmbën e duarve dhe atë plantare
- E) Oligoartropati periferike asimetrike

25. Lezioni inflamator kronik shkatërrues që prek kërcin nazal është tipike e:

- A) Sklerodermi difuze
- B) M. Behget
- C) Lupus eritematoz sistemik
- D) Morphea
- E) M. Wegener

26. Cila është shfaqje tipike në artritin psoriazik?

- A) Perikarditi
- B) Luksacioni i radiusit
- C) Datiliti

- D) Shfaqja e dhimbjes artikulare pas sforcos fizike
- E) Fenomeni Raynaud

27. Cila patologji është përgjegjëse për përfshirjen poliartikulare nga shkaqe inflamatore?

- A) Osteoartroza
- B) Ethet reumatike
- C) Amiloidoza
- D) Hemokromatoza
- E) Hemofilia

28. Arteriti me qeliza gjigjante (arteriti temporal ose i Horton) është sëmundje e rëndë pasi:

- A) Provokon lehtësisht fraktura kockore
- B) Lehtëson zhvillimin e neoplazive
- C) Nuk ka mundësi kurimi
- D) Provokon lehtësisht insuficencë renale
- E) Provokon humbje të shikimit në mënyrë të menjëherë

29. Antigjeni HL-A B27 është i pranishëm në 85% të pacientëve të prekur nga:

- A) Spondiliti ankilozant
- B) Artriti reumatoid
- C) Gotta
- D) Artriti psoriazik
- E) Ethet akute reumatike

30. Cila prej gjendjeve të mëposhtme shoqërohet me praninë e antitrupave antinukel:

- A) Sindroma nga lodhja kronike
- B) Sindroma nga antitrupa antifosfolipide primitive
- C) Poliarteriti nodoz
- D) Lupusi sistemik
- E) Fibromialgji

31. Cila prej sëmundjeve artikulare nuk është me bazë imunologjike?

- A) Artropatia nga LES
- B) Reumatizmi artikular akut
- C) Artropatia e S. Së Felty
- D) Artropatia gotoze (podagra)
- E) Artriti reumatoid

32. Tek artriti reumatoid cili është deformimi karakteristik i gishtave të duarve?

- A) Në ekstension
- B) Devijim në anën ulnare
- C) Hiperfleksion i gishtit të vogël
- D) Devijim në anën radiale
- E) Hiperfleksion i gishtit të mesit

33. Tek artroza nodujt e gjetur janë:

- A) Nodujt Osler
- B) Nodujt e Heberden
- C) Nodujt Schmorl
- D) Nodujt në nënlëkurë

E) Nodujt reumatoid

34. Cila prej patologjive nuk bën pjesë tek spondiloartropatitë:

- A) Artriti psoriazik
- B) Polimialgia reumatike
- C) Sëmundja e Reiter
- D) Artriti reaktiv
- E) Spondiliti ankilozant

35. Cila alternativë rreth osteoporozës nuk është e vërtetë:

- A) Frakturat vertebrale mund të jenë asimptomatike
- B) Frakturat osteoporotike me dhimbje intense dhe të lokalizuar
- C) Zona e prekur më shumë nga frakturat është artikulacioni tibio-tasik
- D) Rreziku për frakturna rritet me uljen e densitetit mineral kockor
- E) Këshillohen ushtrimet fizike për forcimin e kolonës vertebrale

36. Antirupat anti-ENA:

- A) Nuk janë asnjë herë të pranishëm në konektivitin miks
- B) Shfaqen në reumatizmin artikular akut
- C) Janë gjithnjë të pranishme në nefritin nga lupus
- D) Gjenden vetëm në raste të rralla të lupusit
- E) Janë markues të sëmundjes

37. Cila prej alternativave rreth artrtit të podagrës (gotta) nuk është e vërtetë:

- A) Fillimi është në përgjithësi monoartikular
- B) Terapia hipouricemizante nuk duhet nisur gjatë atakut akut
- C) Shifrat e larta të uricemisë kanë pak vlerë për të vendosur diagnozën
- D) Shfaqjet artikulare radiologjike nuk janë të tipit eroziv
- E) Dieta dhe ndryshimi i stilit të jetesës mund të jenë të dobishme për të ulur shpeshtësinë gotoz dhe evitimit të përdorimit të mjekimeve

38. Tek artriti reumatoid në fazë akute nuk është e këshillueshme:

- A) Terapia me FANS
- B) Terapia me medikamente biologjike
- C) Sinoviekтомia
- D) Terapia imunosupresive
- E) Terapia termale

39. Cila prej shenjave radiologjike nuk është karakteristike e osteoporozës vertebrale:

- A) Hipertransparencë e trupave vertebralë dhe rritje e kontrastit të kontureve të strukturës
- B) Pamje konkave e kontureve të strukturës
- C) Rritje e spesorit të kortikales
- D) Deformim në formën e pykës e trupave vertebralë
- E) Rrallim i imazhit trasekular i kockës spongioze

40. Cila prej të dhënave laboratorike është karakteristike për osteomalacinë?

- A) Hiperkalçemi
- B) Rritje të fosfatazës alkaline në gjak
- C) Hiperkalçuri
- D) Hiposforemi

E) Hiperfosforemi

41. Eritema nodoze është karakteristikë e:

- A) Pneumonia streptokoksike
- B) Skleroza multiple
- C) Fruthi
- D) Sklerodermia
- E) Sarkidoza

42. Lezioni më karakteristik në kocka shkaktuar nga Lupusi është:

- A) Fraktura spontane
- B) Osteoporozë në formë pullash
- C) Nekroza aseptike
- D) Osteoskleroza
- E) Osteomieliti akut

43. Tek polimioziti është e shpeshtë të hasen të gjitha alternimet e mëposhtme, përvèç njërisë:

- A) Rritja e CK
- B) Hepatiti
- C) Rritje e AST dhe LDH
- D) Hiposteni/mialgji i muskulaturës së shpatullave
- E) Alternime elektromiografike

44. Alternimi okular karakteristik i sindromës së Sjogren është:

- A) Katarrakta
- B) Rritja e presionit endookular
- C) Keratokongiuntiviti i thatë
- D) Atrofia e nervit optik
- E) Iridocikliti

45. Cili prej alternimeve është tipik për artrozën?

- A) Hollimi i kartilagjenit (kërcit)
- B) Osteoporozë e përhapur
- C) Lacerimi i kapsulës
- D) Osteoporozë iuxtaartikulare
- E) Hiperplazi e sinoviociteve të tipit A

46. Cila prej formave të artrozës është e trashëgueshme?

- A) Lumboartroza
- B) Gonartroza
- C) Artroza nodoze e gishtave
- D) Artroza e shpatullës
- E) Artroza e bërryilit

47. Në sindromën hepato-renale:

- A) në urinë vihet re hematuri
- B) kolesterolemia është e rritur
- C) diureza i kalon 1500 ml/ditë
- D) diureza është më pak se 300 ml/ditë
- E) glikozuria është e vazhdueshme

48. Insuficiencia renale akut funksionale mund të jetë pasojë e:

- A) gurëve në rrugët urinare
- B) obstruksionit të rrugëve urinare
- C) abuzimit me aminoglikane
- D) shterimit të vëllimit jashtëqelizor
- E) nekrozës kortikale bilaterale

49. Oliguria hipertonike, acidzoa metabolike, hiperkalemia përputhen me kuadrin klinik-laboratorik të:

- A) diabetit mellitus të çekuilibruar
- B) diabetit insipid
- C) insuficiencës renale kronike
- D) fazës funksionale të insuficiences renale akute
- E) fazës me poliuri të insuficiencës reanle akute

50. Fraksioni i ejeksionit të natriumit të filtruar normalisht është:

- A) më pak ose baraz me 1%
- B) 1.5-3%
- C) 3-4.5%
- D) 4.5-6%
- E) 6.5-8%

51. Hipokalçemia në insuficiencën renale kronike vjen si pasojë e:

- A) hiperkalçiuirisë
- B) marrjen e pakët të kalçiumit me dietë
- C) mungesa e formës aktive të vitaminës D
- D) mungesa e PTH
- E) hiperparatiroidizëm

52. Cili prej mikroorganizmave të më poshtëm është shkaktari më i shpeshtë i pielonefritit akut:

- A) klebsiella
- B) klamidia
- C) esherikia
- D) pseudomonas
- E) candida

53. Janë gurë me natyrë radiotransparente:

- A) gurët e përbërë nga fosfati i kalçiumit
- B) gurët e përbërë nga oksalati i kalçiumit
- C) gurët me përbërje të përzjerë
- D) gurët e përbërë nga acidi urik
- E) gurët cistik

54. Në insuficiencen renale akute të tipit funksional pesha specifike e urinës është:

- A) e ulët
- B) e ndryshueshme
- C) e kushtezuar nga prania e cilindrave
- D) e rritur
- E) nuk mund të matet

55. Në poliurinë hipotonike pesha specifike e urinës është:

- A) midis 1020 dhe 1030
- B) më shumë se 1030
- C) më pak se 1006
- D) e barabartë me 1010
- E) midis 1010 dhe 1020

56. Të gjitha pohimet e mëposhtme përfaqësojnë shkaqe të hipokalemisë me përjashtim të:

- A) terapisë me ACE-inhibitor
- B) alkalozës metabolike
- C) sindromës Cushing
- D) të vjellave persistente
- E) terapisë me diuretik

57. Për të realizuar një transplant të veshkës, përputhshmëria sipas sistemit ABO:

- A) e domosdoshme vetëm nëse egziston përputhshmëria HLA
- B) jo e domosdoshme nëse egziston përputhshmëria HLA
- C) e panevojshme
- D) e domosdoshme
- E) e domosdoshme vetëm nëse është realizuar një transplant i mëparshëm

58. Sindroma nefrotike:

- A) përfaqëson një kuadër klinik të karakterizuar nga hipoalbuminemi e rëndë ($< 3 \text{ g/dl}$)
- B) paraqitet me një proteinuri mbi 2.5 g/ditë
- C) paraqitet me insuficience renale
- D) shoqërohet me gjendje hipokoagulimi dhe tendece për hemorragji
- E) është gjithmonë një sëmundje parësore e veshkave

59. Pielonefrit akut është:

- A) një sëmundje që prek kryesisht meshkujt
- B) prek kryesisht moshat e treta
- C) karakterizohet nga prania e një temperaturë me natyrë septike
- D) paraqitet me vlera normale të ERS dhe PCR
- E) paraqitet me një neutropeni të theksuar

60. Cila nga këto shenja është patognomonike për glomerulonefritin me lezione minimale:

- A) proteinuria selektive
- B) mikrohematuria
- C) hiperezotemë
- D) leukocituria
- E) cilindruria

61. Të gjitha sëmundjet e më poshtme mund të çojnë drejt insuficiencës renale me përjashtim të:

- A) LES
- B) Diabet mellitus
- C) Amiloidozë
- D) Mielosklerozë
- E) Mieloma multiple

62. Në një paciente me probleme kardiake e cila trajtohet me furosemid, cili elektrolit duhet monitoruar me kujdes?

- A) Natrium
- B) Klor
- C) Kalium
- D) Kalçium
- E) Magnesium

63. Cila nga terapitë e më poshtme konsiderohet si mjekim i zgjedhur në trajtimin mbajtës të një pacienti me artrit reumatoid të diagnostikuar për herë të parë?

- A) AIJS
- B) prednizon 40 mg/ditë
- C) metotraksat (10 mg/javë) + AIJS + kortikosteroid me doza të ulta
- D) AIJS + minociklina
- E) paracetamol sipas nevojës

64. Fenomeni Raynaud mund të shoqërohet me:

- A) erizipelë
- B) sklerodermi
- C) dermatit
- D) tromboflebit
- E) limfoadenit

65. Arteriti Horton mund të ndërllokohet me:

- A) aneurizëm të aortës abdominale
- B) disekim të harkut të aortës
- C) bllokim të arteries subklave
- D) klaudikacio të përtypjes dhe të kafshimit
- E) të gjitha janë të vërteta

66. Polimialgja reumatizmale:

- A) është një sinovit jo eroziv i artikulacionit skapulohumeral dhe strukturave përreth
- B) prek kryesisht meshkujt < 40 vjeç
- C) shkaktohet nga infeksione të shpeshta streptokoksise të tonsilave
- D) shoqërohet me purpurën Schonlein-Henoch
- E) karkaterizohet nga antikorpi JO1 pozitiv

67. Cili nga këto barna përdoret në terapinë e podagrës?

- A) penicilamina
- B) klofibratet
- C) kolestiramina
- D) kortizoni
- E) alopurinoli

68. Në cilën patologji vihet re kuadri radiologjik i "shkopit të bambusë"?

- A) Sindroma Reiter
- B) Artriti Reumatoid
- C) Spondilit ankilozant
- D) Enteroartriti

E) Sindroma Sjogren

69. Në moshat e treta, verbëria mund të jetë pasojë e:

- A) infarktit të miokardit
- B) arteriopative periferike
- C) arteritit Horton
- D) kolitit ulçeroz
- E) hernies hiatale

70. Në artritin reumatoid nuk preket një nga këto artikulacione:

- A) talokrurali
- B) radiokarpali
- C) skapulohumerali
- D) bërryli
- E) sakroiliaku

71. Të gjithë faktorët e më poshtëm janë faktor rreziku për të zhvilluar osteoporozë me përashtim të:

- A) menopauzës të parakohshme kirurgjikale
- B) duhanpirjes
- C) terapisë me fenobarbital
- D) jetës sedentare
- E) obezitetit

72. Në cilën prej patologjive të mëposhtme janë specifik antitrupat anti-CCP?

- A) Spondilit ankilozant
- B) LES
- C) Artrit reumatoid
- D) Sëmundja Behçet
- E) Artrit psoriatik

73. Manifestimi kryesor i granulomës së Wegener është:

- A) në mushkri
- B) në zorrë
- C) në sy
- D) në lëkurë
- E) në vesh

74. Antitrupat anti-SSA dhe anti-SSB takohen më shpesh në:

- A) artritin reumatoid
- B) polikondrit
- C) sindromën Sjogren
- D) artritin psoriatik
- E) sëmundjen Behçet

75. Kur një proteinuri e 24 orëve përcaktohet si nefrotike:

- A) proteinuria $>3\text{g}$
- B) proteinuria $>2\text{g}$
- C) proteinuria $>1\text{g}$
- D) proteinuria $>$ ose e barabartë me 5g

E) proteinuria > ose e barabartë me 8g

76. Të gjitha nefropatitë e mëposhtme mund të komplikojnë një shtatëzani, me përjashtim të:

- A) amilidoza
- B) pielonefriti
- C) nekroza tubulare akute
- D) nekroza kortikale
- E) uremia eklamptike

77. Përcaktuesit e filtracionit glomerular: cili prej këtyre variablate është më i rëndësishmi:

- A) fluksi i gjakut
- B) koeficienti i ultrafiltrimit glomerular
- C) përqëndrimi i proteinave në plazmën e arteries renale
- D) presioni hidrostatik glomerular
- E) presioni arterial

78. Cili prej këtyre medikamenteve hipotensivë shkakton rritje të aktivitetit plazmatik të reninës:

- A) metildopa
- B) propanololi
- C) kaptoprili
- D) klonidina
- E) nifedipina

79. Insuficiencia renale akute:

- A) karakterizohet gjithmonë nga prania e oligo-anurisë
- B) paraqet një sediment urinar të pasur me qeliza dhe cilindra hialino-granularë dhe/ose qelizorë
- C) shoqërohet gjithmonë me hipertension arterial
- D) mund të jetë sekondare nga ekzaminimet imazherike me kontrast
- E) lidhet gjithmonë me një dëmtim të strukturës renale

80. Cilët prej gurëve të mëposhtëm janë radiotransparentë:

- A) struvitë
- B) të fosfatit të kalçiumit
- C) të oksalatit të kalçiumit
- D) të acidit urik
- E) të karbonatit të kalçiumit

81. Shkaku më i zakonshëm i sindromit nefrotik tek adultët është:

- A) GN (glomerulonefriti. me lezione minimale
- B) GN (glomerulonefriti. membrano-proliferativ
- C) nefroskleroza malinje
- D) GN membranoz
- E) nefroskleroza beninje

82. Një grua e re paraqiti episodin e parë të një cistiti akut, i cili u trajtua me sukses me anë të antibiotikoterapisë përkatëse. Pacientja ka nevojë për:

- A) profilaksi me antibiotikë për 6 muaj
- B) analizë urine + urokulturë ç'do muaj për 6 muaj

- C) cistouretrografi miksionale
- D) asnjë veprim tjetër diagnostik ose terapeutik
- E) urografi perfuzional

83. Sindroma nefrotike:

- A) është një kuadër klinik që karakterizohet nga hipoalbuminemia e rëndë ($<3\text{ g/dl}$).
- B) paraqet një proteinuri më të madhe se 2.5 g/ditë
- C) prezantohet me insuficiencë renale me gravitet të ndryshëm
- D) mund të shoqërohet me kuadër "hipokoagulabiliteti" me prirje për hemorragji spontane
- E) është gjithmonë një sëmundje renale primare

84. Cili është shkaku më i mundshëm i takikardisë së shoqëruar me komplekse QRS të gjerë, në një pacient që i është nënshtuar më parë një bypass-i aorto-koronar:

- A) flater trial me çrregullim të përcimit
- B) fibrilacion atrial
- C) takikardi sinusale me çrregullim të përcimit
- D) sindromi Wolf-Parkinson-Wite
- E) takikardi ventrikulare

85. Cila prej këtyre vlerave paraqet gamën e vlerave normale të kalemisë:

- A) $1\text{-}3\text{ mEq/l}$
- B) $3\text{-}4,5\text{ mEq/l}$
- C) $3,5\text{-}5\text{ mEq/l}$
- D) $5\text{-}6\text{ mEq/l}$
- E) $6\text{-}7\text{ mEq/l}$

86. Në pacientin me anuri rreziku për jetën përfaqësohet nga:

- A) varfërimi sodik
- B) hiponatremia
- C) hipoproteinemia
- D) hiperkalemia
- E) hipertensioni

87. Bakteriuria është sinjifikative kur përqëndrimi urinar është:

- A) $1.000/\text{ml}$
- B) $10.000/\text{ml}$
- C) $100.000/\text{ml}$
- D) $1.000.000/\text{ml}$
- E) $5.000.000/\text{ml}$

88. Një sforcim i madh fizik mund të shkaktojë:

- A) hematuri
- B) hemoglobinuri
- C) proteinuri
- D) cilindra eritrocitarë
- E) të gjitha

89. Një burrë 50 vjec arrin në Shërbimin e Urgjencës më temperaturë të lartë ($T=38.8^\circ\text{C}$., të dridhura, dhimbje abdominale difuze dhe nauze. Në ekzaminimin objektiv shenja e Giordano-s është prezente. Cilin prej këtyre ekzaminimeve diagnostike të mëposhtme do kërkonit në fillim:

- A) ekografinë e aparatit urinar
- B) TAK
- C) Cistografinë retrograde
- D) RMN
- E) shintigrafinë renale

90. Si manifestohet më shpesh tumori renal:

- A) masë e palpueshme
- B) hematuri
- C) kolikë renale
- D) diagnoza është e rastësishme
- E) oliguria

91. Cila prej këtyre simptomave i paraprin zhvillimit të nefropatisë diabetike:

- A) rritja e natriurisë
- B) mikrohematuria
- C) cilindruria
- D) shtimi i vëllimit renal
- E) reduktimi i filtracionit glomerular

92. Cili është dekursi i glomerulonefritit akut post-streptokoksik:

- A) evoluon drejt insuficiencës renale kronike
- B) shërohet
- C) evoluon drejt sindromit nefrotik
- D) proteinuri reziduale
- E) hypertension arterial

93. Cili prej muskujve të aktivitetit inspirator është më i rëndësishmi:

- A) muskujt interkostalë ekstern
- B) diafragma
- C) muskuli rektus abdominal
- D) muskujt interkostalë intern
- E) muskuli sternokleidomastoid

94. Të gjitha pohimet e mëposhtme mbi diuretikët tiazidikë janë të vërteta me përashtim të:

- A) mund të shkaktojnë hiperuricemi
- B) përdoren për të nxitur një diurezë të sforuar në emergjencat toksikologjike
- C) janë diuretikë të zgjedhjes së parë për trajtimin e hipertensionit arterial
- D) ndikohen për trajtimin e edemave që shoqërojnë cirrozën hepatike
- E) inhibojnë transportin e Na⁺-Cl⁻ në tubulin distal të përdredhur

95. Në hemodializë akseset vaskulare të përkohshme mund të përftohen me anë të inserimit të kateterëve me lumen të vetëm ose të dyfishtë në venat:

- A) subklavia
- B) jugulare interne
- C) femorale
- D) të gjitha përgjigjet e mësipërme
- E) asnëra

96. Dobësia muskulore në nivel të shpatullave, shoqëruar me rritje të eritrosedimentit gjatë orës së parë, tek një person i moshuar karakterizojnë:

- A) polimiozitin
- B) polimialgjinë reumatike
- C) sëmundjen Still
- D) miopatinë sekondare të hipotiroidizmit
- E) entesopatinë e rotatorëve

97. Zbulimi i proteinurisë së matshme ($>3.5\text{g/ditë}$) dhe cilindrurisë është patognomonike për një:

- A) sindrom nefritik
- B) sindrom nefrotik
- C) hipertension arterial
- D) insuficiencë renale akute ishemike
- E) pielonefrit akut

98. Të gjitha pohimet e mëposhtme janë të vërteta me përjashtim të:

- A) angiotenzina II shkakton vazokonstriksion për shkak të efektit të drejtpërdrejtë mbi arteriolat prekapilare
- B) angiotenzina II antagonizon efektet e aldosteronit
- C) angiotenzina II shkakton hipertrofi dhe rimodelim të strukturave kardiovaskulare
- D) receptori AT1 për angiotenzinën II është i atashuar me një proteinë G
- E) lidhja e angiotenzinës II me receptorin AT2 frenohet në mënyrë specifike nga sartanet

99. Cila prej alternativave paraqet një komplikacion renal të rëndë në diabetin mellit:

- A) polakiuria me dizuri
- B) glukozuria persistente
- C) nefrolitiazë
- D) cistiti akut hemorragjik
- E) glomeruloskleroza

100. Ekzaminimet e shkallës së parë për diagnostikimin e karcinomës së prostatës janë:

- A) ekzaminimi rektal, ekografija transrekiale + biopsia
- B) shintigrafia kockore, TAK abdominal
- C) ekzaminimi rektal, TAK abdominal
- D) ekzaminimi rektal
- E) Asnjëra

101. Cila prej glomerulopative të mëposhtme paraqitet me sindrom nefrotik:

- A) post-infektive
- B) proliferative mezangiale
- C) proliferative ekstrakapilare
- D) glomerulopatia diabetike
- E) glomeruloskleroza

102. Një obstruksion urinar që shkakton hidronefrozë tek fëmija zakonisht shkaktohet nga:

- A) një keqformim kongjenital i traktit urinar
- B) vaza jonormale që komprimojnë ureterin
- C) gurët
- D) "përdredhja" e një ureteri në terren të një veshke ptoziqe

E) një fimozë shumë e rëndë

103. Si duken gurët në ekografi:

- A) imazh hipoekogen me hije akustike konike posteriore
- B) imazh hipoekogen me përforcim posterior
- C) imazh hiperekogen me hije akustike konike posteriore
- D) imazh hiperekogen me përforcim posterior
- E) imazh anekogen

104. Anemia e insuficiencës renale kronike:

- A) është kryesisht e lidhur me një deficít në thithjen e hekurit
- B) është kryesisht e lidhur me një deficít në prodhimin e eritropoetinës
- C) trajtohet vetëm me hemotransfuzion
- D) nuk trajtohet sepse kontribuon në ruajtjen e vlerave të pranueshme të presionit të gjakut
- E) prek kryesisht gratë në moshën e fertilitetit

105. Nga ku e merr më shpesh origjinën karcinoma me qeliza renale:

- A) tubuli proksimal i përdredhur
- B) ansa Henle
- C) duktë kolektor
- D) pieloni renal
- E) tubuli distal i përdredhur

106. Cilin veprim respirator predominues kryejnë muskujt abdominalë:

- A) veprim inspirator në qetësi
- B) asnjë veprim
- C) shtim të presionit intrapleural
- D) veprim ekspirator
- E) veprim inspirator gjatë sforcimit

107. Cila prej këtyre teknikave imazherike diagnostikuese nuk është e dobishme në diagnostikimin e stenozës së arteries renale:

- A) angiografia
- B) eko-kolor-doppler
- C) angiografia me rezonancë magnetike
- D) pielografia retrograde ashendente
- E) shintigrafia renale

108. Një pacient paraqet një gur oksalat kalçiumi më pak se 1cm në pielonin renal që shkakton kolika recidivante. Cila është terapia e zgjedhjes së parë:

- A) pielolitotomia kirurgjikale
- B) ureterorenoskopja
- C) litotripsi ekstrakorpore
- D) terapia hidropike
- E) pielolitotomia perkutane

109. Shkaku më i shpeshtë i sindromit nefrotik në moshën pediatrike është:

- A) glomerulopatia proliferative ekstrakapilare
- B) glomerulopatia me lezione minimale
- C) glomerulopatia membranoze

- D) glomerulopatia proliferative mezangiale
E) glomerulopatia post-infektive

110. Cila prej këtyre simptomave të insuficiencës renale është më e ndjeshme ndaj korrigjimit të hipokalemisë:

- A) nauza dhe të vjellat
B) astenia muskulore
C) diarrea
D) pruriti
E) cefalea

111. Pielonefriti akut:

- A) është sëmundje karakteristike për seksin mashkull
B) prek zakonisht personat në moshë të avancuar
C) karakterizohet zakonisht nga prania e temperaturës të tipit septike
D) paraqitet me vlera normale të eritrosedimentit dhe proteinës C reaktive
E) paraqitet me një neutropeni të shprehur

112. Në cilin tip të emfizemës hiperinflacioni pulmonar merr një rëndësi më të madhe:

- A) emfizema panlobulare
B) emfizema buloze
C) emfizema acinare distale
D) emfizema paraseptale
E) emfizema cikatriciale

113. Në sindromin nefrotik, cila prej këtyre simptomave/shenjave mund të ndeshet:

- A) urina me shkumë
B) anoreksia
C) shndritja e retinës
D) dhimbja abdominale
E) të gjitha

114. Me cilat nga këto teknika imazherike nuk mund të vizualizohet ureteri:

- A) urografia
B) tomografia e kompjuterizuar
C) urografia gjatë rezonancës magnetike
D) radiografia direkte e abdomenit
E) pielografia transnephrostomike deshendente

115. Cila prej sindromave të mëposhtme karakterizohet nga: humbja renale e K, Na dhe Cl, hipokalemia, hiperaldosteronizmi, hiperreninemia dhe presioni arterial normal:

- A) Sindroma e Liddle
B) Sindroma e Laron
C) Sindroma e Kawasakit
D) Sindroma e Bartter
E) Sindroma e Di George

116. Cilat janë shkaqet më të shpeshta të versamentit pleural:

- A) pneumonia
B) fibroza pulmonare

- C) tuberkulozi
- D) infekzionet virale
- E) pneumotoraksi

117. Cila prej këtyre shenjave është patognomonike për glomerulonefritin me lezione minimale:

- A) proteinuria selektive
- B) mikrohematuria
- C) hiperazotemia
- D) leukocituria
- E) cilidruria

118. Patogjeneza e hipernatremisë gjatë ushqyerjes parenterale lidhet me:

- A) shtimin e riabsorbimit proksimal të natriumit
- B) diurezën osmotike
- C) reduktimin e sekretimit të hormonit antidiuretik
- D) sekretimin e shtuar të hormonit aldosteron
- E) filtrimin e shtuar glomerular

119. Gjetja e një vlere të rritur të CA-125 shoqërohet në më shumë se 80% të rasteve me diagnozën e:

- A) karcinomës së kolonit
- B) karcinomës mamare
- C) karcinomës së ovareve
- D) seminomës
- E) karcinomës së qafës së mitrës

120. Hipertensioni nefrovaskular (shkak potencialisht i trajtueshëm i hypertensionit arterial) është vlerësuar në popullatë rrith:

- A) mbi 10%
- B) 5-10%
- C) 1-5%
- D) <1%
- E) nuk është kurrë shkak i hypertensionit arterial

121. Bakteri më shpesh i përfshirë në infekzionet e pakomplikuara të rrugëve urinare është:

- A) proteus
- B) stafilokoku
- C) mykoplasma
- D) Escherichia Coli
- E) Streptokoku

122. Të gjitha komplikacionet e mëposhtme klinike ndeshen në IRK terminale me përjashtim të:

- A) neuropatisë periferike
- B) bronkitit astmatiform
- C) perikarditit
- D) anemisë
- E) osteodistrofisë

123. Diagnoza e hypertensionit esencial:

- A) bëhet me siguri
- B) bëhet me anë të përjashtimit
- C) është instrumentale
- D) është histologjike
- E) është serologjike

124. Në fikun e djathtë të një neonati ndeshet një masë e palpueshme. Urografía evidenton zhvendosje dhe distorsion të pelvisit dhe kaliceve të veshkës së djathtë. Diagnoza më e mundshme është:

- A) neuroblastoma
- B) tumori i Wilms
- C) hidronefroza
- D) tromboza e venës renale
- E) veshka polikistike

125. Me cilat simptoma shoqërohet më shpesh karcinoma me qeliza renale gjatë diagnostikimit:

- A) hematurinë
- B) hematurinë + dhimbjen në fik + masë e palpueshme
- C) asnjë simptomë (diagnozë e rastësishme gjatë një ekzaminimi ekografik.
- D) hypertensionin
- E) insuficiencën renale akute

126. Një grua 30 vjeç shtrohet me sindrom nefrotik. Ekzaminimi i proteinurisë zbulon një humbje të rëndësishme të albuminës dhe mungesë të humbjes urinare të proteinave me peshë molekulare të madhe. Cila prej këtyre situatave është në gjendje të përcaktojë një kuadër të tillë klinik:

- A) nefropatia membranoze
- B) nefropatia membrano-proliferative
- C) nefropatia glomerulare me lezione minimale
- D) glomerulonefriti proliferativ
- E) glomerulonefriti fokal

127. Dializa peritoneale:

- A) kërkon hospitalizim të detyrueshëm
- B) preferohet ndaj HD në pacientët me IRK hemodinamikisht të paqëndrueshëm
- C) lejon një fleksibilitet më të vogël për oraret dhe zhvendosjet, në krahasim me HD
- D) është një teknikë e vjetër
- E) të gjitha

128. Cilat janë vlerat që konsiderohen si shenjë e dëmtimit të veshkave në një pacient hipertensiv të seksit mashkull:

- A) kreatinina plazmatike > 1.5 ;
- B) kreatinina plazmatike > 1.0 ;
- C) kreatinina plazmatike > 1.3 ;
- D) kreatinina plazmatike > 1.0 ;
- E) kreatinina plazmatike > 1.6 ;

129. Simptoma fillestare e sindromit nefrotik normalisht është:

- A) edema
- B) hypertensioni

- C) hematuria
- D) stranguria
- E) oliguria

130. Të gjitha situatat e mëposhtme patologjike mund të çojnë në IRK me përjashtim të:

- A) glomerulonefritit
- B) pielonefritit
- C) renit polikistik
- D) tubulonekrozës akute nga shoku
- E) nefroangiosklerozës

131. Nefropatia më shpesh shkaktare e IRK është:

- A) nefropatia diabetike
- B) nefropatia intersticiale
- C) nefropatia glomerulare
- D) nefropatia vaskulare
- E) nefropatia tubulare

132. Administrimi i zgjatur i cilit prej këtyre medikamenteve konsiderohet një faktor rreziku për Osteoporozën:

- A) ACE inhibitorët
- B) Diuretikët tiazidikë
- C) Kortikosteroidet
- D) Antagonistët e kalçiumit
- E) Laksativët

133. Reduktimi i izoluar i koeficientit të ultrafiltrimit shkakton një nga këto simptoma:

- A) mikrohematuri
- B) leukocituri
- C) dislipidemi
- D) hipertension
- E) hipoproteinemi

134. Cili prej këtyre medikamenteve indikohet në trajtimin fillestar të pacientit me insuficiencë kardiake pak simptomatike:

- A) hidrokortizidi
- B) ACE inhibitorët
- C) Digoksina
- D) Amiodaroni
- E) Betabllokusit

135. Tregoni cilët ekzaminime laboratorike janë zakonisht të alteruar në hipertensionin esencial pa komplikacione sekondare:

- A) elektrolitet në gjak
- B) kreatininemia
- C) asnjëri
- D) ekzaminimi i urinës
- E) hormonale

136. Një grua 40 vjeç pa ankesa kryen, në terren të një chek-up, një analizë urine me urokulturë pozitive për E. Coli me ngarkesë >100.000 UFC. Gruaja ka:

- A) IVU të rrugëve të poshtme urinare
- B) IVU të rrugëve të sipërme urinare
- C) bakteriuri asimptomatike
- D) dizuri
- E) cistit intersticial

137. Cila prej situatave të mëposhtme shoqërohet me incidencën më të lartë të tumorit të testikulit:

- A) varikocela
- B) trauma e testikulit
- C) kriptorkidizmi
- D) hidrocela
- E) hipogonadizmi

138. Në glomerulonefritin membranoz tipik janë të pranishme të gjitha shenjat e mëposhtme, me përjashtim të:

- A) hipertensionit
- B) proteinurisë
- C) hipoproteinemisë
- D) hiperkolesterolmisë
- E) edemave

139. Cili është komplikacioni më i frikshëm i sindromit nefrotik:

- A) hipertensioni arterial
- B) insuficiencia renale
- C) insuficiencia renale akute
- D) tromboza e venës renale
- E) dekompernsimi kardio-cirkulator

140. Pielonefriti kronik (nefriti tubulo-interstitial infektiv kronik., shënoni përgjigjen e pasaktë:

- A) shpesh është bilateral
- B) shkakton atrofi dhe deformim të kaliceve
- C) nuk lidhet me anomali anatomike
- D) shpesh lidhet me një refluks veziko ureteral
- E) asnjëra

141. Nefropatia nga IgA karakterizohet nga:

- A) nga një model histologjik variabël, më shpesh e tipit proliferativ-sklerotik mezangial, me depozitime të IgA
- B) prania e IgA në arteriola
- C) prania e IgA në tubula
- D) prania e IgA në lumenin e kapilarëve
- E) glomeruloskleroza

142. Cila nga nefropatitë e mëposhtme karakterizohet nga: proteinuria, hematuria e lehtë, hipertensioni, hiperazotemia:

- A) Sëmundja me lezione minimale tek fëmijët
- B) Glomerulonefriti membranoproliferativ

- C) Glomeruloskleroza fokale segmentare
- D) Kalkuloza renale
- E) Glomerulonefriti mezangioproliferativ

143. Enureza është:

- A) gjithmonë patologjike
- B) fiziologjike gjatë 2-3 viteve të para të jetës
- C) fiziologjike deri në moshën 5 vjeç
- D) nuk mund të shkaktohet kurrë nga infekzionet
- E) normale në moshën e avancuar

144. Komplementemia është e ulur në një nga glomerulopatitë e mëposhtme:

- A) nefropatia diabetike
- B) glomerulonefriti post-infektiv
- C) glomerulonefriti membranoz
- D) nefropatia në terren të amiloidozës
- E) glomerulonefriti me lezione minimale

145. Cila prej këtyre situatave favorizon akumulimin e K⁺ në organizëm?

- A) diarrea
- B) të vjellat e vazhdueshme
- C) acidoza diabetike
- D) abuzimi me klortiazidikë
- E) insuficiencia kortikosurenale

146. Nekroza tubulare akute mund të jetë komplikacion i:

- A) glomerulonefrtit akut difuz
- B) sindromit nefrotik
- C) litiazës renale
- D) amiloidozës renale
- E) sindromës së shtypjes

147. Në një pacient, gjatë ecurisë së versamentit pleural masiv, vlerësohen të gjitha shenjat e mëposhtme me përjashtim të:

- A) reduktimit të fremitus vokal taktil
- B) respiracionit vezikular të reduktuar ose që mungon
- C) prekjes së nervave
- D) ekskursionit të reduktuar të hemitoraksit të prekur
- E) tingullit të qartë pulmonar

148. Në personat me moshë të re, heqja e njërisë veshkë shkakton tek veshka e mbetur:

- A) hipertrofi
- B) hipertrofi dhe hiperplazi
- C) hiperplazi
- D) hipoplazi
- E) hipoplazi dhe hipotrofi

149. Testi specifik për vlerësimin e fluksit plazmatik renal është:

- A) klirensi i insulinës
- B) klirensi i kreatininës

- C) klirensi i paraaminohipuratit
- D) klirensi i inulinës
- E) të gjitha

150. Janë shkaktarë të inkontinencës tranzitore faktorët e mëposhtëm me përjashtim të:

- A) infekzionit simptomatik të rrugëve urinare
- B) konsumimit të alkoolit
- C) konsumimit të disa substancave mjekësore
- D) fekalomës
- E) konsumimit të sasive të tepërtë të lëngjeve

151. Cili prej këtyre medikamenteve përbën terapinë më efikase, për reduktimin e vdekjeve të papritura në pacientë me kardiopati koronare të qëndrueshme me defiçit të funksionit ventrikular:

- A) amlodipina
- B) betabllokuesit
- C) nitratet
- D) diuretikët
- E) digoksina

152. Cila prej alternativave të mëposhtme shihet më shpesh në hipokalemi:

- A) kapaciteti i reduktuar për të pëqëndruar urinën
- B) reduktimi i filtratit glomerular
- C) humbja e aftësisë së hollimit të urinës
- D) alterimi i klirensit të ujit të lirë
- E) reduktimi i klirensit të acidit para-aminohipurik

153. Prania e eritrociteve me morfollogji të ruajtur e kufinj të rregullt, dhe veçanërisht, mungesa e plotë e akantociteve në sedimentin urinar, është tregues i fortë i:

- A) pH alkaljin të urinës
- B) hemorragjisë me prejardhje nga rrugët urinare (uretere, vezikë, uretrA)
- C) pranisë së sindromit nefrotik
- D) dëmtimit glomerular
- E) nefropatisë intersticiale

154. Shfaqja e makrohematurisë 15 ditë pas një episodi inflamacioni të rrugëve të sipërme ajrore, për cilën glomerulopati të bën të mendosh:

- A) skleroza fokale dhe segmentare
- B) proliferative mezangiale me depozitime të IgA
- C) membrano-proliferative
- D) membranoze
- E) post-streptokoksike

155. Cili prej ndryshimeve të mëposhtme të stilit të jetesës ka rezultuar më efikas në reduktimin e presionit arterial:

- A) reduktimi i peshës trupore
- B) ndërprerja e duhanpirjes
- C) reduktimi i kripës në dietë
- D) eliminimi i kafeinës në dietë
- E) terapia e pushimit

156. Në pielonefritin akut, faktor favorizues për fillimin e një nekroze papilare është:

- A) bakteriuria
- B) diabeti mellitus
- C) hiperdislipidemia
- D) hipodisproteinemia
- E) bilirubinuria

157. Të gjitha pohimet e mëposhtme lidhur me IRK janë të sakta, me përjashtim të:

- A) bilancit sodik negativ
- B) bilancit sodik pozitiv
- C) bilancit sodik të ekuilibruar
- D) bilancit negativ të fosfateve
- E) bilancit pozitiv të joneve hidrogjen

158. Si prezantohet më shpesh tumori i vezikës urinare:

- A) si urgjencë mikSIONALE
- B) si polakiuri
- C) si makrohematuri
- D) si stranguri
- E) si poliuri

159. Cilën grupmoshë prek më shpesh glomerulonefriti akut post-streptokoksik:

- A) fëmijët
- B) të rinjtë
- C) të moshuarit
- D) adultët
- E) neonatët

160. Cili prej infeksioneve virale të mëposhtme shoqërohet më shpesh me shfaqjen e hepatokarcinomës në një pacient pa cirrozë hepatike:

- A) infekzioni me Virusin e Hepatitit A
- B) infekzioni me Virusin e Hepatitit B
- C) infekzioni me Virusin e Hepatitit C
- D) infekzioni me Virusin e Citomegalovirusit
- E) infekzioni me Virusin Epstein Barr

161. Një djalë 16 vjeç prezanton një kuadër klinik të sindromit nefrotik dhe kryen biopsinë renale; kuadri histologjik statistikisht më i mundshëm do të jetë:

- A) glomerulonefriti post-streptokoksik
- B) glomeruloskleroza segmento-fokale
- C) leziona glomerulare minimale
- D) glomerulonefriti membranoz
- E) nefropatia diabetike

162. Cilat janë shenjat indirekte të një guri urinar në ekografi:

- A) formacion ekogen
- B) hije konike
- C) zgjerim i rrugëve urinare mbi pengesë
- D) radioopacitet

E) radiotransparencë

163. Glomerulonefriti që vërehet më shpesh në terren të një neoplasie është:

- A) GN(glomerulonefriti. me lezione minimale
- B) GN(glomerulonefriti. membrano-proliferativ
- C) Glomeruloskleroza segmetare fokale
- D) GN(glomerulonefriti. membranoz
- E) GN(glomerulonefriti. proliferativ me trombe

164. Cili prej pohimeve të mëposhtme është i sakte:

- A) nivelet në gjak të kreatininës nuk ndryshojnë me moshën dhe seksin
- B) klirensi i kreatininës nënvlerëson filtracionin real glomerular (i matur me klirensin e inulinës. dhe ky nënvlerësim është më i madh sa më shumë të reduktohet filtracioni
- C) konsumimi i mishit në dietë nuk ndikon nivelet e kreatininës në gjak
- D) nivelet e azotemisë nuk ndikohen vetëm nga filtracioni glomerular, por edhe nga diureza dhe marrja e proteinave në dietë
- E) konsumimi i mishit në dietë nuk ndikon nivelet e azotemisë

165. Çfarë duhet bërë kur kemi prani të mikrohematurisë së izoluar në një skiator:

- A) kryerja e biopsisë renale
- B) moskryerja e biopsisë renale
- C) përcaktimi i klirensit të kreatininës
- D) matja e presionit arterial
- E) kontrollimi i pacientit periodikisht

166. Urinat në glomerulonefrit akut paraqesin të gjitha alterimet e mëposhtme me përjashtim të:

- A) hematuri makroskopike
- B) cilindra eritrocitarë
- C) proteinuri
- D) ngjyrim kafe
- E) koagula

167. Cila prej terapive të mëposhtme përzgjidhet aktualisht në fillim në një pacient me Artrit Reumatoid:

- A) AINS
- B) Prednizon 40mg/ditë
- C) Metotreksat (10mg/javë. + AINS + ndoshta kortikosteroidë me dozë të ulët
- D) AINS + minociklinë (100mg 2 herë në ditë.
- E) Paracetamol sipas nevojës

168. Cila është patologji më shumë përgjegjëse për hyrjet e reja në dializë për shkak të uremisë terminale:

- A) glomerulonefriti primar
- B) sëmundjet renale kongjenitale
- C) diabeti mellitus
- D) hipertensioni arterial
- E) nefropatitë tubulointersticiale

169. Cili prej çrregullimeve të mëposhtme të gjumit ka prevalencë më të madhe në pacientët e dializuar në krahasim me popullatën e përgjithshme:

- A) Somnambulizmi
- B) Çrregullim i fazës REM
- C) Sindromi i këmbëve të shqetësuara
- D) Kërcitja e dhëmbëve
- E) Asnjëra

170. Të gjitha nefropatitë e mëposhtme recidivojnë në veshkën e transplantuar, përveç:

- A) glomerulosklerozës segmentare fokale
- B) glomerulonefritit membrano-proliferativ
- C) glomerulonefritit me antikorpe anti membranë bazale glomerulare
- D) nefropatia me depozitime mezangiale të IgA
- E) tubulopatia kongjenitale e Gitelman

171. Në asnjërën prej situatave të mëposhtme nuk vërehet rritja e gap-it anionik, përveç:

- A) nefropatisë intersticiale
- B) mosushqyterjes
- C) uretersigmoidostomisë
- D) acidozës tubulare proksimale
- E) nefropatisë diabetike

172. Ku e merr origjinën më shpesh tumor i prostatës:

- A) nga zona qëndrore
- B) nga zona periferike
- C) nga zona e tranzicionit
- D) nga vezikulat seminale
- E) nga uretra prostatike

173. Vendi më i shpeshtë i metastazave të tumorit të prostatës jashtë limfonodujve është:

- A) kolona lumbo-sakrale
- B) pulmonet
- C) mëlçia
- D) surenalet
- E) truri

174. Cilat janë shkaqet më të zakonshme të dëmtimit të erekzionit me natyrë organike:

- A) vaskulare
- B) nervore
- C) jatrogjenike
- D) hormonale
- E) patologji të trupave kavernoza

175. Të gjitha sëmundjet e mëposhtme mund të çojnë në IRK me përjashtim të:

- A) lupusit eritematoz sistemik
- B) diabetit mellitus
- C) amiloidozës
- D) mielosklerozës
- E) mielomës multiple

176. Cila prej këtyre simptomave të IRK është më e ndjeshme ndaj korrigjimit të acidozës:

- A) diarrea

- B) nauzea dhe të vjellat
- C) astenia muskulore
- D) anemia
- E) pruriti

177. Në një pacient me dekompensim kardiak nën trajtim me furosemid, cili prej elektroliteve të mëposhtëm duhet monitoruar vazhdimeshit:

- A) Natriumi
- B) Klori
- C) Kaliumi
- D) Kalçiumi
- E) Magnezi

178. Në një pacient me IRK kryerja e një ekzaminimi koronarografik:

- A) duhet kundërindikuar gjithmonë
- B) duhet kundërindikuar nëse vlerat e kreatininës janë më të larta se norma
- C) mund të realizohet me përgatitjen e duhur
- D) nuk ka efekte mbi funksionin renal
- E) pas një ekzaminimi të tillë kërcohët kryerja e procedurës së menjëhershme të dializës

179. Një individ i sëmurë me Tuberkuloz, nëse nuk i nënshtronhet kurave të përshtatshme, mund të infektojë për gjatë një viti:

- A) një mesatare prej 10-15 personash
- B) 20-30
- C) mbi 40
- D) mbi 50
- E) mbi 100

180. Për cilën nga manifestimet e mëposhtme të SIDA-s, besohet se luan një rol patogenetik virusi human herpes tip 8 (HHV-8):

- A) sarkomën Kaposi
- B) limfadenopatinë e gjeneralizuar persistente
- C) angiomatozën bacilare
- D) diarrenë kronike
- E) leukoplakinë orale viloze

11. Kirurgji e Përgjithshme

1. Ne sindromen mediastinale organet e para qe influencohen nga rritja e presionit endomediastinal janë:

- A) Trakea
- B) Vena kava superiore dhe dy venat anonime
- C) Ezofagu
- D) Arteriet
- E) Nervat

2. Një pacient operohet sepse dyshohet per apendisit akut. Gjate operacionit vihet re se apendiksi edhe ciekum janë normal. Ne Ileusin terminal vihet re një pjese prej 30cm e skuqur, edematoze dhe e trashur me rreshqitje te dhjamicit mesenterial mbi ileus, e cila te ben te dyshosh per Morbus

Crohn. Nuk vihet re dilatim i zorres rreth zones se interesuar. Pjesa tjeter e zorres se holle duket normale. Terapia kirurgjikale e preferuar është

- A) Mbyllje e abdomenit
- B) Ileo trasversostomi latero-laterale
- C) Ileostomi e traktit te interesuar
- D) Apendicektomi profilaktike
- E) Emikolektomi dx

3. Çfarë ekzaminimi është me i keshilluar per te pare një insulinome?

- A) Splenoportografija
- B) Kolangiografija retrograde
- C) Arteriografija selective
- D) Ekografja
- E) Shintigrafia

4. Mbas te ngrenit, ne një pacient qe ka pesuar një rezekcion te stomakut shfaqet ipersudoracion, ndjesi nxehtesie, nausea, lipotimi dhe cefale, duhet te mendojme per:

- A) Pankreatit akut
- B) Ulçer
- C) Stenoze pilorike
- D) Degjeneracion neoplastik
- E) Sd. Dumping

5. Sistemi anastomik portal perfshin te gjitha venat e mëposhtme, përveç:

- A) Gastrika sinistra
- B) Paraombelikale
- C) Hemorroidale superior
- D) Renale sinistra
- E) Mesenterika inferior

6. Pankreatiti akut duhet te trajtohet me kirurgji:

- A) Ne te gjitha rastet
- B) Ne rast nekroze
- C) Ne rast iperamilasemie persistente
- D) Kur P.C.R është mbi 20
- E) Ne rast nekroze te infektuar

7. Një pacient 60 vjeç shfaq ne kohe kolle edhe Temperaturë te rrregullt, jo sh te larte.

Ekzaminimi i pare qe duhet bërë per te vendosur një diagnose është:

- A) Citologjia e espektoratit
- B) Radiografi toraksit
- C) Tine test
- D) Bronkoskopi
- E) Emokromi

8. Arteria emorroidale superior është dege e:

- A) Arteries pudenda
- B) Arteries mesenterika inferior
- C) Arteries iliaka sinistra
- D) Arteries sigmoidale

E) Arteries ipogastrika

9. Ne frakturen e colum femorit arti prezantohet klinikisht:

- A) I rrrotulluar nga brenda edhe i zgjatur
- B) I rrrotulluar nga jashte edhe i zgjatur
- C) I rrrotulluar nga jashte edhe i shkurtuar
- D) I rrrotulluar nga brenda edhe i shkurtuar
- E) I drejte edhe i zgjatur

10. Cili nga faktoret më poshtë predisponon lindjen e neoplazise te colon-rectumit?

- A) Tymi i cigares
- B) Diabeti
- C) Alkoli
- D) Ipertensioni portal
- E) Genet

11. Cili prej ekzaminimeve më poshtë është me i pershatshem per diagnozen e kolecistitit akut?

- A) Gastroskopja
- B) TC
- C) Radiografia e abdomenit
- D) Kolnagiografia retrograde
- E) Ekografja

12. Cili prej ekzaminimeve më poshtë është me i pershatshem per diagnozen e neoplazise te bronkut principal te pulmonit:

- A) Radiografia standarte e toraksit
- B) Bronkoskopia
- C) Stratigrafja
- D) Shintigrafia pulmonare
- E) Bronkografia

13. Nga çfarë shkaktohet Sd. Iperparatiroidizmit primar ne 90% te rasteve?

- A) Adenoma solitare
- B) Adenoma multiple
- C) Iperplazia difuze
- D) Ipertrofia difuze
- E) Adenokarcinoma

14. Cili prej ekzaminimeve më poshtë është me i pershatshem per diagnozen e Bronkektazise?

- A) Radiografia standarte
- B) Shintigrafia pulmonare
- C) Bronkografia
- D) Bronkoskopia
- E) Stratigrafja

15. Cili prej ekzaminimeve më poshtë është me i pershatshem per diagnozen e kancerit gastric:

- A) Esofagogastroskopia me biopsi
- B) RX digestive
- C) TC

- D) Citologji i lengut te stomakut
- E) Ekografi

16. Dilatimi i pleksit pampiniform shkakton:

- A) Spermatocele
- B) Varikocele
- C) Idrocele
- D) Cistocele
- E) Mielocele

17. Te gjitha karakteristikat obiective te identikuara gjate eksplorimit dixhital te rectumit ne kancerin e prostates janë të vërteta përvç:

- A) Humbja e simetrise se gjendres
- B) Rritje konsistences
- C) Mungesa e rrjedhshmerise se planeve persiper
- D) Kufijte jo te definuara
- E) Konservimi i sulcus median interlobar

18. Gangrene gasoze është e shkaktuar me shpesh nga:

- A) S. epidermidis
- B) S. aureus
- C) E.coli
- D) P.mirabilis
- E) C.perfringens

19. Ligatura e venes spermatika është e keshilluar per kurimin e:

- A) Induratio penis plastic (semundja e Peyronie)
- B) Varikoceles
- C) Torsionit te funikulit
- D) Kriptokidizmit
- E) Idroceles komunikante

20. Simptoma me e shpeshtë e Kolangiokarcinomes është:

- A) Ikter
- B) Kostipacion
- C) Disfagia
- D) Rritje e peshes
- E) Diare

21. Te gjitha sëmundjet më poshtëshkaktojne litiazi te vezikes urinare, përvç:

- A) Iperfrofise prostates
- B) Prostatit akut
- C) Stenoze uretrale
- D) Vezika neurologjike
- E) Skleroze e colum vezikale

22. Dyzet e tete ore mbas një torsioni te testikulit kush prej alternativave më poshtë futet ne diagnoza diferencale?

- A) Idrocela
- B) Seminoma

- C) Epididimit tuberkolar
- D) Hernia inguino-skrotal
- E) Orkiepiditimit akut aspecifik

23. Cila prej manovrave më poshtë jep dhimbje ne rast kolecistiti?

- A) Mc burney
- B) Blumberg
- C) Giordano
- D) Murphy
- E) Te gjitha pergjigjet

24. Cili është ekzaminimi i zgjedhur per studimin e neoplazive retroperitoneale?

- A) Urografia
- B) Aortografija
- C) CT
- D) Retropneumoperitoneo
- E) Klizma opake

25. Simptoma me frekuente ne karcinomen e colonit është:

- A) Dispepsia
- B) Retorragji
- C) Dhimbje barku
- D) Dhimbje anale
- E) Kostipacion

26. Te githa sëmundjet më poshtë mund të jenë shkak per një gjinekomasti sekondare, përveç:

- A) Tumor i testikulit
- B) Insuficience renale kronike
- C) Cirroze epatike
- D) Tumoret kortiko-surenale
- E) Malnutricion

27. Te gjitha shenjat më poshtëtë rreshtuara janë prezente ne insuficencen celiako-mezenterike kronike, përveç:

- A) Dhimbjes post-prandiale
- B) Malabsorbimit
- C) Renja ne peshe
- D) Melenes
- E) Tension abdominal

28. Arterite e Hortonit paraprihet me shpesh nga:

- A) Polimiosite
- B) Poliartrite skapollo-omerale
- C) Artrite reumatoide
- D) Artroza lombosakrale
- E) Epikondilite

29. Te gjitha simptomat më poshtë janë karakteristike te infiamacionit te esofagut nga refluksi, përveç

- A) Dhimbje interskapolare

- B) Dhibjje ne pozicion supin
- C) Disfagia
- D) Emofisi
- E) Gjak okult ne fece

30. Sindroma Peutz-Jeghers karakterizohet nga:

- A) Iperpigmentacione muko-kutane edhe ematoma te kanalit digestiv
- B) Ulceracione multiple te mukozes te tubit digerent, kalkoloze biliare edhe splenomegali
- C) Ascit, tumor i orofaringsit edhe ipogonadizem
- D) Alopecia edhe angiodisplazia e colonit
- E) Ipertension nefro-vaskolare edhe esofagit nga refluksi

31. Te gjitha frazat më poshtë janë te sakta per pneumoperitoneon përveç:

- A) Është i shkaktuar nga prezenca e gazit te lire ne kavitetin peritoneal
- B) Tenezem
- C) Mund te shkaktohet nga laparoskopia
- D) Shoqerohet me zhdukjen e aies otuze te heparit
- E) Vihet re gati gjithmone mbas një perforimi te organeve te brendshme ne kavitetit abdominal

32. Një grua 24 vjeç i nenshtrohet një interventi me laparoskopi eksplorative sepse dyshohej per apendisit. Gjate operacionit behet diagnoza e një perforimi te një divertikuli, ka dhene infiamacion i cili shtrihet deri ne cekum pa shenja peritoniti. Trajtimi është:

- A) Rezekcion e ileusmit terminal edhe e colonit ashendent me ileostomi
- B) Emikolektomia dekstra
- C) Rezekcion e ileusit terminal dhe e colonit ashendent me anastomoze ileokolike primare ne një kohe
- D) Drenim i absesit edhe apendicektomia
- E) Mbyllja e abdomenit edhe trajtim me antibiotike

33. Te gjitha frazat më poshtëper Sd. Mallory-Weiss janë te sakta, përveç:

- A) Ematemeza mund te verifikohet pa episode te vjellash precedente
- B) Studimi me Baro nga goja është metoda me e mirë per te bërë diagnozen
- C) Ezofagoskopja është e domosdoshme per diagnose
- D) Laceracioni është një i vetem, linear edhe i lokalizuar ne ezofagun distal
- E) Infuzioni intra-arterial i vazopresines controllon hemorragjine

34. Rrjedhjet e enzimave nga nekroza e pankreatitit akut diagnostikohen me:

- A) Radiografia e tubit digerent
- B) Shintigrafia pankretatike
- C) Arteriografia e tripodit celiac
- D) RX abdomen
- E) CT abdomen

35. Kush prej patologjive më poshtë i bashkangjitet hidrotoraksit?

- A) Komprimimi venoz brachio-cefalik
- B) Komprimimi mbi venen azigos
- C) Komprimim nen venen azigos
- D) Komprimimi ne nivel te venes azigos
- E) Varice esofageale

36. Trajtimi imediat i pneumotoraksit ipertensiv jo traumatik konsiston ne:

- A) Torakotomi
- B) Intubim
- C) Terapi me antibiotike
- D) Drenim pleures
- E) Pushim absolute ne krevat

37. Një grua 70 vjeç prezanton një kuader klinik I cili perputhet me obstruksion te zorreve te holla. Pacientja nuk është operuar kurre por vuan prej shumë kohesh nga një kolelitiazë te cilën nuk e ka trajtuar. Cili prej ekzaminimeve më poshtë duhet bërë per te vene diagnozen?

- A) Klizem opak
- B) Arteriografia
- C) Kolangiografia transepatic
- D) Ekografi e katit abdominal superior te djathte
- E) Radiografia abdomenit pa kontrast

38. Te gjitha opzionet më poshtë janë indikacione per laparoskopine ne urgjence, përveç:

- A) Ruptures se kistit te ovarit
- B) Peritonitit te gjeneralizuar me shok septik
- C) Perforimit intestinal
- D) Ileusit mekanik post-aderencial
- E) Kolecistiti akut

39. Një kirurg i pergjithshem viziton një pacient 45 vjeç me gjendje te per gjishme te mirë por me pak gjakderdhje rektale. Gjate rektoskopise vihet re një polip me diameter 2cm, me siperfaqe te lemuar i cili ndodhet 8cm nga margina anale. Biopsia e marre tregon se është një adenoma vilozë. Çfarë do te bez kirurgu?

- A) Duhet te bez ne menyre immediate rezekcion-anastomoze te rektumit anteriorisht
- B) Do te bez një klizem opake
- C) Do te bez një sigmoidoskopi fleksibel
- D) Do e koaguloj lezionin me endoskopi
- E) Do e mbaj pacientin ne vezhgim te vazhdueshem edhe do marri biopsi periodikisht

40. Cila prej frazave më poshtë është e sakte:

- A) Lokalizimi me i shpeshtë i M. Crohn është rektumi
- B) Incidence e karcinomes është me e larte ne M.Crohn sesa ne retokolitin Ulçeroz
- C) Stenozat intestinale janë me pak frekuente M.Crohn sesa ne retokolitin Ulçeroz
- D) Fistulat janë me te shpeshta ne retokolitin Ulçeroz sesa ne M.Crohn
- E) Hemorragjia rektale është me e shpeshtë ne retokolitin Ulçeroz sesa ne M.Crohn

41. Kush janë simptomat me komune ne kancerin e veshikes urinare?

- A) Infeksionet rikorente edhe persistente
- B) Inkontinenca urinare
- C) Disuria
- D) Polakiuria
- E) Hematuria

42. Per hernien kurrale, te gjitha frazat më poshtë janë te sakta përveç:

- A) Është e lokalizuar nen legamentin inguinal
- B) Është me e shpeshtë tek femrat

- C) Ka një incidence te larte per strangulim
- D) Ne te djathte mund te permbaj apendiksin
- E) Është thjështësisht e reduktueshme

43. Ne rast diagnose prenatale te një veshke multicistik, duhet bërë:

- A) Kontroll ekografik te shtatzanise edhe lindje me operacion
- B) Kontroll ekografik te shtatzanise edhe lindje premature me operacion
- C) Kontroll ekografik te shtatzanise edhe induksion per një lindje spontane sa po te kete arritur maturimin pulmoni
- D) Kontroll ekografik te shtatzanise edhe operacion ne muajin e shtate
- E) Kontroll ekografik te shtatzanise edhe lindje spontane

44. Ne rast apendisiti akut një tushe rectal edhe/ose një vizite vaginale e dhimbshme tregon:

- A) Piosalpingit
- B) Fistul reto-vaginale
- C) Peritonit andopelvik
- D) Cistit
- E) Divertikulum Meckel

45. Te gjitha simptomat edhe shenjat poshte te rreshtuara bejne pjese ne kliniken e enteritit segmental ose Morbus Crohn, përveç:

- A) Temperaturë
- B) Kostipacion
- C) Diare ematike
- D) Diare me gjak ne fece
- E) Te vjella

46. Cilin ekzaminim perdorim per te matur presionin endoluminal te ezofagut?

- A) Ezofagoskopia
- B) Phmetria
- C) Sonda gastrike
- D) Manometria
- E) Ezofagografia

47. Shemja e Rousseau (dora e obstetrit) është tipike e kujt prej sëmundjeve më poshtë?

- A) Hipoparatiroidizem
- B) Hiperparatiroidizem
- C) Hipertiroidizem
- D) Hipotiroidizem
- E) Hipogonadizem

48. Një pacient 70 vjeç, i semur me karcinome epidermoide centro-parenkimale te pulmonit ne kondita normale:

- A) Duhet te bej radioterapi
- B) Mund te bej rezeksion te pulmonit
- C) Duhet te bej terapi citostatike edhe kobalt
- D) Duhet te bej cdo terapi përveç asaj kirurgjikale
- E) Duhet te bej cikle imunoterapie

49. Cila prej vlerësimeve te mëposhtme ka prioritet ne pacientin me politraume:

- A) Niveli i koshiences
- B) Frymemarrja
- C) Kontroll i aktivitetit kardiocirkulator
- D) Kontrolli i rrugeve te frymemarrjes
- E) Kontroll i presionit arterioz

50. Ne pneumotoraksin tensiv të gjitha frazat më poshtë janë të pavërteta, përveç:

- A) Ka nevoje per dekomprimim te menjehershem
- B) Shoqerohet me ipertension arterioz
- C) Nuk shoqerohet me ipertension arterioz
- D) Shkaktohet nga versamenti pleurik
- E) Ka nevoje per vendosjen e një sonde nazo-gastrike

51. Karcinoma e gjirit ne T2 është:

- A) Me e madhe se 1 cm, por me e vogel se 2.5 cm
- B) Me e madhe se 2 cm, por me e vogel se 5.1 cm
- C) Me e madhe se 2 cm, por me e vogel se 3.1 cm
- D) Midis 3 edhe 5 cm
- E) Midis 3 edhe 6 cm

52. Te gjitha frazat më poshtë janë shenja te reaksionit gjate një hemotrasfuzioni, përveç:

- A) Hiperkalcemi
- B) Emolize
- C) Ortikarie
- D) Temperaturë
- E) Hipokalcemi

53. Kush nga perjigjet më poshtë është shkaku me frekuent ne ikterin obstruktiv:

- A) Komprimimi ab estrinsek
- B) Lezione iatrogene
- C) Neoplazi e kokes se pankreasit
- D) Neoplazi epatike
- E) Infiamacion e rrugeve biliare

54. Ne çfarë zone ndodh me shpesh kanceri i gjirit:

- A) Mbi areole
- B) Nen areole
- C) Ne kudrantin superior intern
- D) Ne kuadrantin superior ekstern
- E) Ne kuadrantin inferior ekstern

55. Te gjitha manifestimet më poshtë mund të janë komplikacione te divertikulit te Meckelit, përveç:

- A) Introfleksioni edhe invaginacioni
- B) Sekrecion i acidit klorhidrik
- C) Pankreatiti akut hemorragjik
- D) Hemorragjia e perforimi
- E) Obstruksion i zorres se holle

56. Cili prej organeve te mëposhtme demtohet me shpesh ne traumat e mbyllura abdominal:

- A) Hepari
- B) Stomaku
- C) Shpretka
- D) Vezika urinare
- E) Pankreasi

57. Ekzaminimi qe i duhet bërë një pacienti qe dyshohet per karcinome te ezofagut është:

- A) RX me barium
- B) Skanet toraksit
- C) Ezofagoskopja
- D) Skaner i abdomen superior
- E) Studim i motilitetit ezofageal

58. Shenja klinike kryesore e sëmundjes Hashimoto është:

- A) Gusha
- B) Hipertiroidizmi
- C) Keratokonjunktivit i thatë
- D) Artralgjia
- E) Ekzoftalmia

59. Një grua 42 vjeç me hipertiroidizem edhe tumefacion te qafes, diagnoza me e mundshme është:

- A) Tiroiditi Hashimoto
- B) Semundja e Plummer
- C) Semundja e Graves
- D) Carcinoma papilifera
- E) Adenoma folikolare

60. Një arterit Horton jo i trajtuar mund te evoluoj ne:

- A) Emboli pulmonare
- B) Shurdhim koklear
- C) Tromboze e arteries temporale superficial
- D) Humbje e shikimit bilateral permanent
- E) Kriza te forta edhe te përsëritura ten je cefale temporal

61. Një pacient 85 vjeç, vjen ne spital me dhimbje te forta barku te cilat shtrihen ne te gjitha kuadrantet, është i axhituar, ka diarre, temperaturë edhe ndjesi te vjelli. Abdomeni është i butë, pak i dhimbshem, nuk preken masa abdominalë dhe ka peristaltike. Është e qarte prezenca e një mosperputhjeje midis gjendjes klinike te pacientit edhe ekzaminimit te abdomenit. Kemi një leukocitoze 20.000, LDH-GOT-GTP -gamma GT te rritura, acidoze metabolike. Diagnoza është:

- A) Okluzion intestinal
- B) Aneurizem e aortes ne faze rupture
- C) Infarkt intestinal
- D) Pankreatit akut
- E) Kolit inflamator

62. Cili prej organeve më poshtë merret nga një donator kadaver multiorgan per transplant:

- A) Gonadet
- B) Mbiveshkorja
- C) Shpretka

- D) Veshka
- E) Medula spinale

63. Trajtimi i pneumotoraksit ipertensiv është:

- A) Drenim ne aspirim
- B) I jepet vetem oksigjen
- C) Mbahet nen vezhgim
- D) Torakotomia eksplorative
- E) Intubim

64. Vena spermatike dekstra derdhet ne:

- A) Venen renale
- B) Venen kava
- C) Venen iliaca komunis
- D) Venen iliaca eksterne
- E) Venen pudenda interne

65. Ne një pacienti me vështirësi ne gelltitje per shkak te një neoplazie ezofageale, elementi me i rendesishem per ekzaminim e tij është:

- A) Ne nivelin e stenozeve
- B) Ulçerimi i lezionit
- C) Kohezgjatja e vështirësise ne gelltitje
- D) Ezofagografia
- E) Ezofagoskopia me biopsi

66. Një pacient me retorragji diskrete mbas daljes jashte, me defekim te veshtire edhe te dhimbshem e tenezem rektal. Cili prej ekzaminimeve te mëposhtme është i keshillueshem ne kete rast?

- A) Analize kimike edhe parasitologjike te feceve
- B) Pankolonoskopi
- C) Klizem opak me dubel kontrast
- D) Një tushe rektale digitale dhe një ano-retoskopi
- E) Gjak okult ne fece

67. Ne megakolonin toksik duhet:

- A) Një nderhyrje urgjente mbas stabilizimit te ekuilibrit elektroliteve
- B) Një nderhyrje imediate
- C) Vetem stabilizimi i ekuilibrit elektrolitit
- D) Trajtimi me kemioterapi edhe elektrolite
- E) Te stabilizojme gjendjen e pacientit perpara operimit

68. Cili prej tumoreve te traktit intestinal më poshtë është me i shpeshti ne moshat e reja?

- A) Neuroblastoma
- B) Karcinoidi
- C) Carcinoma e kolonit
- D) Linfo-sarkoma
- E) Rabdomiosarkoma

69. Kush zone e zorres perforohet me shpesh per shkak te stenozeve te sigmes?

- A) Ne colonin desendent

- B) Ne fleksuren lienale
- C) Ne kolon transvers
- D) Ne sigma
- E) Ne cekum

70. Dimensionet e një karcinome te gjirit ne T2 janë:

- A) >1 cm, por <2.5
- B) >2 cm, por <3.1
- C) Midis 3 dhe 6 cm
- D) Midis 3 dhe 5 cm
- E) >2 cm, por <5.1

71. Një pacient 60 vjeç me dhimbje barku te menjehershme ne fosa iliakre siniste, temperaturë, leukocitoze, kontraktim i abdomenit ne zonen iniciale te dhimbjes si edhe arrest te zorreve.

Diagnoza është:

- A) Apendosit akut
- B) Kolecistit akut
- C) Tumor i cekumit
- D) Perforacion i divertikulit ne sigem
- E) Kolik renale siniste

72. Kush është trajtimi i "zgjedhur" per polipozen intestinale familiare?

- A) Mbajtja ne vezhgim te vazhdueshem te pacientit
- B) Rezekcion segmentar e pjeses se zorres se interesuar
- C) Bypass intestinal
- D) Kolektomia totale
- E) Kolonoskopi periodike

73. Trajtimi i "zgjedhur" i fibroadenomes se gjirit është:

- A) Kuadrantektomia
- B) Heqja e tumorit
- C) Mastektomia totale
- D) Mastektomia
- E) Radioterapia

- C) Ne çdo dhimbje te pa kontrollueshmë mirë me FANS apo opioide minore
- D) Vetem ne dhimbjet kronike
- E) Vetem ne dhimbjen e paperballueshme

267. Neuropatia diabetike sjell zakonisht:

- A) Një dhimbje somatike
- B) Një dhimbje viscerale
- C) Një dhimbje homeopatike
- D) Një dhimbje neuropatie
- E) Një dhimbje adiabatike

268. Fluksi hematik cerebral i shtuar ndjeshem jep:

- A) Rritje te presionit arterial mesatar
- B) Aktivitet cerebral
- C) Hipoksi
- D) Adrenaline
- E) Hiperkapni

269. Një "volet" brinjor është me i shpeshtë ne traumat e:

- A) Kembesoreve
- B) Skiatoreve
- C) Çiklisteve
- D) Motoçiklisteve
- E) Shofereve

270. Cili është saturimi normal i O₂ ne gjekun venoz te arteries pulmonare:

- A) 92%
- B) 30%
- C) 60%
- D) 75%
- E) 45%

271. Ne një pacient ne koma dhe ne pozicion supin, okluzioni i rrugeve te frymemarrjes mund te kontrollohet duke:

- A) Flektuar koken me 30 °
- B) Ngritur koken 5 cm mbi trungun
- C) Ekstenduar koken ndaj qafes
- D) Vendosur pacientin ndenjur
- E) Ngritur koken 10 cm mbi trungun

272. Solucioni fiziologjik (nacl ne uje) ka një osmolaritet rreth:

- A) 300 mosm/l
- B) 175 mosm/l
- C) 250 mosm/l
- D) 145 mosm/l
- E) 400 mosm/l

273. Një pacient 70 vjeç, ne diten e trete post operatore laparotomike, shfaq insuficiencë respiratore me një kuader te qarte te atelektazise pulmonare. Cili nga te meposhtmit është trajtimi i zgjedhur per te zgjidhur situaten?

- A) Aerosolterapia
- B) Bronkoskopi dhe tualet bronkial
- C) Fizioterapi respiratore
- D) Antibiotikoterapi masive

E) Nderhyrje e dyte laparotomike

274. Ne rast fibrilacioni ventrikular, defibrilimi elektrik duhet bërë:

- A) Pas një tentative defibrilimi farmakologjik me prokainomid
- B) Pas një tentative defibrilimi farmakologjik me lidokaine
- C) Pasi te kemi vendosur nej rruge venoze
- D) Pasi te kemi intubuar pacientin
- E) Menjehere

275. Ne fazen e refraktaritetit absolut zemra është:

- A) E eksituveshme
- B) Pjeserisht e eksituveshme
- C) Ne diastole
- D) E pa eksituveshme
- E) Ne sistole

276. Cili nga pohimet e mëposhtme njihet se fundmi si perkufizimi i dhimbjes?

- A) Dhimbja është një eksperience objektive
- B) Njdjenjë e identifikuveshme kollaj nga operatoret shendetesore
- C) Gjithçka qe pacienti referon si dhimbje
- D) Ndjenjë ne një apo me shumë pjese te trupit qe percakton një eksperience te pakendeshme
- E) Ndjenjë qe shoqeron një demtim indor

277. Nese një arrest kardiak ka ndodhur ne uje, kapaciteti i trurit per te rezistuar mungeses se oksigjenit:

- A) Varet nga perqendrimi i kripes
- B) Rritet
- C) Ulet
- D) Nuk ndryshon
- E) Varet nga temperatura e ujit

278. Ne diabetin insipid janë tipike:

- A) Oliguria, hipernatremia, hiperosmolariteti plazmatik, hiperosmolariteti urinar
- B) Poliuria, hipernatremia, hiperosmolariteti plazmatik, hipoosmolariteti urinar
- C) Poliuria, hiponatremia, hipoosmolariteti plazmatik, hipoosmolariteti urinar
- D) Poliuria, hipernatremia, hipoosmolariteti plazmatik, hiperosmolariteti urinar
- E) Poliuria, hiponatremia, hiperosmolariteti plazmatik, hiperosmolariteti urinar

279. Një hipokaliemi shoqerohet me:

- A) Rritje te peristaltikes intestinale
- B) Subnivelim te segmentit ST
- C) Rritje te diapazonit te vales T
- D) Nauze
- E) Acidoze

280. Cili nga pohimet e mëposhtme mbi lengun cerebro spinal është i gabuar?

- A) Pesha e tij specifike duhet te jete mes 1010 e 1020
- B) Formose me një shpejtesi prej rreth 450 ml/dite
- C) Vellimi total është 10 - 150 ml
- D) Është një leng i qarte pa ngjyre

E) Ndodhet ne ventrikujt cerebrale

281. Nepermjet cilit mekanizem FANS et ulin dhimbjen?

- A) Aktivizim te receptoreve te endorfines
- B) Bllokim te fosfolipazes
- C) Bllokim te ciklooksigjenazes
- D) Bllokim te receptoreve kolinergjike pre sinaptike
- E) Rritje te prodhimit te leukotrieneve

282. Alkaloza metabolike mund te linde nga:

- A) Diabeti mielit i dekompensuar
- B) Fistul pankreatike
- C) Gjendje shocku
- D) Hipertiroidizem
- E) Te vjella te pakontrollueshme

283. Cili nga pohimet e mëposhtme mbi dikumaroliket nuk është i sakte?

- A) Veprimi kundershtohet me vitamine C ne doza te larta
- B) Janë antagonize te vitamines K
- C) Veprimi zgjat per disa dite pas dozes se fundit
- D) Inhibojne sintezën hepatike te faktorit vii
- E) Inhibojne sintezën e protei nave c dhe s

284. Sa oksigjen permban zakonisht ajri i ekspiruar

- A) Rreth 16%
- B) Rreth 10%
- C) Rreth 5%
- D) Rreth 25%
- E) Rreth 35%

285. Barbituriket ne sistemin nervor:

- A) Normalizojne konsumin e O₂
- B) Rritin konsumin e O₂
- C) Ulin konsumin e O₂
- D) Induktojne hipokapni
- E) Lene te pandryshuar konsumin e O₂

286. Cili nga këto diuretike kurson kaliumin?

- A) Klorotiazidi
- B) Acetazolamidi
- C) Furosemidi
- D) Spironolaktoni
- E) Acidi ektarinik

287. Një pneumotoraks hipertensiv dekomprimohet me një vigon te futur ne:

- A) Hapesira 5° interkostale ne hemiklaveare
- B) Ligamenti interkrikotiroidien
- C) Hapesira 5° interkostale ne aksilaren media
- D) Hapesira 2° -3° interkostale ne aksilaren media
- E) Hapesira 2° - 3° interkostale ne hemiklaveare

288. Një pH arterial $> 7,6$ me PaCO₂ > 45 tregon per:

- A) Alkaloze metabolike
- B) Acidoze respiratore
- C) Acidoze metabolike
- D) Alkaloze respiratore
- E) Alkaloze mikse

289. Takikardia parosistike me bllok ne AV 2:1 është tipike ne mbidozen e:

- A) Lidokaines
- B) Verapamilit
- C) Digitales
- D) Diltiazemit
- E) Adenozines

290. Çfare është kapaciteti funksional rezidual pulmonar?

- A) Vellimi korrent + vellimi rezidual
- B) Vellimi i rezerves inspiratore + vellimi rezidual
- C) Kapaciteti vital + vellimi rezidual
- D) Kapaciteti inspirator + vellimi rezidual
- E) Vellimi i rezerves respiratore + vellimi rezidual

291. Cili nga trajtimet e mëposhtme nuk është i pershtatshem ne hiperkaliemi?

- A) Perfuzion i ngadalte me CaCl₂
- B) Perfuzion glukoze dhe insuline
- C) Perfuzion albumine
- D) Perfuzion i rezinave me shkembim jonik
- E) Alkalinizim

292. Ne alkaloze respiratore PaCO₂:

- A) Rritet
- B) Nuk ndryshon
- C) Ulet
- D) Ka levizje te ndryshueshme
- E) Nuk vleresohet dot

293. Suksinilkolina metabolizohet nga:

- A) Kolinesterazat e verteta
- B) Hidroliza alkaline
- C) Katalaza
- D) M.A.O.
- E) Pseudokolinesteraza

294. Cili nga shenjat e mëposhtme mungon ne rast intoksikacioni me monoksid karboni

- A) Krize stenokardike
- B) Cefale
- C) Nauze dhe te vjella
- D) Cianoze
- E) Konvulsione

295. Ne shockun periferik, konstatimi i një rritjeje te shpejte te presionit venoz central tregon:

- A) Rikthim te ekuilibrit hemodinamik
- B) Insuficience kardiake kongjestive
- C) Hapjen e shunteve arterio venoze
- D) Rritje te gjitates kardiake
- E) Venokonstriksion

296. Me një masazh kardiak te jashtem te kryer mirë arrihen vlera te fluksit coronar rreth:

- A) 5% te normes
- B) 75% te normes
- C) 50 % te normes
- D) 30% te normes
- E) 100% te normes

297. Cilën karakteristike duhet te kete opiat ideal?

- A) Prani te shumë metaboliteve active
- B) Interference metabolike me ilace te tjera
- C) Thjeshtësi titrimi
- D) Akumulim te madh ne indet adipoze
- E) Veprim te shkurter

298. Injektimi intrakardiak i adrenalines:

- A) Është një procedure e rrezikshme qe duhet bërë vetem ne raste te jashtezakonshme
- B) Duhet bërë bashke me bikarbonat natriumi
- C) Duhet bërë vetem ne rruge parasternale
- D) Ka indikacion ne paciente me hipotermi
- E) Është menyra me e mirë per te rivendosur qarkullimin ne një arrest kardiak

299. Me një masazh kardiak te jashtem te kryer mirë arrihen vlera te gjitates kardiake rreth:

- A) 25% te normes
- B) 75% te normes
- C) 50% te normes
- D) 100% te normes
- E) 10% te normes

300. Ne kushte shocku septik hiperdinamik, reduktimi i menjehershëm i gjitates kardiake i shoqëruar me reduktim te presionit venoz central tregon per:

- A) Mbingarkese te mikroqarkullimit
- B) Hapje te shunteve arterio venoze
- C) Shock hipodinamik si pasoje e reduktimit te mases qarkulluese
- D) Paralize te arteriolave
- E) Insuficience kontraktive te miokardit

301. Vasodilatatori me i fuqishem cerebral është:

- A) Tiopentali
- B) Diazepam
- C) Hiperkapnia
- D) Droperidoli
- E) Hipokapnia

302. Me një masazh kardiak te jashtem te realizuar mirë kemi fluks cerebral rreth:

- A) 20% te normes
- B) 75% te normes
- C) 50% te normes
- D) 100% te normes
- E) 5% te normes

303. Një masazh kardiak i jashtem nevojitet kur:

- A) Pacienti nuk merr fryme
- B) Pacienti pakoshience dhe paraqet njolla cianotike ne ekstremite
- C) Pacienti është midriatik, cianotik dhe pulsi central mungon
- D) Pulsi radial është zhdukur
- E) Pulsi femoral është zhdukur

304. Cili nga pohimet mbi barrieren hemato encefalike është i sakte:

- A) Është lirisht e pershkueshme nga jonet inorganike
- B) Është relativisht e pershkueshme nga gazet
- C) Është lirisht e pershkueshme nga uji
- D) Është lirisht e pershkueshme nga jonet bikarbonat
- E) Është lirisht e pershkueshme nga jonet e natriumit

305. Frakturna e bazes se kafkes shfaqet me:

- A) Otorre dhe/ose otorragji
- B) Emfizeme sub kutane oksipitale
- C) Akufene e skotoma
- D) Ekimoze difuze te qafes dhe te rajonit supraklavear
- E) Hemorragji retinale

306. Ne një te rritur te shëndetshëm ne qetesë hedhja kardiake (litra / minute) është rreth:

- A) 1,2
- B) 2,9
- C) 8
- D) 5
- E) 12

307. Cardioversioni elektrik i sinkronizuar ka indikacion ne:

- A) Ne flatter atrial
- B) Fibrilacion elektrik
- C) Bllok a-v ii^o te tipit mobitz ii
- D) Takikardi ventrikulare pa puls
- E) Ne disocimin elekromekanik

308. Sapo te diagnostikojme një takikardi ventrikulare pa puls:

- A) Bejme masazh te sinusit karotid
- B) Sillemi si ne një fibrilacion ventrikular
- C) I injektojme pacientit 10 mg/kg i.v. Ne bolus
- D) Vendosim një kanjule ne një vene te madhe
- E) I injektojme pazienti lidokaine 1,5 mg/kg i.v. Ne bolus

309. Pangopshmeria receptoriale e një ilaçi është:

- A) Kapaciteti i ilaçit per tu lidhur me receptorin e tij
- B) Ne proporcione zhdrojte me efektin e ilaçit
- C) Shpejtesia me te cilën lidhet ilaçi me receptorin e tij
- D) "onset" i i shpejte i veprimit
- E) Vështirësia e ilaçit per tu ndare nga receptori i tij

310. Hipoksia nga cianuri ndodh nga:

- A) Hipoventilimi central
- B) Interferimi ne transportin e O₂
- C) Inibimi i zinxhirit respirator mitokondrial
- D) Ngadalesimi i fluksit kapilar
- E) Atelektazi pulmonare difuze

311. Cianoza shfaqet kur:

- A) Hemoglobinemia < 10 g/dl
- B) CoHb > 5 g/dl
- C) Hemoglobinemia < 7 g/dl
- D) PaO₂ = 70 mm hg
- E) Hb e reduktuar > 5 g/dl

312. Cila nga pohimet e mëposhtme nuk është e sakte ne lidhje me angina pectoris:

- A) Angina stabile induktohet nga ushtrimi fizik dhe ndalon ne pushim
- B) Angina stabel është prezente vazhdimesht me një dhimbje konstante
- C) Angina insta bel shfaqet dhe ne pushim
- D) Angina insta bel është me e vestire ne trajtim se sa ajo stabel
- E) Iskemia miokardiale është ne shumicen e rasteve asimptomatike

313. Ne cilat raste lidokaina përdoret si ilaçi i zgjedhur?

- A) Takikardi supraventrikulare parosistike me hipotension grav
- B) Flatter atrial
- C) Takikardi ventrikulare me torsion te majes
- D) Bllok A-V te grades III
- E) Takikardi ventrikulare me prani pulsi

314. Një pH arterial < 7,3 ma PaCO₂ < 35 flet per:

- A) Alkaloze mikse
- B) Acidoze respiratore
- C) Alkaloze metabolike
- D) Alkaloze respiratore
- E) Acidoze metabolike

315. Cilin nga shenjat apo simptomat e mëposhtme nuk e gjejme ne intokacionin nga morfina?

- A) Bradipne
- B) Hiperpireksi
- C) Oliguri
- D) Pupilla si koke gjilpere
- E) Flaciditet muskular

316. Presioni onkotik plazmatik është:

- A) 5 cm H₂O
- B) 5 mm Hg
- C) 10 cm H₂O
- D) 25 mm Hg
- E) 25 cm H₂O

317. Kapaciteti funksional rezidual ne një subjekt normal 70 kg është rreth:

- A) 1 liter
- B) 1,5 liter
- C) 2,5 liter
- D) 2 liter
- E) 3,5 liter

318. Ne një lindje normale vaginale jo te komplikuar, humbja hematike është rreth:

- A) 500 ml
- B) 250 ml
- C) 750 ml
- D) 1000 ml
- E) 1250 ml

319. Ne kushte normale zgjatje e intervalit P-Q ne EKG e një te rrituri është:

- A) 0,24 - 0,30 sekonda
- B) 0,18 - 0,24 sekonda
- C) 0,06 - 0,08 sekonda
- D) 0,10 - 0,12 sekonda
- E) 0,12 - 0,20 sekonda

320. Hipoventilimi i shoqëruar me deprimim te qendres se frysma marrjes shkakton:

- A) Hipoksi dhe hiperkapni
- B) Hipoksi dhe hipokapni
- C) PO₂ normale dhe hiperkapni
- D) Reduktim te saturimit te hemoglobines
- E) Rritje te baze eksesit

321. Cili nga te me poshtmit është një pohim i sakte lidhur me FANS at:

- A) Aspirina inhibon agregimin trombocitar pasi inhibon ciklooksigenazen
- B) Inhibojne agregimin trombocitar pasi ulin nivelet plazmatike te Ca ++
- C) Rikthimi i një funksioni trombocitar normal kerkon te pakten 3 javë nga ndalimi i marjes se aspirines
- D) Doza antiagreguese e aspirines është 20 mg/kg ne dite
- E) Te gjithe FANS at inhibojne potencialisht agregimin trombocitar

322. Ne venat central presioni është zakonisht:

- A) Gjithmone pozitiv
- B) Pozitiv por mund te behet negativ gjate ekspirimit
- C) Gjithmone negativ
- D) Pozitiv por mund te behet negativ gjate inspirimit
- E) Gjithmone poshte atmosferes

323. Me arrest kardiak kuptojme:

- A) Zhdukjen e pulseve arteriale periferike
- B) Pushimin e aktivitetit mekanik te trurit
- C) Fibrilacionin ventricular
- D) Pushimin e aktivitetit mekanik te zemres
- E) Disocimin elektromekanik

324. Dega interventrikulare posteriore del nga:

- A) Koronarja e majte
- B) Dega interventrikulare posteriore
- C) Arteria cirkumflekse
- D) Koronarja e djathte
- E) Direkt nga aorta ascendente

325. Arsyja me e shpeshtë e sindromes kavale superiore mund te jetë:

- A) Karcinoma folikulare e tiroides
- B) Tumori i timusit
- C) Neoplazia e lobit superior te djathte pulmonar
- D) Fibroza mediastinike
- E) Struma e zhytur

326. Cila nga te mëposhtmet nuk është komponent i tetralogjise Fallot?

- A) Hipertrofia e ventrikulit te djathte
- B) Difekti i septumit interventrikular
- C) Dekstro pozimi i aortes
- D) Hipertrofia ventrikulare e majte
- E) Stenoza infundibolare e arteries pulmonare

327. Ne një leter dalje nga spitali te një pacienti te operuar me by-pass aorto koronar, termi "on-pump" do te thote:

- A) Pacient i operuar me zemer qe rrihte
- B) Operacion gjate te cilit u nevojit perdorimi i qarkullimit ekstra korporal
- C) Pacienti nuk ruante funksion te pompes ne fund te operacionit
- D) Qe gjate operacionit u be i nevojshem perdorimi i një kontra pulsatori aortal
- E) Nevoje gjate operacionit per te perdorur ventilim pulmonar me pompe te jashtme

328. Cila nga strukturat e mëposhtme, normalisht nuk është e vaskularizuar nga arteria koronare e djathte apo dege te saj?

- A) Atriumi i djathte
- B) Bordi i theksuar i i ventrikulit te djathte
- C) Pjesa posteriore e ventrikulit te majte
- D) Pjesa posteriore e septumit interventrikular
- E) Pjesa anteriore e septumit interventrikular

329. Per cilat vlera te zones dhe te ndryshimeve te presionit mesatar trans valvular (delta p) vendoset indikacion per trajtim kirurgjik te stenozes se valvole aortale?

- A) Zone < 0,5cm dhe delta P > 50 mmHg
- B) Zone < 1,5cm dhe delta P > 30 mmHg
- C) Zone < 2cm dhe delta P > 30 mmHg
- D) Zone < 1cm dhe delta P > 50 mmHg
- E) Zone < 2,5cm dhe delta P > 25 mmHg

330. Cili nga te me poshtmit nuk është një komplikacion i mundshem i zevendesimit te një valvule aortale

- A) Shfaqja e një blloku dege te majte
- B) Demtim i ostiumeve koronare
- C) Shfaqje e një blloku dege te djathte
- D) Endokardit infektiv
- E) Demtim i lembos anteriore mitrale

331. Sipas protokolleve, cila nga te mëposhtmet nuk është një indikacion per trajtim kirurgjik per sëmundje te valvules aortale.

- A) Ne parandalimin e vdekjes se papritur ne paciente asimptomatike me stenoze aortale grave
- B) Paciente me stenoze grave asimptomatike qe duhet te bejne by pass aorto coronar
- C) Paciente me stenoze grave qe duhet te bejne nderhyrje kirurgjike ne aorte apo ne valvula te tjera
- D) Paciente simptomatike me stenoze grave
- E) Ne paciente me stenoze te lehte por ku verehet një progresion i shpejte i sëmundjes

332. Pas implantimit te një valvule biologjike, terapi nga goja me warfarin:

- A) Nuk ka indikacion
- B) Ka indikacion dhe duhet te vazhdoje gjithe jeten
- C) Duhet marre per tre muaj
- D) Duhet marre per një muaj
- E) Duhet marre per 1 vit

333. Ulçerat diabetike janë kryesisht:

- A) Plantare
- B) Pre maleolare
- C) Dorsale te kembes
- D) Pretibiale
- E) Popliteale

334. Mes shkaqeve te dhimbjes ekstra abdominale qe ngjasojne me abdomenin akut cila është jo e sakte?

- A) Infarkti i miokardit
- B) Embolia pulmonare
- C) Perikarditi
- D) Pulmoniti
- E) Bronkiti azmatik

335. Leukocituria është patognomonike me:

- A) Neoplazi vezikale
- B) Kalkuloze urinare
- C) Trauma te rrugeve urinare
- D) Veshke patkua
- E) Infeksion urinar

336. Tipi me i shpeshtë i kalkulave urinare është:

- A) Urate
- B) Fosfate-magnezium

- C) Cistina
- D) Oksalate kalciumi
- E) Xantina

337. Flebedema ne fazat e saj fillestare karakterizohet nga:

- A) Edeme premaleolare e bute
- B) Edeme premaleolare e forte
- C) Inflamacion kronik premaleolar
- D) Diskromi premaleolare
- E) Ulçera kutane

338. Vena safena e vogel derdhet ne:

- A) Venen safena e madhe
- B) Venen femorale
- C) Vene iliake interne
- D) Venen poplitea
- E) Venen iliake eksterne

339. Çfare është një cistoskop?

- A) Instrument per te pare prostaten
- B) Instrument per te pare uterusin
- C) Instrument per te pare ureterin
- D) Instrument per te pare fshikezen e urines
- E) Instrument per te pare veshken

340. Ne aneurizmen e aortes abdominale cili nga pohimet e mëposhtme është i sakte?

- A) Vendosja me e shpeshtë e aneurizmes është ne 90 % te rasteve poshte arterieve renale
- B) Vendosja me e shpeshtë e aneurizmes është ne 90% te rasteve mbi arteriet renale.
- C) Ne paziente me rupture te aneurizmes reziku i vedekjes para se te mberrijne ne spital është 70 - 80 %
- D) Bakteret janë përgjegjës per rreth 50 % te aneurizmave
- E) Vdekshmeria ne pazientet qe i nenshtrohen nderhyrjes se menjehershme riparuese është 80 - 90 %.

341. Vena safena e madhe e ka origine:

- A) Posteriorisht maleolit intern
- B) Anteriorisht maleolit lateral
- C) Anteriorisht maleolit intern
- D) Posteriorisht maleolit lateral
- E) Ne nivelin e perforueses se hunter it.

342. Neoplazia me e shpeshtë e fshikezes se urines është:

- A) Karcinoma me qeliza te tranzicionit
- B) Adenocarcinoma
- C) Sarkoma
- D) Limfoma
- E) Lejomiosarkoma

343. Arsyja me e shpeshtë e një versamenti pleural hemorragjik është:

- A) Tuberkulozi

- B) Pulmoniti
- C) Neoplazia
- D) Mikoza
- E) Azma

344. Cili prej ekzaminimeve diagnostike ndihmon më shumë se të tjerët në vendosjen e diagnozës së kancerit gastrik:

- A) Rx i aparatit tretës
- B) Ezofagogastroskopi me biopsi
- C) TAC
- D) Ekzaminimi citologjik i lëngut gastrik
- E) Echografia

345. Ndërhyrja kirurgjikale, ku lidhet vena spermatike është e sugjeruar në terapinë e:

- A) Sëmundja e La Peyronie (Induratio penis plastica)
- B) Torsioni i funikulit
- C) Varikocele
- D) Criptorchidisis
- E) Hydrocela komunikuese

346. Cila prej këtyre manovrave shkakton dhimbje, kur kemi të bëjmë me kolecistit?

- A) Murphy
- B) Blumberg
- C) Giordano
- D) Mc Burney
- E) Të gjitha përgjigjet

347. Trajtimi i menjëhershëm i pneumotaraksit hipertensiv jo traumatik bazohet në:

- A) Torakotomi
- B) Intubim
- C) Drenimin pleural
- D) Terapi me antibiotikë
- E) Regjim shtrati absolut

348. Cilat janë simptomat më të zakonshme të kancerit të vezikës urinare?

- A) Infeksionet urinare periodike e të vazhdueshme
- B) Inkontinençë urinare
- C) Hematuri
- D) Polakiuri
- E) Dizuri

349. Cili prej vlerësimeve të mëposhtëm është parësor, kur kemi të bëjmë me një pacient të politraumatizuar?

- A) Kontrolli i gjëndjes së ndërgjegjes
- B) Kontrolli i fryshtëzimit
- C) Kontrolli i lirshmërisë së rrugëve ajrore
- D) Kontrolli i aktivitetit kardiocirculator
- E) Kontrolli i presionit arterial

350. Konsiderohet si indikacion për transplant hepari tek të rriturit:

- A) Hepatosteatoza akute e shtatzanisë
- B) Cirroza biliare primitive
- C) Cholangiti sklerozant
- D) Të gjitha përgjigjet
- E) Asnjëra prej përgjigjeve

351. Cili është shkaku më i shpeshtë i ikterit obstruktiv:

- A) Shtypjet e jashtme
- B) Lezionet jatrogjene
- C) Kanceri hepatik
- D) Kanceri i kokës së pankreasit
- E) Inflamacion i rrugëve biliare extrahepatike

352. Cili prej organeve preket më shpesh në traumat e mbyllura të abdomenit?

- A) Hepari
- B) Lieni (shpretka)
- C) Stomaku
- D) Vezika urinare
- E) Pankreasi

353. Në një pacient me obstruksion neoplazik të koledokut, kolecista është:

- A) asnjë herë e tendosur
- B) rrallë herë e tendosur
- C) shpesh herë e tendosur
- D) nuk është e palpueshme asnjë herë
- E) e përjashtuar

354. Trajtimi i pneumotoraksit hipertensiv është:

- A) Torakotomia eksploruese
- B) Dhënia e oksigjenit
- C) Pritje
- D) Drenimi në aspirim
- E) Intubimi

355. Cili prej tumorëve malinj të traktit intestinal është më i shpeshti te moshat e reja?

- A) Limfosarkoma
- B) Carcinoidi
- C) Carcinoma e kolonit
- D) Neuroblatoma
- E) Rabdomiosarkoma

356. Metastazat e kancerit të prostatës prekin më shpesh:

- A) Kockat e baçinit dhe vertebrat e fundit lumbare
- B) Heparin
- C) Trurin
- D) Pulmonet
- E) Në asnjë prej këtyre organeve

357. Pankreatiti akut shpesh herë shoqërohet me:

- A) Ezofagit nga refluksi

- B) Colelitiazë
- C) Diverticulit
- D) Ulçera gastrike
- E) Colangiti sklerozant

358. Cila prej shenjave është më e shpeshta në kancerin e vezikës urinare?

- A) Cistopieliti i përsëritur
- B) Mbajtja akute e urinës (ritension)
- C) Hematuri
- D) Polakiuri
- E) Stranguri

359. Një mashkull 72 vjeç shfaq dhimbje të forta të shpinës, një masë abdominale pulsuese dhe hipotension. Për cilën prej diagozave mund të dyshojmë:

- A) Infarkt intestinal
- B) Aneurizëm disekante të aortës
- C) Rupturë (çarje) ose fisuracion të aneurizmës së aortës abdominale
- D) Sindroma e Leriche
- E) Aneurizëm e arteries hepatike

360. Për diagnozën e apendisitit akut është më e rëndësishmja:

- A) Echografja abdominale
- B) TC
- C) Rtg e traktit tretës me vlerësim të zorrës së hollë
- D) Clisma opake
- E) Anamneza dhe ekzaminimi objektiv

361. Trajtimi i duhur kirurgjikal për neoplazinë e kolonit ashendent është:

- A) Hemikolektomia e djathtë
- B) Hemikolektomia e majtë
- C) Rezekzioni ileus- ciecal
- D) Rezekzioni segmentar
- E) Kolektomia subtotalë

362. Angina abdominale shkaktohet nga:

- A) Neoplazi të kolonit
- B) Hemorragji intestinale
- C) Divertikulit
- D) Iskemia kronike intestinale
- E) Ulçera peptike post- anastomozës

363. Torakotomia urgjente është e indikuar tek:

- A) Kontuzioni (shembja) pulmonare
- B) Versamenti pleural bilateral
- C) Hemotoraksi i furnizuar
- D) Pneumotoraksi si valvul
- E) Empiema

364. Janë komplikanca të kolecistitit, përvëç:

- A) Pankreatiti

- B) Peritoniti
- C) Fistula biliare
- D) Perforimi
- E) Tromboflebiti migrues

365. Cilin prej ekzaminimeve do t'i bëje një pacienti që ka paraqitur hematemesis?

- A) Bronkoskopi
- B) Rtg të traktit tretës
- C) Ezofago-gastro-duodeno-skopi
- D) Rtg direkt të abdomenit
- E) Clisma opake

366. Tiroidektomia totale është ndërhyrja e përshtatshme në:

- A) Struma multinodulare
- B) Ca midular
- C) Ca folikular
- D) Asnjëra prej këtyre patologjive
- E) Të gjitha patologjitet e përmendura

367. Cilin ekzaminim strumental zgjedh, nëse dyshon për litiazë të kolecistës?

- A) Rtg të rrugëve të para të traktit tretës
- B) Manometri duodenale
- C) Echografi hepato-biliare
- D) Kolecistografi
- E) Rtg direkt të abdomenit

368. Trajtimi parësor i embolisë pulmonare është:

- A) Lidhje të venës kava inferiore
- B) Trombektomi
- C) Embolektomi pulmonare
- D) Antikoagulantë e fibrinolitikë
- E) Antibiotikë

369. Cilët segmentë intestinalë mund të prekë sëmundja e Crohn:

- A) Ileusin
- B) Kolonin
- C) Ezofagun
- D) Stomakun
- E) Te gjithë traktin tretës

370. Cili është trajtimi i pneumotoraksit hipertensiv?

- A) Ndërhyrja kirurgjikale me urgjencë
- B) Aspirimi
- C) Aspirimi dhe drenimi
- D) Plumbimi ekstrapleural
- E) Asnjëra prej përgjigjeve

371. Shoku anafilaktik karakterizohet nga:

- A) Hipotension, bradikardi, Presion venoz central (PVC) të reduktuar
- B) Hipotension, takikardi, Presion venoz central (PVC) të rritur

- C) Hipotension, takikardi, Presion venoz central (PVC) të reduktuar
- D) Hipotension, bradikardi, Presion venoz central (PVC) të rritur
- E) Hipotension, bradikardi, oligoanuri

372. Me dizuri kuptohet:

- A) Vështirësi gjatë urinimit
- B) Dhimbjë gjatë urinimit
- C) Rritje të numrit të herëve të urinimit
- D) Prania e leukociteve në urinë
- E) Prania e pusit në urinë

373. Histologjikisht tumoret e prostatës janë:

- A) Carcinoma me qeliza tranzitore
- B) Adenocarcinoma
- C) Carcinoma skuamoqelizore
- D) Leiomiosarkoma
- E) Limfoma

374. Prerja në linjën mediane ombelikale-pubike, nën shtresat e lekurës dhe nënlëkurës përfshin:

- A) Pjesën e brendshme të muskujve abdominalë rektis
- B) Linjën alba
- C) Fashën e muskujve abdominalë rektis
- D) Muskuli rekti, oblik të madh e të vogël
- E) Muskuli i madh e i vogël oblik dhe trasvers

375. Cilët janë receptorët që përfshihen më shumë në hiperplazinë e prostatës:

- A) Alfa 1-adrenergjikë
- B) Beta 2- adrenergjikë
- C) Serotoninergjikë
- D) Kolinergjikët
- E) Dopaminergjikët

376. Cila prej këtyre gjendjeve nuk i shoqërohet nefrolitiazës dhe hiperkalciurisë?

- A) Hiperkalciuria idiopatike
- B) Hipoparatiroidizmi
- C) Vitamina D me tepricë
- D) Sarkoidzoza
- E) Sëmundja e Paget

377. Echografia renale dhe pielografia endovenoze e kryer tek një mashkull 65 vjeç, që u vlerësua për inkontinencën urinare, rezultoi me hidronefrozë bilaterale. Cila prej gjendjeve të mëposhtme është më e mundshmja për të shkaktuar këtë komplikim?

- A) Sëmundja e Alzheimer
- B) Ndërhyrje kirurgjikale paraprake
- C) Inkontinencë nga stresi
- D) Hiperplazi e prostatës
- E) Rritje e aktivitetit të muskulit detruzor në varësi të moshës

378. Cila prej gjendjeve të mëposhtme mund të jetë komplikancë e hipertrofisë beninje të prostatës:

- A) Kalkuj në vezikën urinare
- B) Ritacioni akut urinar
- C) Divertikuloza e vezikës urinare
- D) Të gjitha përgjigjet
- E) Stranguri

379. Çfarë është devijimi urinar:

- A) Vendosja në menyrë definitive e ureterëve në lëkurë
- B) Ndërhyrja e kryer për të korriguar kapacitetin e humbur të vezikës urinare
- C) Anastomoza kirurgjikale uretero-uretrale
- D) Drenimi i vezikës nëpërmjet kateterit
- E) Modifikimi kirurgjikal i rrugëve normale të urinës në menyrë të përkohshme ose definitive

380. Konsiderohet bakteriuri, nëse numri i mikrorganizmave për ml urine është:

- A) më e madhe se 100.000
- B) më e vogël se 50.000
- C) midis 10.000 dhe 50.000
- D) midis 5.000 dhe 10.000
- E) 1.000

381. Spermatorrea është:

- A) Lëshimi i likidit seminal pa ereksion
- B) Lëshimi i likidit seminal i përzier me gjak
- C) Lëshimi i likidit seminal i përzier me pus
- D) Lëshimi i likidit seminal me ereksion
- E) Asnjëra nga përgjigjet

382. Hidronefrozë do të thotë:

- A) Përthithje të urinës nga tubujt kolektorë
- B) Prania e urinës purulente në kavitetin ampulo-kalicien të zgjeruar
- C) Stazë urinare, me rrjedhojë zgjerim të kavitetit ampulo-kaliciene
- D) Stazë urinare vetëm në vezikën urinare
- E) Dëmtim i përgjithshëm i parenkimës renale dhe rrugëve eskretore

383. Carcinoma e prostatës jep metastaza më shpesh në:

- A) Skelet
- B) Gjëndra mbiveshkore
- C) Hepar
- D) Pulmon
- E) Tru

384. Cili prej ekzaminimeve klinike është i domosdoshëm për të përcaktuar diagnozën e dizfunksionit erektil?

- A) Arteriografia selektive
- B) Vezikolodeferentografija
- C) Nuk janë të nevojshëm ekzaminimet klinike
- D) Profilin glicemik, lipidik dhe testosteroneminë
- E) Teste psikometrike

385. Sfinteri vezikal i jashtëm është i përbërë nga:

- A) Muskulaturë e vijëzuar
- B) Muskulaturë e lëmuar
- C) Muskulaturë mikse
- D) Ind fibroz
- E) Ind fibro-adipoz

386. Hemorragjia që e ka pikënisjen nga uretra nën diafragmën shkakton:

- A) Uretrorragji
- B) Hematuri totale
- C) Hematuri fillestare
- D) Hematuri terminale
- E) Mikrohematuri

387. Shkaku më i shpeshtë i sindromës kavale superiore mund të jetë:

- A) Neoplazi e lobit superior të djathtë të pulmonit
- B) Tumori i timusit
- C) Carcinoma fulikulare e tiroïdes
- D) Fibroza e mediastinit
- E) Struma e zhytyr retrosternale

388. Cila valvul kardiake preket më shpesh nga sëmundja reumatike?

- A) Aortale
- B) Mitrale
- C) Pulmonare
- D) Trikuspidale
- E) Të gjitha valvulat preken në menyrë të njëjtë

389. Gjatë ndërhyrjet kardiokirurgjikale të by-passit koronar, perfuzioni me eritrocite të përqëndruara është:

- A) Gjithnjë i nevojshëm
- B) Asnjë herë i nevojshëm
- C) Kryhet gjithnjë nëse pacienti ka probleme me koagulimin e gjakut
- D) Gjithnjë i nevojshëm, në rast ndërhyrjesh ku bëhet qarkullimi ekstracorpor
- E) Asnjëra prej përgjigjeve

390. Flebo-edema në fazën fillestare karakterizohet nga:

- A) Edema e fortë premaleolare
- B) Edema e butë premaleolare
- C) Inflamim kronik premaleolare
- D) Dizkromi premaleolare
- E) Ulçera të lëkurës

391. Vena e madhe safena e merr origjinën:

- A) Posteriorisht pjesës së brendëshme të maleolit
- B) Anteriorisht pjesës së brendëshme të maleolit
- C) Anteriorisht pjesës laterale të maleolit
- D) Posteriorisht pjesës laterale të maleolit
- E) Në nivelin e depërtueses së Hunter

392. Shkaku më shumë i mundshëm i një versamenti pleural hemorragjik është:

- A) Tuberkulozi
- B) Pulmoniti
- C) Mykoza
- D) Neoplazi
- E) Astma

393. Arteria femurale e ka origjinën nga:

- A) Aorta torakale
- B) Arteria iliake e brendëshme
- C) Arteria iliake e jashtme
- D) Femuralja sipërfaqësore
- E) Femuralja e thellë

394. Çfarë terapie urgjente do të bëje në një bllok A-V të plotë?

- A) Lidokainë bolus
- B) Defibrilim elektrik
- C) Vendosje të pacemaker transcutan
- D) Kardioversionin elektrik
- E) Të gjitha

395. Dega interventrikulare posteriore merr origjinë nga:

- A) Koronaria e majtë
- B) Koronaria e djathtë
- C) Arteria cirkumflekse
- D) Dega interventrikulare posteriore
- E) Direkt nga aorta ashendente

396. Kush nuk është një komplikancë e mundshme gjatë ndërhyrjes për zëvendësimin e valvulës së aortës?

- A) Fillimi i një blloku të degës së majtë
- B) Dëmtim të pjesës fillestare të koronareve
- C) Dëmtim të fletës anteriore mitrale
- D) Endokarditi infektiv
- E) Fillimi i një blloku të degës së djathtë

397. Cila është simptoma më e shpeshtë e hernies diskale lumbare?

- A) Lumbalgja
- B) Gonalgja
- C) Skiatalgja
- D) Cervikalgja
- E) Brakialgja

398. Çfarë është sëmundja e Dupuytren?

- A) Tenosinovit stenozues i veshjes së tendinave fleksore të gishtave
- B) Sinostozë kongenitale radioulnare
- C) Retraksion të aponeurozës së pëllëmbës (palmare)
- D) Nekrozë aseptike të skafoïdit
- E) Pseudo-artrozë të skafoïdit

399. Tek pacientët e moshuar, cila është terapia përzgjedhëse në rastin e frakturave mediale të qafës së femurit?

- A) Me allçi
- B) Osteosintezë
- C) Zëvendësim me protezë
- D) Asnjë trajtim
- E) Heqjen e kokës së femurit

400. Të gjitha janë shenja radiografike të artrozës, përvë:

- A) Reduktim të hapësirës artikulare
- B) Prania e osteofiteve
- C) Prania e geoidëve
- D) Profili artikular i çrregullt
- E) Zgjerim të hapësirës artikulare

401. Cili prej ekzaminimeve strumentale mundëson realizimin e diagnozës së hernies së diskut:

- A) Echografia
- B) Arteriografia
- C) Termografia
- D) TAC/RMN
- E) Radiografia

402. Cila prej tendinave nuk kalon në kanalin karpal (kyçit të dorës):

- A) Radiali fleksor i kyçit
- B) Fleksor i thellë i gishtave
- C) Fleksor sipërfaqësor i gishtave
- D) Ulnari fleksor i kyçit
- E) Fleksor i gjatë i gishtit të madh

403. Manovra e Lasègue është pozitive kur:

- A) Kur përfshihet nervi skiatik
- B) Neoplazi të kolonës vertebrale
- C) Si rezultat i poliomelilit
- D) Tek miopatitë
- E) Në distorsionin vertebral

404. Morbusi i Paget:

- A) Rrallëherë është poliostik
- B) Prek kryesisht meshkujt
- C) Shfaqet në dekadën e dytë të jetës
- D) Ka një zhvillim të shpejtë
- E) Krakterizohet nga rritja e turn-overit kockor

405. "Mano Cadente" (dora që bie) shkaktohet nga:

- A) Paraliza e nervit radial
- B) Paraliza e nervit median
- C) Paraliza e nervit ulnar
- D) Paraliza e nervit muskulokutan
- E) Paraliza e nervit aksilar

406. Nga cilat vertebra merr origjinën nervi skiatik:

- A) L5-S1
- B) L2-L3
- C) S2-S3
- D) L4-L5-S1-S2
- E) L3-L4-L5-S1

407. Skolioza:

- A) Eshtë devijim i shtyllës kurizore në planin sagital
- B) Eshtë idiopatik në 70% të rasteve
- C) Eshtë shpesh kongenital
- D) Përcakton eterometri të gjymtyrëve të poshtme
- E) Eshtë shpesh sekondar

408. Komplikimet nervore më të shpeshta në frakturat e olekranit:

- A) Dëmtim të ulnarit
- B) Dëmtim të medianit
- C) Dëmtim të radialit
- D) Dëmtim të aksilarit
- E) Të muskulit kutan

409. Hernia e diskut përbëhet nga:

- A) Unaza fibrotike
- B) Bërthama pulpoze
- C) Nga i gjithë disku
- D) Nga disku+ ligamentin gjatësor anterior
- E) Nga disku, ligamentin gjatësor anterior, ligamentin gjatësor posterior

410. Cila strukturë përfshihet në sindromën e tunelit karpal?

- A) Nervi ulnar
- B) Nervi median
- C) Arteria radiale
- D) Nervi radial
- E) Tendina ekstensore ulnare e kyçit

411. Rakitizmi varet nga:

- A) Mungesa e vitaminës D
- B) Mungesa e vitaminës E
- C) Defiçiti i kalçitoninës
- D) Mungesa e vitaminës A
- E) Asnjëra prej përgjigjeve

412. Cila kockë e pëllëmbës së dorës bën frakturë më shpesh?

- A) Semilunarja
- B) Piramidalja
- C) Trapezoidi
- D) Kapitati
- E) Skafoidi

413. Frakturna bimaleolare e paqëndrueshme ka nevojë për:

- A) Bendazh funksional
- B) Stabilizim kirurgjikal
- C) Allçi në formën e kepcës
- D) Allçi nga kofsha deri tek këmba
- E) Manipulime

414. Frakturna e Colles përfshin:

- A) Ekstremitetin distal të tibias
- B) Metafizën radiale distale
- C) Kapiteliumin e radialit
- D) Oleokrani
- E) Kokën e omerit

415. Osteoporoza është një faktor rrisku për:

- A) Artrozë
- B) Infeksione
- C) Tumore të kockës
- D) Frakturna
- E) Insuficencë renale

416. Artikulacioni që përfshihet më shpesh nga luksacioni është:

- A) Anka (kocka e baçinit)
- B) Gjuri
- C) Kavilja
- D) Shpatulla
- E) Radio-karpal

417. Të gjithë janë komponentë të tetralogjisë së Fallot, përveç:

- A) Hipertrofi të ventrikulit të majtë
- B) Difekt të septumit interventrikular
- C) Pozicionim në anë të djathë të aortës
- D) Hipertrofi të ventrikulit të djathë
- E) Stenozë infundibulare (hinkore) të arteris pulmonare

418. Cili është shkaku i dizfonisë që shfaqet me zërin bitonal?

- A) Paraliza e një korde vokale
- B) Kollë e vazhdueshme për periudha të gjata
- C) Komprimim të trakesë
- D) Obstruksion të laringut
- E) Devijim të trakesë dhe ezofagut

419. Me spina bifida kuptohet:

- A) Keqformim kongenital i tubit nervor
- B) Agjenezi të trurit të vogël
- C) Mungesxe të trupit kalloz
- D) Mungesë të palcës kurrizore
- E) Tumor temporal

420. Apendisiti akut tek një fëmijë nën 5 vjeç, mund të shfaqë:

- A) Asnjëherë komplikime
- B) Komplikime të shpeshta
- C) Asnjë simptomë
- D) Koplikime vetëm në gjininë femërore
- E) Koplikime vetëm në gjininë mashkullore

421. Cila prej situatave të mëposhtme nuk është shkaku i cianozës tek një i sapolindur:

- A) Policitemia
- B) Sепси
- C) Vazhdueshmëria e qarkullimit fetal
- D) Kanali atrioventrikular i plotë
- E) Tetralogja e Fallot

422. Cilat janë rreziqet e kriptorkidizmit të pa operuar?

- A) Dizfunkioni erektil
- B) Degjenerimi neoplastik
- C) Orkiti
- D) Epididimit
- E) Hipogonadizëm hipogonadotrop

423. Një fëmijë 2 vjeçar, shfaq episode periodike e të rënda të dhimbjes së tipit kolik, të shoqëruara dhe me të qara e të vjella. Feçet janë me gjak të kuq. Në palpimin në epigastër vihet re një masë ovale. Cila prej diagnozave është më shumë e mundshme?

- A) Divertikuli i Meckel
- B) Stenoza kongenitale e pilorit
- C) Ileus nga mekonium
- D) Invaginimi
- E) Enterokoliti nekrotizant

424. Konsiderohet si "gold standard" për të diagnostikuar sëmundjen e Hirschsprung:

- A) Biopsia rektale
- B) Manometria anorektale
- C) Klizma opake
- D) Echografia abdominale
- E) Ph-metria

425. Ndërhyrja më e përshtatshme për trajtimin e stenozës kongenitale të pilorit është:

- A) Gatsrodigijnostomia
- B) Gastroduodenostomia
- C) Piloroplastika ekstramukozë
- D) Antrekтомia
- E) Rezekzioni gastro-duodenal

426. Tek një i sapolindur me fibrozë cistike, episodi i obstruksionit intestinal shkaktohet me shumë mundësi nga:

- A) Atrezi e duodenit
- B) Invaginimi
- C) Ileus nga mekonium
- D) Mungesën e perforimit anal
- E) Malrotacionin intestinal

427. Sa është vlera normale e saturimit të O₂ në gjakun venoz të arteries pulmonare?

- A) 92%
- B) 75%
- C) 60%
- D) 30%
- E) 45%

428. Sa është osmolariteti në solucionin fiziologjik (NaCl në ujë):

- A) 145 mOsm/l
- B) 175 mOsm/l
- C) 250 mOsm/l
- D) 300 mOsm/l
- E) 400 mOsm/l

429. Në cilën prej gjendjeve të mëposhtme, bëhet ventilimi artificial?

- A) Rritje e PaCO₂
- B) Ulje i PaO₂
- C) Rritje e pH
- D) Ulje e pH
- E) Të gjitha gjëndjet

430. Sa oksigjen ka normalisht në ajrin e ekspiruar?

- A) Përafërsisht 5%
- B) Përafërsisht 10%
- C) Përafërsisht 16%
- D) Përafërsisht 25%
- E) Përafërsisht 35%

431. Barbiturët, në nivelin e sistemit nervor qëndror:

- A) Ulin konsumin e O₂
- B) Rrisin konsumin e O₂
- C) Normalizojnë konsumin e O₂
- D) Induktojnë hipokapni
- E) Nuk ndikojnë në konsumin e O₂

432. Cili prej diuretikëve ruan kalumin?

- A) Spironolactoni
- B) Acetazolamidi
- C) Furosemidi
- D) Clortiazidi
- E) Acidi etakrinik

433. Cili prej faktorëve ul probabilitetin e suksesit të defibrilimit elektrik:

- A) Hipotermia
- B) Acidoza
- C) Hipoksia
- D) Rezistencë e rritur e toraksit
- E) Të gjitha

434. pH arterial $>7,6$ dhe PaCO₂ >45 sugjerojnë për:

- A) Acidozë metabolike
- B) Acidozë respiratore
- C) Alkalozë metabolike
- D) Alkalozë respiratore
- E) Alkalozë mikse

435. Takikardia parosistike me bllok AV 2:1 është tipike nga mbidozimi me:

- A) Lidokainë
- B) Digital
- C) Verapamil
- D) Diltiazem
- E) Adenozinë

436. Në alkalozën respiratore, PCO₂:

- A) Rritet
- B) Ulet
- C) Nuk ndryshon
- D) Varion në kohë
- E) Nuk përcaktohet

437. Tek enfizema senile, insufiçanca respiratore shoqërohet me:

- A) Hipersekrecion bronkial
- B) Djersitje
- C) Takikardi dhe hipertension
- D) Kongjestion të lëkurës dhe cianozë
- E) Të gjitha përgjigjet

438. Pneumotoraksi i hapur shkaktohet nga:

- A) Sëmundjet pleuro-pulmonare
- B) Komunikimi i vazhdueshëm midis kavitetit pleural dhe ambientit të jashtëm
- C) Ruptura (çarja) e ndonjë bule subpleurale
- D) Fistulizimi bronkial
- E) Embolia pulmonare

439. Cili është shkaku më i zakonshëm i embolisë arteriale?

- A) Prania e aneurizmës së aortës
- B) Fibrilacioni atrial
- C) Prania e disa pllakave ateromatoze të ulçeruara
- D) Përdorimi i mjekimit me kimioterapikë
- E) Prania e sindromit të antitrupave antifosfolipidë

440. Triada klinike tipike për hypertensionin endokranial është:

- A) Cefale, të vjella, edemë të papilës
- B) Cefale dhe humbje të ndërgjegjes
- C) Dhimbje të qafës dhe marrje mendsh
- D) Temperaturë
- E) Skotoma dhe ulje të shikimit

441. Nje grua 42 vjecare shtrohet ne urgjence me nje dhimbje te forta barku, te vjella, me distension abdominal dhe me arrest te feceve me gaz. Anamneza eshte per gjithesish normale per vec nje operacioni qe ka bere 12 vjet me pare. I behet radiografi direkte abdomenit ne kembe edhe vihen re hidronivele ne zorren e holle. Bllokimi intestinal mund te jete i tipit:

- A) Adenokarcinome
- B) Morbus Crohn
- C) Sd aderenciale
- D) Ileus biliar
- E) Kolit ulceroz

442. Trajtimi i metastazave epatike eshte i mundur, vetem kur:

- A) Tumori primitiv eshte < 3 cm
- B) Numri i metastazave eshte < 2
- C) Madhesia e metastazave nuk kalon 3 cm
- D) Te gjitha

443. Linfonodi Sentinella:

- A) Ai qe zbulohet i pari gjate vizites se pacientit
- B) Eshte me afer tumorit
- C) Eshte metastaze
- D) Eshte noduli i pare ku drenohet linfa peritumorale
- E) Asnjera

444. Quhet hernie interne:

- A) Dislokimi abnormal i omentumit ne reces natural ose neoformazione te hapesires peritoneale
- B) Dislokimi abnormal i nje ose me shume organeve ne reces natural ose neoformacione te hapesires peritoneale
- C) Prezenca e hernies ne stad inicial
- D) Prezenca e nje laparocele ne stad inicial
- E) Asnjera

445. Lobi i Spigelios ose lobi caudate i heparit, korrespondon me:

- A) Segmentin e I
- B) Segmentin e II
- C) Segmentin e VI
- D) Segmentin e VII
- E) Asnjera

446. Konsiderohet indikacion per trapiant te heparit tek te rriturit:

- A) Epatosteatoze akute gjate shtatezanise
- B) Cirroze biliare primitive
- C) Kolangite sklerozante
- D) Te gjitha

447. Konsiderohet kunderindikacion per kateterizimin venoz central:

- A) Enfizema polmonare
- B) Pneumotoraksi
- C) Linfoadenopatia sopraklavare
- D) Asnjera

448. Cili eshte ilaci kryesor ne trajtimin neoadjuvant te karcinomes se rektumit:

- A) Mitomicina-C
- B) 5-fluoruracili
- C) Adriamicina
- D) VP-16
- E) Asnjera

449. CVL -ja nuk duhet bere kur ka:

- A) Obezitet
- B) Intervente kirurgjikale te meparshme
- C) Hernie epigastrike te zmadhuar
- D) Asnjera

450. Konsiderohet komplikance teknike e ushqyerjes parenterale totale (NPT):

- A) Pneumotoraksi
- B) Pozicionimi i keq i kateterit
- C) Shpimi i arteries suklavia
- D) Pneumotoraksi, pozicionimi i keq i kateterit, shpimi i arteries suklavia
- E) Asnjera

451. Nje femije me veshtiresi ne frysma e diagnozuar me:

- A) Gjak komplet
- B) Emogaz
- C) Ekzaminim i espektoratit
- D) Elektrocardiogram
- E) RX toraksit

452. Konsiderohet pike e dhimbshme e apendiksit te inflamuar:

- A) Pika Mc Burney
- B) Pika Morris
- C) Pika Munro
- D) Pika Lanz
- E) Te gjitha

453. Ekzaminimet e bera per te diagnozuar një okluzion intestinal janë:

- A) Ekografi abdomenit
- B) Radiografi direkte e abdomenit
- C) Skaner
- D) Laparoskopi
- E) Asnjera

454. Funksioni i sfinkterit ezofageal inferior, eshte:

- A) Te pengoje refluksin e materialit gastrik ne ezofag
- B) Te ngadalsoje kalimin e ushqimit
- C) Te perspejtoje kalimin e ushqimit
- D) Te stimuloje gogesimen
- E) Te gjitha

455. Tumori i Klatskin eshte:

- A) Tumor malinj i rrugeve biliare intrahepatike

- B) Tumor malinj i duktuseve hepatike te djathte edhe te majte
- C) Tumor malinj i kokes se pankreasit
- D) Tumor malinj i bishtit te pankreasit
- E) Asnjera

456. Akalazia eshte:

- A) Nje alterim motor i karakterizuar vetem nga mungesa e relaksimit te sfinkterit inferior te ezofagut
- B) Nje alterim motor i karakterizuar nga mungesa e relaksimit te sfinkterit superior te ezofagut
- C) Nje alterim motor i karakterizuar nga mungesa e relaksimit te sfinkterit inferior te ezofagut, arrest total ose moskordinim i peristaltikes edhe dilatacion i ezofagut
- D) Nje alterim motor i karakterizuar nga mungesa e relaksimit te sfinkterit superior te ezofagut, arrest total ose moskordinim i peristaltikes edhe dilatacion i ezofagut
- E) Asnjera

457. Cili eshte kuptimi i Xenotriantit:

- A) Transplantim mes te afermeve
- B) Transplantim mes njerezve te sekseve te kunderta
- C) Transplantim mes njerezve te racave te ndryshme
- D) Transplantim mes specieve te ndryshme
- E) Transplantim te organeve artificiale

458. Ne nje pacienteje me rrjedhje hematike te thithes, eshte e nevojshme:

- A) ekografi mamarie
- B) duktogalaktografia
- C) mamografi
- D) agoaspirim i lezionit
- E) asnjera

459. Ne prezence te nje opaciteti ne mushkerite e nje 40 vjecari, eshte e nevojshme:

- A) te fillohet nje terapi me antibiotik
- B) te nderhyet sa me shpejt ne menyre kirurgjikale
- C) te behet diagnoza e sakte perpara se te filloje terapia
- D) te zhvillohet nje cikel kemioterapie antituberkulare
- E) te gjitha

460. Dhimbre abdominale, rritje te peristaltikes, te vjella dhe arrest i zorres me fece dhe gaz jane karakteristike te:

- A) arrest te zorreve
- B) peritonit
- C) pankreatit
- D) kolecistit
- E) te gjitha

461. Karcinoma kolorektale e trasheguar jo polipoide (sindroma Linch I), karakterizohet nga:

- A) trashegimi autosomale dominuese
- B) prevalence e kancerit te kolonit proksimal
- C) mosha e re
- D) te gjitha

462. Seminoma e testikulit:

- A) eshte tumor i rralle testikular
- B) rritet shpejt
- C) metastazon ne kocke
- D) asnjera

463. Rezekioni abdomino-perineal sipas Miles konsiston në:

- A) proktokolektomi totale me anastomoze ileo-anale me cistekomi
- B) amputim i rektumit, anusit, sfinkterit anal dhe kolonostomia definitive
- C) rezeksion anterior i ulur, anastomoze rektale dhe kolonostomi provizore mbrojtese
- D) prokto-kolektomi totale me ileostomi definitive
- E) asnjera

464. Tiroidektomia totale keshillohet ne rast:

- A) Strume multinodulare
- B) Ca midolar
- C) Ca folicolar
- D) Te gjitha

465. Ne pacientet ne te cilet eshte kryer nje splenektomi, eshte gjetur qe jane:

- A) Me rezistente ndaj infeksioneve
- B) Me te ndjeshem ndaj infeksioneve te vazhdushme
- C) Prodhues te nje numri me te madh antikorpesh
- D) Shfaqin eozinofili
- E) Asnjera

466. Nga sa shtresa te bashkuara eshte i perbere muri i nje kisti te ekinokokut:

- A) Dy
- B) Tre
- C) Pese
- D) Dy ose tre, sipas vendodhjes se cistit
- E) Asnjera

467. Volvusi eshte:

- A) Torsion i aksit te nje segmenti te zorres se holle rreth vetes ose rreth mezenterit, i cili shkakton nje bllokim proksimal te lumenit
- B) Torsion i aksit te nje segmenti te colonit rreth vetes ose rreth mezenterit, i cili shkakton nje bllokim proksimal te lumenit
- C) Torsion i aksit te nje segmenti te zorres se holle rreth vetes ose rreth mezenterit, i cili shkakton nje bllokim distal te lumenit
- D) Torsion i aksit te nje segmenti te zorres se holle ose te colonit rreth vetes ose rreth mezenterit, i cili shkakton nje bllokim proksimal e distal te lumenit
- E) Asnjera

468. Cili nga keto tumore te tiroides, eshte me shpesh i lidhur me neopplasi te tjera endokrine:

- A) Adenoma folikulare
- B) Karcinoma medulare
- C) Karcinoma folikulare
- D) Karcinoma papilare
- E) Asnjera

469. Kush nga alternativat e meposhtme, i korespondon nje neoplazie mamare te klasifikuar ne stadin 1:

- A) tumori me madhesi qe varion nga 2 ne 5 cm
- B) mungesa e linfonodujve homolaterale te palpueshem
- C) mungesa e metastazave
- D) te gjitha

470. Ne kirurgjine e colon-rekt, agjenti qe shkakton me shpesh infeksionin e plages operatore me origjine anaerobe eshte:

- A) C.perfringens
- B) C.tetani
- C) B.fragilis
- D) Fuzobakterium spp.
- E) asnjera

471. Lobi kaudat i heparit i korrespondon:

- A) segmentit 1
- B) segmentit 2
- C) segmentit 4
- D) segmentit 8
- E) asnjera

472. Sarkidoza me adenopati hilare asimptomatike e pa interesim te parenkimes pulmonare, kerkon:

- A) terapi kortikoide
- B) terapi me ossifenbutazon
- C) terapi me kolkicine
- D) terapi me klorokine
- E) asnje terapi

473. Konsiderohet si manifestimi klinik me i shpeshte ne hipertensionin portal:

- A) encefalopatia
- B) hemorragija gastro-intestinale
- C) asciti
- D) splenomegalia
- E) te gjitha

474. Hidroadeniti eshte:

- A) pezmatimi akut i nje gjendre dhjamore
- B) bashkimi i disa forunkulave
- C) pezmatimi akut i nje gjendre sudoripare
- D) nje linfadenit aksilar
- E) asnjera

475. Ne presence te HCC ne cirrozen hepatike, ne cilin rast indikohet rezeksioni hepatic:

- A) nodul unik ne cirroze te dekompenso (child B-C)
- B) nodule multiple ne cirroze te kompenso (child A)
- C) nodul unik ne cirroze te kompenso (child A)
- D) nodul unik ne Child A me tromboze portale (trombektomia portale)

E) asnjera

476. Ne tumoret e pjeses rektale me pT3N2M0, nenkuptohet:

- A) nje vleresim preoperator i shtrirjes se tumorit
- B) tumor qe shtrihet deri ne musculature dhe intereson dy linfonodula
- C) tumor qe invadon strukturat fqinje
- D) te dhenat intraoperatore te tumorit, ku jane te prekura dhe linfonodulat lokoregionale
- E) asnjera

477. Tumori i apendiksit me shpesh eshte:

- A) adenokarcinome
- B) carcinoid
- C) linfoma
- D) leiomiosarkoma
- E) asnjera

478. Cilet nga ilacet me poshte perdoret ne bashkepunim me radioterapine ne trajtimin neoadjuvant te kancerit rektal:

- A) oxaliplatin
- B) kapecitabina
- C) CPT-11
- D) bevacizumab
- E) te gjitha

